

CH
WB

Cultural
Heritage without Borders
KOSOVO



GJENDJA E TRASHËGIMISË KULTURORE

NË KOSOVË

2021


TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|----|
| EKIPI PUNUES | 5 |
| LISTA E SHKURTESAVE | 6 |
| 1. HYRJE | 8 |
| 2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT | 10 |
| 3. GJENDJA FIZIKE E TRASHËGIMISË KULTURORE | 12 |
| 3.1 Gjendja fizike e aseteve të trashëgimisë arkitekturore | 14 |
| 3.2 Kriteret e vlerësimit | 16 |
| 3.3 Lista trashëgimia në rrezik gjate vitit 2021 | 17 |
| 3.4 Të dhënat e gjendjes fizike të aseteve në terren | 20 |
| 3.4.1. Asetet që janë rrënuar plotësisht | 21 |
| 3.4.2. Asetet që i është përkeqësuar gjendja fizike | 26 |
| 3.4.3. Asetet e intervenuara me qëllim të përmirësimit të gjendjes fizike | 35 |
| 4.DËMTIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE NË TRI VITET E FUNDIT (2018-2020) | 42 |
| 4.1 Dëmtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prishtinës | 44 |
| 4.2 Dëmtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Pejës | 47 |
| 4.3 Dëmtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prizrenit | 48 |

| | |
|---|----|
| 5.PLANFIKIMI HAPSINOR DHE TRASHËGIMIA KULTURORE | 52 |
| 5.1 Përpilimi i hartës zonale të Kosovës | 53 |
| 5.1.1 Numri i monumenteve të përfshira në hartën zonale të Kosovës | 55 |
| 5.1.2 Informatat (lloji, formati, standardi) | 58 |
| 5.1.3 Qasja dhe siguria në zonat e veçanta të mbrojtura | 61 |
| 5.2. Përspektiva e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore | 62 |
| 5.2.1 Bazuar në informatat e hartës zonale të Kosovës | 62 |
| 5.2.2 Bazuar në informatat e hartave zonale komunale | 63 |
| | |
| 6. INSTITUCIONET E TRASHËGIMISË KULTURORE | 64 |
| Roli dhe përgjegjësitë e institucioneve kompetente të trashëgimisë kulturore, analizë reflektuese e punës së këtyre institucioneve në vitet e fundit ..VEC TITULL OSHT, PA TEKST | 65 |
| 6.1. KKTK , Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, institucionet kompetente në varësi të MKRS-së | 65 |
| 6.1.1. Aktivitetet e Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore | 68 |
| 6.1.2. Sfidat e KKTK-së | 69 |
| 6.1.3. Buxheti i shpenzuar | 70 |
| 6.2. MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Departamenti i Trashëgimisë Kulturore | 73 |
| 6.2.1. Aktivitetet e MKRS-së – Departamentit të Trashëgimisë Kulturore | 75 |
| 6.2.2. Sfidat e MKRS-së – Departamentit të Trashëgimisë Kulturore | 76 |
| 6.2.3. Buxheti - Shpenzimet Financiare | 78 |
| 6.3. IAK - Instituti Arkeologjik i Kosovës | 85 |
| 6.3.1. Aktivitetet e Institutit Arkeologjik të Kosovës - IAK | 87 |
| 6.3.2. Sfidat e Institutit Arkeologjik të Kosovës - IAK | 88 |
| 6.3.3. Buxheti i shpenzuar i Institutit Arkeologjik të Kosovës | 90 |
| 6.4. IKMM - Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve | 92 |
| 6.4.1. Aktivitetet e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve - IKMM | 94 |
| 6.4.2. Sfidat e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve - IKMM | 95 |
| 6.4.3. Buxheti i shpenzuar i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve - IKMM | 97 |

| | |
|---|------------|
| 6.5. QRTK - Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore | 99 |
| 6.6. ITK - Inspektorati për Trashëgimi Kulturore | 103 |
| 6.6.1. Sfidat e Inspektoratit për Trashëgimi Kulturore- ITK | 104 |
| 6.6.2. Buxheti i Inspektoratit për Trashëgimi Kulturore- ITK | 105 |
| 7. LISTA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË MBROJTJE TË PËRHERSHME DHE TË PËRKOHSHME | 107 |
| 7.1. Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme | 108 |
| 7.2. Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme | 111 |
| 8. PËRDORIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM | 112 |
| 8.1. Plani i menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit | 113 |
| 8.2. Plani i menaxhimit të Kalasë së Prizrenit | 115 |
| 8.3. Miratimi dhe publikimi i planeve të menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kalanë e Prizrenit | 116 |
| 9. PËRFUNDIMI | 118 |
| BIBLIOGRAFIA | 125 |
| PYETËSORËT | 131 |

GRUPI PUNUES:



Menaxhere e hulumtimit:
ARGJIRË KRASNIQI

Këshilltar i hulumtimit:
SALI SHOSHI

Hulumtuesë dhe
tekstshkruesë:
ALBAN MORINA
ARGJIRË KRASNIQI
DORUNTINA UKIMERI
ERINË MULOLLI ZAJMI

Lektoruese:
VIOLETA KELMENDI

Dizajner:
FATON HASANI

LISTA E SHKURTESAVE

| | | | |
|--------------|--|--------------|---|
| MKRS | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | DKRS | Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit |
| KKTK | Këshilli i Kosovës për Trashëgimi të Kosovës | DTZHE | Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik |
| QRTK | Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore | TK | Trashëgimia Kulturore |
| IAK | Instituti Arkeologjik i Kosovës | HZKos | Harta Zonale e Kosovës |
| IMMK | Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës | HZKom | Harta Zonale e Komunës |
| ITK | Inspektoriati për Trashëgimi Kulturore | PHK | Plani Hapësinor i Kosovës |
| TK | Trashëgimia Kulturore | GIS | Sistemi Informativ Gjeografik |
| KGJK | Këshilli Gjyqësor i Kosovës | SPAK | Aplikacioni GIS për Sistemin Zyrtar të Planifikimit Hapësinor për Menaxhim të Bazës së të dhënave |
| KPK | Këshillit Prokurorial i Kosovës | MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| DPP | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë | IPH | Instituti për Planifikim Hapësinor |
| PMQHP | Plani i Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit | PZHK | Plan Zhvillimor Komunal |
| PMKP | Plani i Menaxhimit për Kalanë e Prizrenit | UA | Udhëzim Administrativ |
| ZQH | Zyra për Qendrën Historike | ZVM | Zona të Veçanta të Mbrojtura |
| CHWB | Cultural Heritage Without Borders (Trashëgimia Kulturore pa Kufij) | KOS | Kisha Ortodokse Serbe |
| DSHP | Drejtoria e Shërbimeve Publike | SHPK | Shërbimi Policor i Kosovës |
| DA - | Drejtoria e Arsimit | | |

1. HYRJE

Trashëgimia kulturore është një ndër mjetet më të rëndësishme për formimin dhe fisnikërimin e identitetit.¹ Si rrjedhojë, trashëgimia kulturore e shtrirë në kohë dhe hapësirë të ndryshme, pasqyron vlerat kulturore të një populli. Por, si qëndron Kosova në këtë fushë? Sa është e rëndësishme për politikën nacionale formimi i një identiteti dhe krijimin e një sensi të përkatësisë përmes asetëve të trashëgimisë kulturore? Si ndikon performanca e sundimit të ligjit në përkeqësimin e gjendjes së trashëgimisë kulturore në vend? Sa ndihen qytetarët përgjegjës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore?

Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore në Kosovë është e garantuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht neni 9 i Kushtetutës përcakton që "Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare" dhe neni 58, pika 5, "Republika e Kosovës do të promovojë ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës. Republika e Kosovës do të ketë detyrë të posaçme për të siguruar mbrojtjen efektive të tërësisë së objekteve dhe monumenteve të rëndësishme kulturore dhe fetare për komunitetet."

Raporti "Gjendja e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë - 2021" përmban një analizë të gjendjes në fushën e trashëgimisë kulturore, gegjesisht gjendjen e asetëve të trashëgimisë ndërtimore duke bërë një reflektim real të performancës institucionale, më saktësisht institucioneve kompetente të trashëgimisë kulturore, të cilat detyrë e kanë ruajtjen, mbrojtjen dhe integrimin këtyre asetëve në politikën zhvillimore të vendit.

Ky raport, sigurisht që nuk është skenimi i parë për gjendjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Organizata vendore dhe ndërkombëtare kanë publikuar raporte të veçanta në të cilat janë analizuar çështje të caktuara, sikurse që mediet vazhdimisht kanë raportuar nga terreni për problemet dhe sfidat që e kanë përcjellur këtë sektor. Megjithatë, ky raport synon që të përmbledhë dhe sistemoj disa nga çështjet kyçe të cilat janë tregues për gjendjen fizike të asetëve, sfidat institucionale në menagjim të këtyre asetëve dhe trendet aktuale. Ky format do të shërbej si shkallë krahasuese në vlerësimin e performancës së institucioneve të trashëgimisë në adresimin e sfidave.

CHWB Kosova synon që një raport i tillë të vë në dispozicion të publikut çdo vit, duke e synuar për të ngritur transparencën dhe llogaridhënien institucionale karshi publikut.

Në besojmë se politikën e sukseshme bazohen në identifikim të saktë të problemeve, në mënyrë që të ofrohet zgjidhjet e duhura.

Ky raport ndër të tjera renditë sfidat të cilat pritet të adresohen gjatë viteve në vijim. Gjendja fizike e ndërtesave, degradimet dhe rrënimet e ndërtesave historike; sfidat e integritetit të trashëgimisë në politikën e planifikimit hapësinor; çështjet e drejtësisë dhe sigurisë; bashkëpunimi institucional dhe ndarja e buxhetit janë disa prej temave të cilat janë analizuar, dhe të cilat mbesin sfida për tu ballafaquar në të ardhmen.

Institucionet e Kosovës deri tash kanë përfshirë në listë rreth një mijë e pesëqind (1500) ndërtesa të trashëgimisë kulturore ndërtimore (arkitekturore dhe arkeologjike), rrjedhimisht shoqërisë kosovare iu është ofruar një potencial kulturor me rëndësi historike, shoqërore, estetike, shkencore dhe ekonomike. Por, ky potencial do të duhet të ruhet, mbrohet dhe intergrohet në politikën zhvillimore në mënyrë që të kthehet si resurs për zhvillim të qëndrueshëm duke ndikuar në mirëqenien socio-ekonomike në vend. Trashëgimia kulturore është një prej potencialeve dhe resurseve më të rëndësishme të Kosovës dhe si e tillë duhet të trajtohet.

Argjirë Krasniqi, Sali Shoshi

¹ Graham, B., Hoëard, P., Eds. (2008). *The Ashgate Research Companion to Heritage and Identity*

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Modeli përfaqësues i hulumtimit është përdorur për të shtrirë në kohë analizën, duke mbuluar një periudhë kohore të 3-5 viteve të fundit. Qëllimi i këtij hulumtimi është krijimi i një pasqyre të qartë reflektuese mbi gjendjen e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë.

Ky hulumtim ka përdorur disa metoda të mbledhjes së informatave si përmes: analizës së ligjit dhe akteve nënligjore, rregulloreve dhe udhëzuesve relevantë, përmes analizimit/ hulumtimit të dokumentacioneve të publikuara online, raporteve të publikuara nga institucionet dhe organizatat që kanë monitoruar sektorin e trashëgimisë kulturore, përmes intervistave dhe takimeve me zyrtarët e institucioneve relevante dhe përmes hulumtimit në terren. Në disa raste, për shkak të vështirësive në sigurimin e dokumenteve publike, ka qenë e nevojshme asistimi i Institutit të Avokatit të Popullit dhe Agjencisë për informim dhe privatësi.

Metodat e përdorura :

Metoda përshkruese – përshkrim i problematikës, teorive e nocioneve kryesore që lidhen me temën

Metoda statistikore – paraqitje e të dhënave të ndryshme statistikore e empirike që vlerësojnë gjendjen e aseteve të trashëgimisë arkitekturore

Metoda e krahasimit – krahasim i gjendjes së aseteve në kohë

Secila prej këtyre metodave ka për qëllim që të jep përgjigje nga kënde të ndryshme për fenomene të caktuara që direkt apo indirekt ndikojnë në trashëgiminë kulturore.

Janë përpiluar edhe pyetësorë ndër-sektorial që përfshijnë intervista me përgjegjës të ndryshëm institucional dhe pyetësorë ku të dhënat janë mbledhur në mënyrë të përsëritur dhe të kohëpaskohshme. Janë përdorur dy lloje të pyetësorëve, ata të përgjithshëm dhe pyetësorët specifik. Para takimeve apo zhvillimit të intervistave, janë dërguar letra paraprake apo thirrje telefonike për të zhvilluar takimet fizike. Pyetësori i përgjithshëm i është drejtuar MKRS-së, Departamentit të Trashëgimisë Kulturore, të gjitha Qendrave Ra-

jonale për Trashëgimi Kulturore - QRTK, Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Institutit Arkeologjik të Kosovës e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve. Ky pyetësor përmbanë ndër të tjera pyetje lidhur me mënyrën e organizimit të këtyre institucioneve, strukturën organizative, numrin e të punësuarve, planet vjetore të punës, e të tjerë. Përderisa, pyetësorët specifik janë dizajnuar enkas për institucionet të cilave iu është drejtuar pyetësori me pyetje të cilat janë lidhur me punën dhe përgjegjësitë e tyre. Këta pyetësorë i janë drejtuar Departamentit të Trashëgimisë Kulturore të MKRS-së, Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, IKMM-së, QRTK-ve, Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore dhe të gjitha departamenteve respektive të nivelit komunal që puna e tyre lidhet me trashëgiminë kulturore. Poashtu, është zhvilluar komunikim i vazhdueshëm me shkrim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Gjykatat Themelore, Prokuroritë Themelore, Policinë e Kosovës. Të gjithë pyetësorët e përdorur janë bashkëngjitur në shtojcën e këtij hulumtimi.

Hulumtimi në terren ka përfshirë vrojtimin në terren të 198 aseteve të cilat i përkisnin Listës Trashëgimia në Rrezik si dhe një numri të aseteve në gjendje të keqe fizike. Arsyeja se pse janë përzgjedhur këto kategori për inspektim është pikërisht gjendja e rënduar fizike në të cilën ndodhen dhe rreziku i degradimit të vazhdueshëm të tyre edhe në të ardhmen.

3. GJENDJA FIZIKE

E TRASHËGIMISË KULTURORE

Ndonëse infrastruktura ligjore për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës ka vendosur themelet e veta me miratimin e Ligjit për Trashëgimi Kulturor, në të vërtetë trashëgimia arkitekturore, arkeologjike, e luajtshme dhe ajo shpirtërore përballen me sfida dhe rreziqe të vazhdueshme.

Në ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës, janë të angazhuara një numër organizatash e institucionesh të cilat përbëjnë një sistem zingjiror që kërkon koordinim dhe bashkëpunim midis tyre në mënyrë që të jetë efikas. Nga të dhënat që kemi mbledhur nga institucionet përgjegjëse del se asetet e trashëgimisë kulturore përballen me sfida sa i përket ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të tyre.

Gjendja fizike e aseteve të trashëgimisë kulturore është e ndryshme. Më konkretisht, shumica e aseteve të trashëgimisë kulturore të kategorisë arkitekturore janë në gjendje të mirë dhe mesatare fizike. Megjithatë, nuk mungojnë asetet të cilat janë në gjendje të keqe fizike apo edhe pranë shkatërrimit të tërësishëm. Institucionet relevante intervenojnë gjatë vitit në restaurimin e këtyre aseteve apo përmirësimin e gjendjes së tyre fizike. Megjithatë, janë evidente problemet e prioritizimit të projekteve apo edhe fokusit në asete të caktuara të trashëgimisë apo regjione specifike. Më tutje, në disa raste paraqiten probleme edhe me pronarët të këtyre aseteve të cilët edhe refuzojnë intervenimet e ndryshme nga institucionet. Problematike mbetet numri i inspektimeve në asete të caktuara dhe përditësimi i gjendjes së tyre nga terreni.

Qëllimi i hulumtimit mbi përgjegjësinë institucionale dhe individuale në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore është vënia në pah e gjendjes së trashëgimisë kulturore dhe dëmtimit që asetet e trashëgimisë kanë pësuar në tre vitet e fundit dhe veprimet e institucioneve relevante për mbrojtjen e saj, me theks të veçantë ato në Komunën e Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit. Në një periudhë kohore tre vjeçare (2018- 2020) asetet e trashëgimisë

në këto komuna janë dëmtuar apo janë rrezikuar të dëmtohen përmes veprimeve të paautorizuara, tejkalimit të lejeve të pëlqimit dhe veprimeve të tjera. Me qëllim të evidentimit të dëmeve të shkaktuara në asetet e trashëgimisë kulturore përgjatë tri viteve të fundit, kemi nxjerrë të dhëna mbi veprimet e ndërmarra nga ana e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Të dhënat statistikore të marra nga institucionet përgjegjëse, të cilat në të shumtën e rasteve nuk kanë apo nuk ofrojnë për publikun të dhëna të strukturuar sa i përket trashëgimisë kulturore tregojnë për një moskoordinim midis institucioneve dhe mostrajtim dinjitoz të çështjeve që lidhen me trashëgiminë kulturore. Kjo për faktin se shumica e zyrave për statistika në institucionet relevante nuk posedojnë të dhëna për trashëgiminë kulturore dhe nuk e kanë të specifikuar atë si kategori. Gjenerimi i të dhënave statistikore nga sisteme digjitale të centralizuara së fundmi ka mjugulluar edhe më tej mbledhjen e të dhënave statistikore për trashëgiminë kulturore. Rrjedhimisht institucionet lokale nuk kanë mekanizma për matjen e shkallës së dëmtimit të trashëgimisë kulturore e as të dhëna të veçanta për këtë kategori. Edhe pse institucionet kanë detyrime të qarta ligjore për të vepruar për ruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe Kosova ka kornizë legjislative dhe institucionale të favorshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore mbetet ende një sfidë e vazhdueshme.

3.1 GJENDJA FIZIKE E ASETEVE

TË TRASHËGIMISË

ARKITETURORE

Regjistri i trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohëshme 2020-2021 përmban gjithsej 923 asete të kategorisë Trashëgimia Arkitekturore, nënkategoria monument/ ansambël.

Në vitin 2016 ChwB Kosova i ka vlerësuar shumicën e këtyre aseteve duke i listuar ato në njëren nga kategoritë: e mirë, mesatare, e keqe, shumë e keqe, pjesërisht e rrënuar dhe plotësisht e rrënuar. Shtesë kësaj, po në të njejtin vit u përpilua edhe lista "Trashëgimia në rrezik" e cila përbëhet prej aseteve të cilat i përkisnin tri kategorive të fundit të vlerësimit fizik: asetet në gjendje shumë të keqe fizike, pjesërisht të rrënuar dhe ato plotësisht të rrënuar.

Lista "Trashëgimia në rrezik" e vitit 2017 përmban gjithsej 109 asete të trashëgimisë arkitekturore në gjendje shumë të keqe fizike dhe pjesërisht të rrënuar.

Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosova) në bashkëpunim me organizatën EC Ma Ndryshe, gjatë vitit 2016 ka analizuar gjendjen fizike të 870 aseteve të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Me qëllim të vlerësimit të gjendjes së tanishme fizike, ekipet e CHwB Kosova gjatë vitit 2021 vizituan 86 asete nga "Lista Trashëgimia në rrezik" si dhe 112 asete të tjera të kategorizuara më parë në gjendje të keqe fizike.


Arsyeja se pse janë përzgjedhur këto kategori për inspektim është pikërisht gjendja e rënduar fizike në të cilën ndodhen dhe potenciali për t'u degraduar edhe më tej kryesisht për shkak të mos përkujdesjes dhe mos shfrytëzueshmërisë së tyre.

Kështu, gjatë vitit 2021 u vizituan gjithsej 198 asete të trashëgimisë arkitekturore, prej të cilave:

- **9** asete janë rrënuar plotësisht (4,54%);
- **26** aseteve iu është përqendësuar gjendja fizike (13.63%);
- **114** asete janë në gjendje të njëjtë fizike (57.57%);
- **19** asete iu janë nënshtruar ndërhyrjeve për përmirësim të gjendjes (9.59%);
- **20** asete nga lista në rrezik janë në proces të intervenimit/ restaurimit (9.59%);

Po ashtu, përgjatë pesë viteve të fundit, ndërhyrje emergjente dhe konservuese/ restauruese janë bërë edhe në një numër të aseteve të cilat nuk ishin pjesë e listës "Trashëgimia në rrezik" të ChwB Kosova, mirëpo të cilat ishin në listat prioritare të Qendrave Rajonale të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës.

Bazuar në këto gjetje, shumica e aseteve vazhdojnë të mbesin në gjendje të njëjtë fizike, përderisa është shqetësues fakti që nëntë prej tyre janë rrënuar plotësisht.



Në gjendje të njejtë
58%

Përkeqësim i gjendjes
14%

Plotësisht të rrënuara
5%

Nuk ka pasë qasje
4%

Në proces të intervenimit
10%

Të intervenuara
9%

3.2 KRITERET E VLERËSIMIT

Procesi i vlerësimit të aseteve të trashëgimisë arkitekture ka përfshirë vlerësimin e një numri të caktuar të kriterëve, të cilët do të japin një pasqyrë të shkallës së rrezikut për këto asete. Këto kriterë janë bazuar në vlerësimin e trashëgimisë në rrezik sipas English Heritage*.

Në mënyrë që të përcaktohet gjendja e përgjithshme fizike, kriteret janë caktuar sipas llojit të dëmtimeve të elementeve të asetit/ strukturës tek: muret e jashtme, kulmin (mbulesën, oxhakun dhe olluqet), dyert dhe dritaret dhe enterierin, aty ku kishte qasje.

Si rrjedhojë, kombinimi i llojeve të dëmtimeve që paraqiste një aset, ka dhënë një pasqyrë të gjendjes tyre fizike, duke e listuar asetin në njërin nga këto kategori:

- E mirë: kur ndërtesa është në gjendje stabile në aspektin struktural, nuk ka dëmtime dhe nevojë për intervenime;
- Mesatare: kur ndërtesa është në gjendje stabile në aspektin struktural, por që ka nevojë për riparime të vogla dhe mirëmbajtje të përgjithshme;
- E keqe: dëmtime në mure, ose një kulm që rrjedhë, me dëmtime të shkaktuara nga ndikimet atmosferike, zakonisht të shoqëruara me dëmtime të një pjese të konsiderueshme të elementeve të objektit.
- Shumë e keqe: kur ndërtesa ka shembje të ndonjë pjese të strukturës dhe ka shenja të qarta të jo stabilitetit (keqësim në muraturë, dobësim në konstrukcion të kulmit, shfaqje të lagështisë).
- Pjesërisht e rrënuar: kur jo të gjitha pjesët strukturale të ndërtesës dallohen, kanë formë dhe qëndrojnë ende mbi tokë.

Plotësisht e rrënuar: kur struktura e ndërtesës nuk ekziston, ose kur pjesë të strukturës mund t'i hasim të shkapërderdhura në lokacion.



3.3 LISTA TRASHËGIMIA

NË RREZIK 2021

GJENDJA FIZIKE: SHUMË E KEQE

1. Kulla e Sadik Ibishit, Isniq, Deçan
2. Mulliri i Daut Osë Hulaj, Hulaj, Deçan
3. Shtëpia tradicionale e Rushit Këpuskës, Gjakovë
4. Shtëpia tradicionale e Bashkësisë Islame, Gjakovë
5. Kroi i Islom Beut, Gjakovë
6. Mulliri i Hakiut në Verbicë të Zhegocit, Gjilan
7. Shtëpia dhe Oda e Tefik Vehbi Zymberit, Verbicë e Zhegocit, Gjilan
8. Shtëpia e Ajet Kokës, Kokaj, Gjilan
9. Shtëpi banimi në Kokaj e Ilmi Rrustemit, Kokaj, Gjilan
10. Kompleks Arkitektonik, Lagjja e Zmokëve, Burincë, Gjilan
11. Kulla e Xhelë Hajdinit, Terziaj, Gjilan
12. Shtëpia Kullë e Muharrem Currit, Dermjak, Hani i Elezit
13. Shtëpia e Naser Thaçit, Kryenik, Hani i Elezit
14. Lagjja e Bravëve, Puset e Nikës, Hani i Elezit
15. Kulla e Sahit Ibërdemaj, Lluga, Istog
16. Sharra e Qelë Bicaj, Vrellë, Istog
17. Kulla e Hamdi Halil Osmanaj, Trubuhovc, Istog
18. Kulla e Halil Ali Mavraj, Saradran, Istog
19. Shtëpia e Minah Lumës, Gllloboçicë, Kaçanik
20. Shtëpia e Enver Lumës, Gllloboçicë, Kaçanik
21. Shtëpia e Hamdi Demollit, Krilevë, Kamenicë
22. Shtëpia e Demush Ferizit, Zhujë, Kamenicë
23. Shtëpia e Hamdi Arif Rashitit, Velegllavë, Kamenicë
24. Manastiri Rëgjavc, Moçarë, Kamenicë
25. Rrënojat e Mullirit të Urës në Bubël, Malishevë
26. Stacioni i Trenit Lutogllavë, Pejë
27. Xhamia e Shtupecit të Vogël, Pejë
28. Mulliri i Halil Mehmet Bricorit, Bricor, Pejë
29. Përmendorja mbivarrore e Halil Beut në Xhamia e Kurshumlisë, Pejë
30. Kisha e Shën Gjergjit, Sigë, Pejë
31. Ura e Gurit (Ura n'gur), Pejë
32. Shtëpia banimi - Avdullah Avdullahu, Llaushë e Ulët, Podujevë
33. Mulliri në Majac, Majac, Podujevë
34. Shtëpia e Kadri Metehisë, Metehi, Podujevë
35. Shtëpi banimi - Kurtesh Sylejmani, Prishtinë
36. Shtëpia banimi - Shefqet Mehmeti, Prishtinë
37. Shkolla e parë shqipe, Prishtinë
38. Shtëpia banimi - Muharrem Sejdiu, Prishtinë
39. Shtëpi banimi e Idriz Bllacës, Besi, Prishtinë
40. Shtëpia e Mulla Ademit, Keqekollë, Prishtinë
41. Mulliri në Glllogovicë, Prishtinë
42. Mulliri në Grashticë, Prishtinë
43. Shtëpi banimi - Atifete Jusufi, Prishtinë
44. Banim kolektiv - Pronë e Komunës/ Kryqi i Kuq, Prishtinë
45. Shtëpi banimi - Pronë e Komunës, Prishtinë
46. Kulla e Pjetër Prenk Palaj, Zym, Prizren
47. Kazerma e vjeter - Internati, Prizren

- 48.** Shkolla Fillore Emin Duraku, Likovcë, Skënderaj
- 49.** Kulla e Gani Sejdiut, Runik, Skënderaj
- 50.** Kulla e Ramë Sylejman Hoxhës, Plluzhinë, Skënderaj
- 51.** Kulla e Jonuz Hasan Tafollit, Qadrak, Suharekë
- 52.** Kompleksi arkitektonik, Gumnishtë, Vushtrri
- 53.** Kulla e Qelisë, Deçan
- 54.** Mulliri i Dulahit, Mramor, Prishtinë
- 55.** Mulliri i Sani Hoxhës, Shalë, Lipjan

GJENDJA FIZIKE: Pjesërisht e rrënuar

- 56.** Kulla e Haxhë Alisë, Pobergjë, Deçan
- 57.** Shtëpia banimi - Smail Haxhiu, Llukë e Ulët, Deçan
- 58.** Kompleks banimi - Familja Dervisholli, Gradicë, Drenas
- 59.** Mulliri i Babushit, Nerodime, Ferizaj
- 60.** Kulla e Idriz Hereqit, Kralan, Gjakovë
- 61.** Mulliri i Cërmjanit, Gjakovë
- 62.** Kulla e Fetah Kurexhajt, Kurexhaj, Gjilan
- 63.** Kulla e Shaqë Hajdinit, Terziaj, Gjilan
- 64.** Kulla e Hajdin Hajdinit, Terziaj, Gjilan
- 65.** Shtëpi- Kullë e Baki Currit, Dermjak, Hani i Elezit
- 66.** Lagja e Dacajve, Puset e Nikës, Hani i Elezit
- 67.** Kompleks shtëpive i Lagjes Bushtë e Poshtme, Puset e Nikës, Hani i Elezit
- 68.** Kulla e Shaban Turkaj, Kashicë, Istog
- 69.** Kulla e Haxhi Buleshkaj, Istog i Ulët, Istog
- 70.** Kulla e Tahir Gagicës, Velegllavë, Kamenicë
- 71.** Xhamia e Mazhiqit, Mazhiq, Mitrovicë
- 72.** Kulla e Shemi Ahmetit, Zasellë, Mitrovicë
- 73.** Mulli në Jasenovik, Novobërdë
- 74.** Kulla e Sheremetit, Pejë

- 75.** Pojatë - Avdyl Shabani, Metehi, Podujevë
- 76.** Kompleks Banimi në Milevcë (Selim Ismaili), Prishtinë
- 77.** Shtëpi banimi - Imer Berisha, Prishtinë
- 78.** Shtëpi banimi - Fitim Gjata, Prishtinë
- 79.** Ndërtesa e shkollës së mesme Ryzhdije, Prizren
- 80.** Shtëpia e Jonuz Agallarit, Prizren
- 81.** Kulla e Rexhep Thaçit, Burojë, Skënderaj
- 82.** Shtëpia banimi- Fetah Loshi, Pemishte, Skënderaj
- 83.** Mulliri i Berishëve, Suharekë
- 84.** Mulliri i vjetër i familjes Buzhala, Buzhalë, Suharekë
- 85.** Xhamia e Dranocit, Deçan
- 86.** Kulla në Letnicë (e Ivanit), Letnicë, Viti

GJENDJA FIZIKE: E keqe

- 87.** Mulliri i Gjirkokajve
- 88.** Kulla e Zenun Ahmetit
- 89.** Kulla e Sali Gecës
- 90.** Kulla e Bajram Xhafer Lekaj
- 91.** Varri i madh - Sallatash
- 92.** Kulla - Ibish Morina
- 93.** Xhamia e Talinocit të Muhaxherëve
- 94.** Teqja në Mirasalë
- 95.** Shtëpia e Hasan Fazlisë në Koshare
- 96.** Xhamia e Firajës
- 97.** Shkolla e Vjetër e Muzikës
- 98.** Shtëpia tradicionale e Nimon Ferizit
- 99.** Shtëpia tradicionale e Bashkësisë Islame
- 100.** Kulla e Ymer Pogës
- 101.** Shtëpia e Naim Zajmit
- 102.** Shtëpia e vjetër e Jelena Jokiçit

- 103.** Shtëpia e Gjon Lesh Dedajt
- 104.** Shtëpia tradicionale e Bedri Shytit
- 105.** Shtëpia tradicionale e familjes Hoxha
- 106.** Kulla e Musë Rexhepaj
- 107.** Kulla e Osman Bajramit
- 108.** Kulla e Osman Jakupit
- 109.** Shtëpia tradicionale e Osman (Hysen) Ponoshecit
- 110.** Shtëpia e Avdurrahmon Zhubit
- 111.** Koshi i Fevzi Hoxhës
- 112.** Shtëpia - Kullë e Sahit Agës
- 113.** Hambari i Feriz Llashticës në Llashticë
- 114.** Shtëpia e Haxhi Bekteshit
- 115.** Xhamia e fshatit Trubuhovc
- 116.** Kulla e Halil Dervish Sylaj
- 117.** Kulla e Jah Ymerit
- 118.** Mulliri i Sallajve
- 119.** Shtëpia - Kullë e Xhemajl Brahës
- 120.** Mulliri i fshatit Biçec
- 121.** Xhamia në Gurëzi
- 122.** Xhamia në Korbliq
- 123.** Shtëpia e Rahim Riza Rekës
- 124.** Shtëpia e Jusuf Ademit
- 125.** Shtëpia e Sylë Haskut
- 126.** Xhamia në Zhujë
- 127.** Tavani i shtëpisë së Ilmi Murselit
- 128.** Kulla e Pashkë Karadakut - Janjevë
- 129.** Shtëpi me ballkon - Glasnoviq Josipa Maria
- 130.** Shkolla fillore në gjuhën Serbe - 1882
- 131.** Shtëpia e Mirsad Feratit
- 132.** Kulla e Halim Miftarit
- 133.** Shtëpia e familjës Korogli
- 134.** Kisha Katolike në Vinarc të Epërm
- 135.** Mejtepi në Koshtovë
- 136.** Kulla në Zhazhë
- 137.** Shtëpia në Makresh të Epërm (Jovic Bllagojës)
- 138.** Shtëpia e Novobërdalive në Artanë
- 139.** Xhamia në Artanë
- 140.** Shtëpia banimi në Pasjan e Nikolla Trajkoviç
- 141.** Shtëpi banimi në Pasjan e Bozhin Gjorgjeviç
- 142.** Konaku i Kasapollëve
- 143.** Kroni te shtëpia e kulturës "Kajnakut"
- 144.** Kroni i Bajram Bogut
- 145.** Shkolla fillore në Shtupec të Vogël
- 146.** Kulla e Ali Osmanit
- 147.** Kullë e Demë Ahmetit - Tani pronë e Halit Hamitit
- 148.** Shtëpi Banimi Musa Hamiti
- 149.** Koshi në Lladoc
- 150.** Kulla-Xhemajl Haxhiu
- 151.** Shtëpi banimi në Podujevë
- 152.** Shtëpi banimi-pronë e Sabit Hamitit
- 153.** Shtëpi banimi - Sali Safqi
- 154.** Shtëpi banimi - Bujar Gjeli
- 155.** Hamami i Madh
- 156.** Shtëpi banimi - Musli Hoxha
- 157.** Shtëpi banimi (Hyjnilerëve)
- 158.** Shtëpia banimi - Brahim Brahimi
- 159.** Trafo e rrymës
- 160.** Vetfarmi
- 161.** Shtëpi banimi në Kukaj (Daut Xhemshiti)
- 162.** Mulliri në hyrje të fshatit Marec
- 163.** Shtëpia banimi-Mirnije Lleshi
- 164.** Varreza Hebraike në Taukbashqe
- 165.** Stacioni i Trenit
- 166.** Kompleksi i Teqes Sinani

- 167. Tyrbja e Kalendar Babës
- 168. Tyrbja e Musa Efendiut
- 169. Kulla e Tahir Reshitit
- 170. Islahana e vjetër
- 171. Shtëpia e Familjes Berlajolli
- 172. Konsullata Austriake
- 173. Shtëpia e familjes Kirajtani
- 174. Ura e gurit
- 175. Kullë - shtëpia e Qamil Vuqitërnës
- 176. Kulla e Hajrulla Qantes
- 177. Kulla e Ismet Qemeges
- 178. Kroi i Xhem Osmanit
- 179. Shtëpi Banimi-Idriz Hajdari
- 180. Hambari i Iliaz Fazliut
- 181. Hambari i Smajl Veselit
- 182. Mulliri i fshatit Kuqicë
- 183. Kullë - Rexhë Gashi
- 184. Flladnikë - Ramadan Ismaili
- 185. Mulliri i familjes Loshi
- 186. Shtëpia e Ibrahim Ramë Bllacës

- 187. Shtëpia e Haxhi Ahmetit
- 188. Mulliri dhe Velanica e Vishëve nga Verbani i ndërtuar në Binçë
- 189. Xhamia e Gërmovës
- 190. Shtëpi banimi në Letnicë (Nikollë Mita)
- 191. Xhamia në fshatin Goden
- 192. Ura mesjetare me nëntë harqe

LISTA E ASETEVE TË RRËNUARA GJATË PERIU DHËS 2017-2021

1. Kulla e Sadik Rrucës, Junik
2. Kulla e Ramë Stojkaj, Lloqan, Deçan
3. Kulla e Haxhi Mustafës (Met Brahim), Skivjan, Gjakovë
4. Kulla e Ibish Alisë, Brovinë, Gjakovë
5. Kulla e Gani (Elez) Mehmetit, Brovinë, Gjakovë
6. Qardaku i Azem Hamzës Ahmetaj, Lëbushë, Deçan
7. Shtëpia e Veton Hotit, Prishtinë
8. Shtëpia e Ismet Jashar Misinit, Gërmovë, Viti
9. Shkolla e vjetër në fshatin Kaçanik i Vjetër, Kaçanik

3.4 TË DHËNAT E GJENDJES

FIZIKE TË ASETEVE NË TERREN

Gjatë vitit 2021, ekipet e CHWB Kosova vizituan 198 asete të trashëgimisë arkitekturore, gjendja e të cilave u inspekua në terren, dhe u bë krahasimi me gjendjen e tyre të para katër, respektivisht pesë viteve më parë. Raporti paraqet fillimisht asetet të cilat ishin rrënuar në tërësi përgjatë këtyre viteve, pastaj asetet të cilave iu është përkeqësuar gjendja, si dhe asetet të cilat i janë nënshtruar ndërhyrjeve konservuese/restauruese me qëllim të përmirësimit të gjendjes fizike. Të gjitha këto janë ilustruar me fotografi krahasuese, përmes së cilave vërehen më së miri këto ndryshime.

3.4.1. ASETET QË JANË RRËNUAR PLOTËSISHT

Që nga viti 2018 e deri më tani janë rrënuar plotësisht nëntë (9) asete të trashëgimisë arkitekturore. Prej tyre, 7 janë kulla të njohura si: Kulla e Sadik Rrucës në Junik (Fig. 1), Kulla e Ramë Stojkaj në Lloqan, Deçan (Fig. 2), Kulla e Haxhi Mustafës (Met Brahim) në Skivjan (Fig. 3), Kulla e Ibish Alisë (Fig. 5) dhe Kulla e Gani (Elez) Mehmetit, Brovinë, Cjakovë (Fig. 6), dhe së fundmi u rrënuar edhe Qardaku i Azem Hamzës Ahmetaj, Lëbushë, Deçan (Fig.4). Dy shtëpi banimi të njohura në regjistrin e mbrojtjes si: Shtëpia e Veton Hotit në Prishtinë dhe Shtëpia e Ismet Jashar Misinit në Gërmovë (Fig. 7), si dhe 1 shkollë, e njohur si shkolla e vjetër në fshatin Kaçanik të Vjetër. Shkolla e vjetër është rrënuar nga komuna e Kaçanikut e në vend të saj është ndërtuar shkolla e re (Fig. 8). Ndërsa, asetet tjera janë rrënuar nga vet pronarët e tyre, të cilët rrënimin e tyre e kanë arsytuar kryesisht për shkak të gjendjes shumë të keqe fizike në të cilën kanë qenë këto asete dhe rrezikshmërisë që ato paraqisnin për familjet e tyre. Rrënimi/ humbja e aseteve të trashëgimisë kulturore në disa raste lidhet edhe me mungesën e investimeve nga MKRS-ja në kohën e duhur, me ç'rast do të mund të parandalohet një gjë e tillë. Ndër të tjerash, theksohet humbja e Kullës së Ibish Alisë në Brovinë të Cjakovës, e cila konsiderohet të ketë qenë ndër kullat më të veçanta të asaj zone².

*Është me rëndësi të theksohet se numri i aseteve të rrënuara mund të jetë edhe më i madh për shkak se pjesë e këtij hulumtimi ishin gjithsej 198 asete të trashëgimisë ndërtimore të cilat janë inspektuara nga gjithsej 930 asetet sa janë në regjistrin e mbrojtjes.

4.10. Secili person juridik dhe fizik ka për detyrë që të kujdeset për mbrojtjen e tërësisë së trashëgimisë kulturore nëse ai/ajo është pronar, posedues ose shfrytëzues i kësaj trashëgimie kulturore.

4.11. Cilido person fizik apo juridik që dëmton trashëgiminë kulturore, pavarësisht nga marrëdhëniet e tyre pronësore me të, dënohet ose sanksionohet në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, Ligjit për kundërvajtje dhe në pajtim me nenin 11 të këtij ligji.

LIGJI NR. 02/L-88, për Trashëgiminë Kulturore

2 Gajani, O. (18.11.2021) Intervistë përmes telefoni



2016



2021

Fig. 1 Kulla e Sadik Rrucës, Junik

majtë: para rrënimt
[foto e dt.08.2016],
djathtë: ndërtimi i
shtëpisë së re
në vend të kullës
[foto e dt.07.2021]

foto: CHWB Kosova

Fig. 2 Kulla e Ramë Stojkaj, Lloqan, Deçan

majtë: para rrënimt
[foto e dt.07.2016],
djathtë: e rrënuar
[foto e dt.07.2021])

foto: CHWB Kosova



2016



2021



2016



2021

Fig.3 Kulla e Haxhi Mustafës (Met Brahimi), Skivjan, Gjakovë

majtë: para rrëimit
[foto e dt.07.2016],
djathtë: e rrënuar
[foto e dt.08.2021]

foto: CHwB Kosova

Fig. 4 Qardaku i Azem Hamzës Ahmetaj Lëbushë, Deçan

majtë: para rrëimit
[foto e dt.06.2016],
djathtë: e rrënuar
[foto e dt.10.2021]

foto: CHwB Kosova



2016



2021



2016

**Fig. 5 Kulla e Ibish
Alise, Brovinë,
Gjakovë**

majtë: para rrënimit

[foto e dt.07.2016],

foto: CHWB Kosova



2016

**Fig. 6 Kulla e Gani
(Elez) Mehmetit,
Brovinë, Gjakovë**

majtë: para rrënimit

[foto e dt.07.2016]

foto: CHWB Kosova



2016



2021

Fig.7 Shtëpia e Ismet Jashar Misinit në Gërmovë

majtë: para rrënimit
[dt.07.2016],
djathtë: ndërtimi i shkollës
së re në vend të së vjetrës
[dt.08.2021]

Fig. 8 Shkolla e vjetër në fshatin Kaçanik i Vjetër, Kaçanik

majt: para rrënimit
[dt.08.2016],
djathtë: ndërtimi i shkollës
së re në vend të së vjetrës
[dt.08.2021]



2016



2021

3.4.2. ASETET QË I ËSHTË

PËRKEQËSUAR GJENDJA FIZIKE

Gjatë hulumtimit në terren është vërejtur që 26 aseteve të cilat i takonin listës “Trashëgimia në rrezik” i është përkeqësuar edhe më tutje gjendja e tyre fizike. Pothuajse të gjitha këto asete janë të pashfrytëzueshme, andaj përkeqësimi i gjendjes së tyre ka ardhë kryesisht si pasojë e mos-shfrytëzueshmërisë dhe mos-kujdesit ndaj tyre.



2016



2021

**Fig. 9 Shtëpi banimi
Shefqet Mehmeti,
Prishtinë**

majtë: para intervenimit
[dt.07.2016],

djathtë: pas intervenimit
[dt.03.2021]

foto: CHwB Kosova



2016



2021

Fig. 10 Shkolla e parë shqipe, Prishtinë

majtë: gjendja e dt.07.2016,
djathtë: gjendja e
dt.08.2021

foto: CHwB Kosova

**Fig. 11 Shtëpi banimi
– Musli Hoxha,
Prishtinë**

majtë: gjendja e
dt.07.2017,
djathtë: gjendja e
dt.08.2021

foto: CHwB Kosova



2016



2021



2016



2021

Fig. 12 Kulla e Rexhep Thaçit, Burojë, Skenderaj

majtë: gjendja e dt.06.2016,
djathtë: gjendja e dt. 09.2021

foto: CHWB Kosova

Fig. 13 Shtëpia tradicionale e Bashkësisë Islame në Rr. Mithat Frashëri, Gjakovë

majtë: gjendja e dt.07.2016,
djathtë: gjendja e dt.08.2021

foto: CHWB Kosova



2016



2021



2016



2021

Fig. 14 Kulla e Idriz Hereqit, Kralan, Gjakovë

majtë: gjendja e
dt.07.2016,
djathtë: gjendja e
dt.09.2021

foto: CHwB Kosova

**Fig. 15 Mulliri
i Daut Osë Hulaj,
Hulaj, Deçan**

majtë: gjendja e
dt.07.2016,
djathtë: gjendja e
dt.07.2021

foto: CHwB Kosova



2016



2021

Fig. 16 Kulla e Hajdin Hajdinit, Terziaj, Gjilan

majtë: gjendja e dt.07.2016,
djathtë: gjendja e dt.09.2021

foto: CHWB Kosova dhe QRTK Gjilan



2016



2021



2016



2021

Fig. 17 Shtëpi banimi- Fetah Loshi, Pemishtë, Skenderaj

majtë: gjendja e dt.08.2016,
djathtë: gjendja e dt.09.2021

foto: CHWB Kosova

**Fig. 18 Kulla e Halil
Dervish Sylaj,
Istog i Poshtëm,
Istog**

majtë: gjendja e
dt.07.2016,
djathtë: gjendja e
dt.08.2021

foto: CHwB Kosova



2016



2021



2016



2021

**Fig. 19 Kulla e Hamdi
Halil Osmanaj,
Trubuhovc, Istog**

majtë: gjendja e
dt.07.2016,
djathtë: gjendja e
dt.08.2021

foto: CHwB Kosova



2016



2021

Fig. 20 Kulla e Shaban Turkaj, Kashicë, Istog

majtë: gjendja e dt.07.2016,
djathtë: gjendja e dt.04.2021

foto: CHWB Kosova

Fig. 21 Kulla e Pjeter Prenk Palaj, Zym, Prizren

majtë: gjendja e dt.07.2016,
djathtë: gjendja e dt.09.2021

foto: CHWB Kosova



2016



2021



2016



2021

Fig. 22 Xhamia e fshatit Trubuhovc, Istog

majtë: gjendja e dt.07.2016,
djathtë: gjendja e dt.09.2021

foto: CHwB Kosova

Fig. 23 Shtëpia e familjes Korogli, Mitrovicë

majtë: gjendja e dt.07.2016,
djathtë: gjendja e dt.10.2021

foto: CHwB Kosova



2016



2021

Fig. 24 Mulliri i Berishëve, Suharekë

majtë: gjendja e
dt.07.2016,
djathtë: gjendja e
dt.10.2021

foto: CHwB Kosova



2016



2021



2016



2021

Fig. 25 Shtëpia e Novobërdalive në Artanë, Novobërdë

majtë: gjendja e dt.
06.2016,
djathtë: gjendja e dt.
09.2021

*foto: CHwB Kosova
dhe QRTK Gjilan*

3.4.3. ASETET E INTERVENUARA

ME QËLLIM TË PËRMIRËSIMIT TË

GJENDJES FIZIKE

Krahas aseteve së cilave iu është përkeqësuar gjendja fizike, apo të cilat janë rrënuar plotësisht, që nga viti 2017 e deri më tani një numër i aseteve iu është nënshtruar edhe ndërhyrjeve me qëllim të përmirësimit të gjendjes së tyre. Nga viti 2017 është intervenuar në gjithsej 67 asete të trashëgimisë arkitekturore. Prej tyre, 20 asete ishin pjesë e listës trashëgimisë në rrezik dhe atyre në gjendje të keqe fizike. Pjesa dërmuese e këtyre intervenimeve është bërë nga MKRS-ja, ndërsa në vetëm disa prej tyre kanë intervenuar organizatat vendore e ndërkombëtare.

Sipas të dhënave nga Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës për periudhën 2017-2021 numri më i madh i ndërhyrjeve në asetet e trashëgimisë arkitekturore i ka realizuar QRTK-ja e Prizrenit, përderisa QRTK-të tjera kanë dukshëm numër më të vogël të ndërhyrjeve. Më poshtë janë paraqitur intervenimet gjatë vitit 2017-2021 sipas rajoneve. Pjesa më e madhe e ndërhyrjeve kanë qenë ndërhyrje emergjente, kurse një pjesë tjetër edhe ndërhyrje konservuese/ restauruese.

| RAJONI | TË REALIZUARA | TË PAPËRFUNDUARA | NË PROCES TË ZBATIMIT |
|----------------|---------------|------------------|-----------------------|
| QRTK Prizren | 43 | 1 | 3 |
| QRTK Pejë | 11 | 1 | 0 |
| QRTK Gjakovë | 4 | 0 | 6 |
| QRTK Prishtinë | 7 | 0 | 0 |
| QRTK Gjilan | 1 | 0 | 10 |
| QRTK Mitrovicë | 4 | 1 | 0 |

Disa nga arsyet kryesore se përse QRTK në Prizren ka arritur të realizoj një numër kaq të madh të projekteve në raport me QRTK-të e rajoneve tjera lidhen me: kërkesat e tyre të shumta drejtuar MKRS-së për intervenime në asete të trashëgimisë kulturore, Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit ka ndihmuar në përfitime të fondeve si dhe lobimi edhe në grupet parlamentare në Kuvendin e Kosovës për investime në këtë rajon.³

Në pyetjen drejtuar MKRS-së se si bëhet ndarja buxhetore për Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, është thënë se aplikohen kriteret të cilat janë përcaktuara në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe mbi bazën e saj vendosen prioritetet. Shtesë, gjithashtu pranohen edhe kërkesa nga Qendrat Rajonale. Sipas MKRS-së me prioritet trajtohen asetet për të cilat ekzistojnë projektet.⁴

³ Hoxha, S. (03.11.2021) "Re: Lidhur me ndarjen buxhetore të QRTK-ve" Intervistë përmes telefonit dhe emailës.

⁴ Aliu, V. (14.10.2021) "Re: Informatë rreth intervenimeve në TK."

Gjatë takimit në QRTK-në e Gjilanit u theksua se pavarësisht listës prioritare për intervenime emergjente të dërguar çdo vit në MKRS, për pesë vitet e fundit, një numër shumë i vogël prej tyre u morr parasysh.⁵

Njëra ndër shqetësimet e ngritura nga njëra nga QRTK-të është mungesa e kapaciteve të mjaftueshme profesionale interdisiplinare për hartimin e projekteve të restaurimit.⁶

Problem në realizimin e projekteve paraqet edhe vlerësimi i projekteve nga ana e IKMM-së. Ky proces merr shumë kohë derisa është jashtëzakonisht e rëndërishtme që ky vlerësim të bëhet më shpejt, veçanërisht kur bëhet fjalë për masa preventive e intervenime emergjente në asete.⁷

Gjithashtu, QRTK-të kanë shprehur edhe shqetësimin e tyre lidhur me disa asete të trashëgimisë arkitekturore të cilat janë nën pronësi private dhe për të cilat pronarët refuzojnë të pranojnë intervenimet për sanimin e gjendjes së tyre. Disa prej rasteve për të cilat është planifikuar intervenimi mirëpo nuk është pranuar nga pronarët janë: shtëpia e familjes Korogli në Mitrovicë, Konaku i Haki Spahiut në Pejë, shtëpia e familjes Lokvica në Prizren, po ashtu shtëpia e Nimon Ferizit në Gjakovë.

Nga vizita tek kjo e fundit, jemi njoftuar se arsyeja e refuzimit të intervenimit është se investimi i ofruar nga QRTK është konsideruar si i pamjaftueshëm për përmirësimin e gjendjes së asetit përkundër që gjendja e asetit është e rënduar dhe familjarët

Intervistë përmes emailës.

5 *Hoxha, A. (08.10.2021). Intervistë personale.*

6 *Durguti, E. (11.10.2021). Intervistë personale.*

7 *Loxha Vitaku, Rezarta (10.11.2021). Intervistë personale.*

ndihen të rrezikuar gjatë shfrytëzimit të kësaj prone.⁸ Krahas tyre, edhe në Prishtinë është hasur në probleme të ngjashme, ku pronarët kanë refuzuar intervenimet nga QRTK-ja. Raste të tilla ka pasur me Shkollën e Parë Shqipe dhe Shtëpinë banimit të Musli Hoxhës, në të cilat janë kryer masat e para mbrojtëse dhe pastaj pronarët kanë refuzuar të vazhdohet me intervenimet më tutje.

Përgjatë pesë viteve të fundit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka ndarë mjete buxhetore dhe ka filluar ndërtimin e disa ndërtesave të cilat nuk kanë status të mbrojtjes ligjore. Disa nga rastet e këtyre ndërtimeve janë: Kulla e Shaban Manxhollit në Mikushnicë, Skënderaj; Kulla e familjes Fanaj, Vërmicë; Restaurimi i Akademisë së parë ushtarake të UÇK-së në Açarevë; Muzeu i Paqes; Muzeu i Natyrës, e të tjerë. (Listën e plotë mund ta gjeni në kapitullin 5, pika 5.1.2 Buxheti - shpenzimet financiare të këtij raporti)

Ndërkohë, në vitin 2018 ishin nënshkruar kontrata për intervenime emergjente në disa asete të trashëgimisë arkitekturore në Rajonin e Gjakovës, Gjilanit, Prizrenit e Mitrovicës. Nga këto kontrata vetëm disa në një numër të vogël të aseteve janë kryer punime, mirëpo edhe ato kanë mbetë të papërfunduara. Ndërsa, në asetet tjera të planifikuara sipas kontratës nuk kanë filluar fare punimet. Për këtë arsye MKRS është detyruar që t'i ndërpres kontratat me operatorin për shkak mosrealizimit të kontratës.

8 *Intervistë me pronarin e Shtëpisë tradicionale të Nimon Ferizit në Gjakovë (23.08.2021).*

Për momentin, sipas të dhënave të marra nga QRTK-të, janë duke u realizuar ndërhyrjet në 19 asete të trashëgimisë ndërtimore, përderisa është edhe një numër i aseteve të cilat janë në procedurë të kontraktimit, dhe të cilat priten të fillojnë me zbatim në momentin e nënshkrimit të kontratave nga MKRS.

Vërejtje: Në këtë raport nuk është bërë vlerësimi i cilësisë së intervenimit në çfarëdo aspekti, mirëpo është dokumentuar vetëm gjendja e tanishme në raport me gjendjen paraprake.



2016



2021

Fig.26 Shtëpia e familjes Okqaboll, Prizren

majtë: para intervenimit [dt.07.2016], djathtë: pas intervenimit [dt.03.2021]

Intervenimi: QRTK Prizren

foto: CHWB Kosova



2016



2021

Fig. 27 Shtëpia e familjes Ereneit, Prizren

majtë: para intervenimit
[dt.07.2016],
djathtë: pas intervenimit
[dt.03.2021]

Intervenimi: QRTK Prizren

foto: CHWB Kosova

Fig. 28 Mulliri i Rexhep Shatrit, Dedaj, Prizren

majtë: para intervenimit
[dt.07.2016],
djathtë: pas intervenimit
[dt.03.2021]

Intervenimi: QRTK Prizren

foto: CHWB Kosova



2016



2021



2016



2021

Fig. 29 Shtëpia e familjes Bërlajolli, Prizren

majtë: para intervenimit [dt.07.2016],
djathtë: pas intervenimit [dt.03.2021]

Intervenimi: QRTK Prizren

foto: CHWB Kosova

Fig. 30 Shtëpia e Mirsad Feratit, Mitrovicë

majtë: para intervenimit [dt.07.2016],
djathtë: pas intervenimit [dt.09.2021]

Intervenimi: QRTK Mitrovicë

foto: CHWB Kosova



2016



2021



2016



2021

**Fig. 31 Mulliri i
Avdyl Zenel Jasiqit,
Gramaqel, Deçan**

majtë: para intervenimit
[dt.07.2016],
djathtë: pas intervenimit
[dt.07.2021]

Intervenimi: CHwB Kosova

foto: CHwB Kosova

**Fig. 32 Kulla e Fazli
Buqollit, Raushiq,
Pejë**

majtë: para intervenimit
[dt.07.2016],
djathtë: pas intervenimit
[dt.03.2021]

Intervenimi: QRTK Pejë

foto: CHwB Kosova



2016



2021



2016



2021

Fig. 33 Kulla e Zeqir Hakaj, Orrobërdë, Istog

majtë: para intervenimit [dt.07.2016],
djathtë: pas intervenimit [dt.09.2021]

Intervenimi: QRTK Pejë

foto: CHWB Kosova

Fig. 34 Xhamia në Syriganë, Skënderaj

majtë: para intervenimit [dt.08.2016], djathtë: pas intervenimit [dt.09.2021]

Intervenimi: Drejtoria e përgjithshme e Vakëfeve,
R. e Turqisë

foto: CHWB Kosova



2016



2021

4. DËMTIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE NË TRI VITET E FUNDIT (2018-2020)

Inspektorati për Trashëgimi Kulturore që ka statusin e Departamentit pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2018 ka raportuar se ka bërë vizita të vazhdueshme inspektuese në asetet e trashëgimisë kulturore, ku ka ndaluar në 13 raste punimet e paautorizuara (4 në Prishtinë, 7 në Prizren dhe 2 në Deçan) si dhe për dëmtuesit e trashëgimisë kulturore ka proceduar 6 kallëzime penale (5 në Prizren dhe 1 në Pejë).

Këshilli Gjyqësor i Kosovës për periudhën 2018-2020, për vepra penale të ndërlidhura me trashëgiminë kulturore duke përfshirë por mos u kufizuar tek: veprat penale të parapara nën 321, paragrafi 1 dhe 3 dhe nën 354 dhe 344 të Kodit Penal, në nivel vendi ka ndërmarrë një sërë veprimesh.

Në vitin 2018 për dëmtimin, shkatërrimin dhe nxjerrjen e paautorizuar të monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka raportuar: 5 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese dhe 5 lëndë të pranuar në punë, raste të dëmtimit, shkatërrimit dhe nxjerrjes së paautorizuar të monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës. Nga këto ka dhënë 2 dënime me kusht për dëmtimin, shkatërrimin dhe nxjerrjen e paautorizuar të monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës dhe 8 lëndë ish-in të pazgjidhura deri në fund të 2018. Për veprën penale Punime të paautorizuara dhe përvetësimi i monumenteve të Kulturës për vitin 2018, KGJK ka raportuar 1 lëndë të pazgjidhur në fillim të periudhës raportuese dhe 1 lëndë të pranuar në punë.

Sipas Inspektorati për Trashëgimi Kulturore në vitin 2019 ka ngritur 2 kallëzime penale dhe ka ndërmarrë 27 veprime në nivel të Kosovës për ndërprejren e punimeve të paautorizuara në asetet e trashëgimisë kulturore dhe në disa raste ka obliguar palët që t'i përmbahen projekteve të aprovuara nga organet kompetente të institucioneve të trashëgimisë kulturore. Nga këto 2 raste të ndalimit të punimeve, 1 është kërkesë për pezullim të lejes, 1 rast i obligimit të

palës për largimin e objekteve reklamuese nga aseti i trashëgimisë kulturore dhe 1 kërkesë për fillimin e procedurave kundërvajtëse janë ndërmarrë në Komunën e Prishtinës, kurse 1 rast i ndalimit të punimeve dhe 1 kërkesë për fillimin e procedurave kundërvajtëse në Komunën e Pejës.

Në vitin 2019 për dëmtimin, shkatërrimin dhe nxjerrjen e paautorizuar të monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka raportuar: 7 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese dhe 4 lëndë të pranuar në punë. Nga këto ka dhënë 2 dënime me kusht dhe 6 lëndë janë të pazgjidhura deri në fund të 2019. Për veprën penale Punime të paautorizuara dhe përvetësimi i monumenteve të Kulturës për vitin 2019, KGJK ka raportuar 1 lëndë të pazgjidhur në fillim të periudhës raportuese dhe 1 lëndë të pranuar në punë.

Inspektorati për Trashëgimi Kulturore gjatë vitit 2020 ka ndërmarrë veprime për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore duke ndaluar punimet dhe duke obliguar palët për kthim të aseteve në gjendje të mëparshme në 15 raste (2 raste në Pejë, 7 raste në Prishtinë, 4 raste në Prizren, 1 rast në Kamenicë dhe 1 rast në Klinë). Ka ngritur 3 Kallëzime penale (2 kallëzime penale në Prizren dhe 1 kallëzim penal në Prishtinë). Gjithashtu ka kërkuar fillimin e procedurave kundërvajtëse në 3 raste (1 rast në Deçan, 1 rast në Prishtinë dhe 1 rast në Gjakovë).

4.1. DËMTIMI I TRASHËGIMISË

KULTURORE NË KOMUNËN


E PRISHTINËS

Në Komunën e Prishtinës **gjatë vitit 2018 Inspektorati për Trashëgimi Kulturor** ka evidentuar 1 rast të shkeljes së procedurave dhe dokumentacionit për vendosjen e objektit montazh në oborrin e Muzeut Kombëtar; 2 raste të ndalimit të punimeve: ndalim të punimeve për Komunën e Prishtinës deri në marrjen e lejes nga IKMM tek ish-sheshi “Vëllazërim Bashkimi”si dhe ndalim të punimeve në shkollën “Elena Gjika” deri në pajisjen me leje nga organet kompetente të Trashëgimisë Kulturore; 3 raste të obligimit për largimin e objekteve që pengojnë vizurat në asetet e TK: obligim për largimin e makinerive bujqësore (pjesë e një panairi) nga afërsia e asetit të TK “Newborn” të cilat kanë penguar vizurat, obligim për largimin e reklamave të një banke private nga afërsia e asetit të TK “Newborn” të cilat kanë penguar vizurat, obligim për pajisje me leje nga IKMM për vendosjen e reklamave në fasadën e “Hotel Grand”, në të kundërtën të hiqen reklamat.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për vitin 2018 në Komunën e Prishtinës ka raportuar 8 raste të inicuar të dëmtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe 8 raste të dërguara në prokurori për dëmtimin e objekteve të trashëgimisë kulturore.

Gjykata Themelore në Prishtinë për vitin 2018 ka raportuar 2 lëndë në punë për veprën penale dëmtimi, shkatërrim dhe nxjerrje e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës dhe ka raportuar 2 lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese për të njejtën veprë.

Dëmtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prishtinës në vitin 2018




Në vitin 2019 nga **Inspektorati për Trashëgimi Kulturore** në Komunën e Prishtinës janë evidentuar 3 raste të ndalimit të punimeve: ndalim i punimeve lidhur me ndërhyrjet pa leje në oborrin e shkollës “Elena Gjika” aset i trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme me numër unik 2712; Vendimi nr. 03/2019 lidhur me asetin e trashëgimisë kulturore Biblioteka Kombëtare “Pjetër Bogdani” i përfshirë në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme me numër unik 3639; dhe Vendimi nr. 08/2019 lidhur me asetin e trashëgimisë kulturore “Hotel Grand” përfshirë në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme me numër unik 4235. Gjithashtu është bërë 1 kërkesë për pezullim të lejes kur tek Galeria e Arteve “Agim Cavderbasha” në Prishtinë është konstatuar se po ndërtohet një pompë e benzinës pa pëlqim nga institucionet e trashëgimisë. Prandaj i është kërkuar Drejtorisë të Urbanizmit që të pezullojë lejen dhe e cila ka njoftuar që leja është pezulluar. Një kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse nga Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore i është drejtuar Policisë së Kosovës për fillimin e hetimeve në lidhje me dëmtimin e “Pitosit” nga punonjësit e Institutit të Kosovës për mbrojtjen e monumenteve. Ndërsa, pas refuzimit nga QRTK Prishtinë për lejimin e vendosjes së reklamave në fasadat e “Hotel Grand”, Inspektorati për Trashëgimi Kulturore ka lëshuar vendim ku ka obliguar palën për largimin e panove reklamuese nga aset i trashëgimisë kulturore.

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë për Komunën e Prishtinës në vitin 2019 ka njoftuar për 3 raste të inicuar të dëmtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe 3 raste të dërguara në prokurori për dëmtimin e objekteve të trashëgimisë kulturore në Komunën e Prishtinës.

Gjithashtu, **Gjykata Themelore në Prishtinë për vitin 2019** ka raportuar 2 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese për veprën penale dëmtimi, shkatërrim dhe nxjerrje e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës; 2 lëndë në punë dhe 2 lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese për të njejtën veprë.


Dëmtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prishtinës në vitin 2019



Gjatë vitit 2020 sipas **Inspektoratit për Trashëgimi Kulturore** janë evidentuar 4 raste të ndalimit të punimeve: ndalim i punimeve në “Shkollën e parë shqipe në Prishtinë”, ndalim i punimeve të “NEWBORN” në Prishtinë, ndalim i punimeve në Bibliotekën Kombëtare në lidhje me rregullimin e platosë, ndalim i punimeve tek “Xhamia e Pirinazit” në Prishtinë dhe ndalim i punimeve të “Hotel Grand”. Gjithashtu në një rast është obliguar pala për largimin e objekteve reklamuese nga aseti i trashëgimisë kulturore, ndërtesa e Bibliotekës Kombëtare. Nga ITK është bërë edhe një kallëzim penal për “Shkollën e parë shqipe”.

Policia e Kosovës për vitin 2020 ka njoftuar për 4 raste të inicuar të dëmtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe 4 raste të dërguara në prokurori për dëmtimin e objekteve të trashëgimisë kulturore.

Dëmtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prishtinës në vitin 2020



4.2. DËMTIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOMUNËN E PEJËS


Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore në vitin 2018 për Komunën e Pejës ka bërë 1 kallëzim penal për vepër penale ndaj monumenteve të mbrojtura kulturore ashtu siç sanksionohet me Kodin Penal të Kosovës.

Dëmtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Pejës në vitin 2018




Gjatë vitit 2019 Inspektorati për Trashëgimi Kulturore ka evidentuar 1 rast të ndalimit të punimeve për ndërhyrjet në Xhaminë Taftali në Pejë, aset i trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme me numër unik 1144. Gjithashtu ka bërë 1 kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj shfrytëzuesit të asetit të trashëgimisë “Kulla e Pashës” në Pejë për dhënien në shfrytëzim pa u respektuar procedurat siç parashihen në dispozitat e ligjit për trashëgimi kulturore.

Dëmtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Pejës në vitin 2019



Në vitin 2020 Inspektorati për Trashëgimi Kulturore ka evidentuar 2 raste të ndalimit të punimeve: ndalim i punimeve në shtëpinë e “Boro Vukmiroviç” dhe ndalimin e punimeve të “Kalaja e Lipës” në Pejë.

Dëmtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Pejës në vitin 2020



4.3. DËMTIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOMUNËN E PRIZENIT

Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore gjatë vitit 2018 në Komunën e Prizrenit ka raportuar 5 kallëzime penale për vepra penale kundër monumenteve të mbrojtura siç sanksionohen me Kodin Penal të Kosovës. Gjithashtu, ka raportuar 7 raste të ndalimit të punimeve: Ndalim i punimeve për tejkallim të projektit të apovuar nga institucionet e trashëgimisë kulturore për objektin “Tyrbja e Axhiz Babës” në kompleksin e Marashit; Ndalim i punimeve pa pëlqim


të institucioneve kompetente tek rruga “Pushkatarët”; Ndalim i punimeve në afërsi të aseteve të trashëgimisë “Hani dhe Nallbani” të familjes Kovaçi dhe Kishës së Zonjës Ndihmëtare deri në marrjen e pëlqimit nga institucionet kompetente për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; Ndalim i punimeve restauruese në shtëpinë e familjes Shehu deri në marrjen e pëlqimit nga institucionet kompetente për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; Ndalim i punimeve të rrugëve Brenda QHP nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike deri në marrjen e pëlqimit nga institucionet kompetente për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; Ndalim i punimeve dhe rrenim i pjesës së tejkalluar nga pëlqimi për objektin brenda QHP me pronar Albert Gjonaj dhe ndalim i punimeve për vendosjen e kioskut të “Kujtesa net” në “Sheshin e Dëshmorëve” Brenda QHP pa pëlqimin e organeve kompetente për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Policia rajonale e Prizrenit gjatë vitit 2018 ka raportuar 3 raste të inicuar për dëmtimin e trashëgimisë kulturore dhe 3 raste të proceduara në prokurori.

Prokuroria Themelore e Prizrenit gjatë vitit 2018 ka pranuar 7 raste të kallëzimeve penale për dëmtimin e trashëgimisë kulturore për të cilat ka ngritur 5 aktakuza pranë Gjykatës Themelore në Prizren për veprën penale dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrje e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës nga neni 354 i Kodit Penal.

Gjykata Themelore në Prizren për vitin 2018 ka raportuar 4 lëndë të pranuar për veprën penale dëmtimi, shkatërrim dhe nxjerrje e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës për të cilat ka dhënë 4 dënime me gjobë për veprën penale dëmtimi, shkatërrim dhe nxjerrje e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës.

Dëmtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prizrenit në vitin 2018



Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore gjatë vitit 2019 në Komunën e Prizrenit ka raportuar 8 raste të ndalimit të punimeve: Ndalim i punimeve dhe obligim për mënjanim të parregullsive gjatë zbatimit të projektit të aprovuar nga QRTK në Prizren në afërsi të “Teqes


Halveti” brenda QHP; Obligim i OJQ “Dokufest” për largimin e reklamave nga Ura e Gurit, aset i trashëgimisë kulturore brenda QHP; Ndalim i punimeve tek ish-NLB banka deri në marrjen e pëlqimit nga ana e institucioneve kompetente për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; Ndalim i punimeve lidhur me rastin e tejkalimit të lejes së dhënë nga QRTK në Prizren nga investitori Refki Foki, brenda QHP; Ndalim i punimeve lidhur me rastin e tejkalimit të lejes së dhënë nga QRTK në Prizren nga investitori Munir Hacan, brenda QHP; Ndalim i punimeve të paautorizuara në sheshin Shatërvan brenda QHP; Ndalim i punimeve lidhur me rastin e tejkalimit të lejes së dhënë nga QRTK në Prizren nga investitori Mërgim Shkreli, brenda QHP dhe ndalim i veprimeve të paautorizuara në rrugën “Marin Barleti” brenda QHP. Gjithashtu ka raportuar 1 kallëzim penal për dëmtimin e shtëpisë tradicionale të “Sava Toskës” në Prizren.

Policia rajonale e Prizrenit gjatë vitit 2019 ka raportuar 9 raste të inicuaru për dëmtimin e trashëgimisë kulturore dhe 9 raste të proceduara në prokurori.

Prokuroria Themelore e Prizrenit gjatë vitit 2019 ka pranuar 4 raste të kallëzimeve penale për dëmtimin e trashëgimisë kulturore për të cilat ka ngritur 3 aktakuza pranë Gjykatës Themelore në Prizren për veprën penale dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrje e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës nga neni 354 i Kodit Penal.

Gjykata Themelore në Prizren për vitin 2019 ka raportuar 2 lëndë të pranuaru për veprën penale dëmtimi, shkatërrim dhe nxjerrje e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës për të cilat ka dhënë 2 dënime me gjobë për veprën penale dëmtimi, shkatërrim dhe nxjerrje e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës.

Dëmtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prizrenit në vitin 2019



Sipas **Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Prizren, gjatë vitit 2020** janë evidentuar 3 raste të dëmtimeve në ndërtesat e trashëgimisë kulturore dhe 12 raste të punimeve të paautorizuara apo tejkalim të kushteve të pëlqimit, ku në 2 raste punimet e paautorizuara janë realizuar nga organet komunale.

Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore gjatë vitit 2020 ka evidentuar 4 raste për ndalim punimesh dhe obligim të palëve për kthim të

aseteve në gjendje të mëparshme. ITK gjithashtu ka paraqitur 1 kallëzim penal.

Këshilli për Trashëgimi Kulturore i Qendrës Historike të Prizrenit ka përmendur 4 raste të aktiviteteve pa leje e pa shqyrtim në këtë zonë, sikur se edhe ndërrimin e vitrinave të lokaleve. KTK ka konfirmuar se sfidat që identifikohen në Qendrën Historike janë të shumta, “duke filluar me ndërtimet, aktivitetet pa leje (mbyllja e terasave para lokaleve me PVC apo qelq dhe konstruksion metali), vendosja e reklamave ndriçuese në ballore të lokaleve (më shumë se 1m2 dhe me dizajne të pa përshtatshme), mos menaxhimi i mirë i mbeturinave dhe vendndodhja e kontejnerëve e mbeturina rrugore me numër të madh të cilat nuk largohen, parkingje ilegale dhe uzurpimi i trotuareve me vetura, qasja e automjeteve pa leje brenda Sheshit të Shadërvanit, ngasja me veturë mbi monumente (Urën e vjetër të Gurit) e shumë çështje dhe aktivitete tjera të cilat mendojmë se duhet të diskutohen”

Drejtorja e Inspektorateve në Komunën e Prizrenit ka bërë të ditur se gjatë vitit 2020 ka identifikuar shkelje në 10 objekte në zonat e trashëgimisë kulturore në Prizren, me ç’rast ka shqiptuar 6 gjoba mandatore dhe 4 kallëzime penale, si dhe ka nxjerrë 3 vendime për rrënim.


Policia Rajonale e Prizrenit ka theksuar se gjatë vitit 2020 janë iniciuar 8 raste, ku 4 nga ato janë proceduar në prokurori dhe 4 janë nën hetime.

Prokuroria Themelore në Prizren ka pohuar se gjatë vitit 2020 lidhur me dëmtimin e trashëgimisë kulturore në Prizren ka pranuar 3 kallëzime penale kundër 3 personave të dyshuar. Kjo prokurori vitin e kaluar për veprën penale dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrje

e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës nga neni 354 i Kodit Penal, në 3 kallëzime penale kundër 3 personave ka ngritur aktakuzë pranë Gjykatës Themelore në Prizren.

Gjykata Themelore në Prizren për vitin 2020 ka njoftuar se për veprat penale nga neni 354, janë të evidentuara 4 raste, ku në 1 rast kjo gjykatë ka nxjerr aktgjykimin me urdhër ndëshkimor, përkatësisht dënim me gjobë, derisa 3 lëndë tjera janë në punë.

Dëmtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prizrenit në vitin 2020



5. PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

Nga këndvështrimi dinamik i ndryshimeve, është e domosdoshme që praktikat për integrim të informatave të monumenteve në planifikim hapësinor të jenë të përditësuara dhe në monitorim të vazhdueshëm. Për këto dhe shumë çështje tjera që lidhen me planifikimin hapësinor dhe trashëgiminë kulturore kërkohet qasje strategjike, angazhim i të gjithë akterëve që jetojnë, punojnë ose administrojnë hapësirën. Mbi të gjitha, ky proces përbën një përgjegjësi të madhe politike dhe qytetare.

Politikat zhvillimore në vend, sot i kanë vendosur hartat zonale si dokumente strategjike - bazë për planifikim hapësinor. Qëllimi i këtij kapitulli është pikërisht ky, të analizohet se sa politikat e institucioneve përgjegjëse kanë qenë në gjendje të trajtojnë dhe përfshijnë trashëgiminë kulturore si pjesë integrale në përpilimin e Hartave Zonale.

Për përpilimin e këtij dokumenti strategjik kombëtar, përveç tjerash është nevojitur edhe bashkërendim ndërinstucional. Ky kapitull do të paraqes bashkëpunimin në procesin e integrit të sektorit të trashëgimisë kulturore në këtë dokument të rëndësishëm, se si është trajtuar sektori i trashëgimisë kulturore përgjatë procesit të përpilimit të Hartës Zonale, se a është ndërtuar strukturë e menaxhimit të të dhënave për sektorin e trashëgimisë kulturore në kuadër të Hartës Zonale dhe sa përdorshme është kjo bazë e të dhënave nga sektorët tjerë me interes për planifikim dhe zhvillim?

Për të marrë përgjigje në këto pyetje janë konsultuar dokumente dhe raporte zyrtare të publikuara nga institucionet dhe organizatat që merren me sektorin e Planifikimit dhe Trashëgimisë Kulturore. Gjithashtu janë zhvilluar intervista me përgjegjës të institucioneve relevante të ngarkuara me përpilim të HZKos: Departamentin e Planifikimit Hapësinor në kuadër të MMPH-së, Departamentin e Trashëgimisë Kulturore në kuadër të MKRS-së si dhe intervista me

përgjegjës të Shoqërisë Gjermane për bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ Kosova). Në rrafshin lokal me: përgjegjës të komunës së Leposviqit, Podujevës dhe Prishtinës. Për më tepër janë vizituar edhe sajte të caktuara të trashëgimisë kulturore.

Duke u bazuar në të gjeturat, ky kapitull do të ofrojë konkluzione mbi sfidat kryesore të planifikimit dhe menaxhimit hapësinor dhe rekomandime për autoritetet që t'i tejkalojnë ato.

5.1. PËRPILIMI I HARTËS ZONALE TË KOSOVËS

Harta Zonale e Kosovës është dokument i planifikimit hapësinor i nivelit qëndror, në pajtim me dispozitat e nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-174. Qëllimi kryesor i këtij ligji është: “të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barazpeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës, si vlerë e përgjithshme kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore”.⁹ Sipas po këtij ligji, MMPH është institucioni përgjegjës për hartimin dhe bashkërendimin e HZK¹⁰, ndërsa Qeveria e Kosovës është subjekti përgjegjës për shqyrtimin e dokumentit, i cili përfundimisht aprovohet nga Kuvendi i Kosovës. Deri më sot, edhe pas 7 viteve të miratimit të ligjit për planifikim, autoritetet qëndrore dhe lokale nuk kanë arritur të përmbyllin në tërësi procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe si rezultat HZKos mbetet ende e pa aprovuar.

⁹ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/ nr. 30/ 23 gusht, 2013
¹⁰ Harta zonale e Kosovës 2020-2028+

Karshi obligimeve të nivelit qëndror edhe autoritetet lokale kanë përgjegjësi përpilimin e hartës zonale komunale. Nëse krahasohet me dokumentet tjera të nivelit komunal, harta zonale e komunës nuk është një strategji e përgjithshme p.sh. siç është PZHK-ja. Ajo përcakton se çka ligjërisht mund të bëhet me pronën. Rrjedhimisht, ka për detyrë ta përkthejë strategjinë zhvillimore komunale për gjithë territorin, duke integruar të gjitha elementet sektoriale me nevojat tematike dhe të shenjtojnë ato në hartë.¹¹ Për t'ia lehtësuar nivelit lokal këtë proces, MMPH ka aprovuar Udhëzimin Administrativ nr. 24/2015 mbi kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e hartës zonale të komunës.

Tutje, HZKos do të vendosë kushtet zhvillimore të obligueshme për të gjitha subjektet pjesëmarrëse në implementim. Të gjithë sektorët e rëndësishëm dhe strategjitë përkatëse të Qeverisë së Kosovës janë të përfshirë në procesin e hartimit të këtij dokumenti.¹² Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturorë 2017-2020, është dokumenti i konsultuar për fushën gjegjëse.

Por, sa këto dokumente strategjike të konsultuara për përpilim të Hartës Zonale, i përmbushin nevojat si bazë për planifikim dhe zhvillim?

Kualiteti i dokumenteve strategjike varet në masë të madhe nëse sistemi i monitorimit funksionon në mënyrë të duhur dhe anasjelltas.¹³ Ndërsa monitorimi i zbatimit të strategjive në Kosovë del të jetë segmenti më i dobët i sistemit të planifikimit strategjik në Qeveri.¹⁴

¹¹ Udhëzues për hartim dhe miratim të hartës zonale të komunës, USAID, 2017

¹² Draft- Harta zonale e Kosovës 2020-2028+

¹³ Analiza e Strategjise Kombetare të TK-se, Ruzhdi Halili

¹⁴ Koncept Dokumenti për Sistemin e monitorimit dhe vlerësimin për Reformën e Administratës Publike 2015-2020 në Kosovë

Rekomandimet e dalura nga Analiza për Strategjinë Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, hartuar nga Ruzhdi Halili në 2019, nënvizojnë nevojën e rishikimit të këtij dokumenti në një periudhë sa më afatshkurtë, për formulim të objektivave që mbështeten në analizën e situatës dhe problemeve, nevojën për ndërlidhje dhe harmonizim me dokumentet tjera planifikuese, etj.

Lënë anash dokumentet dhe duke kaluar në analizën e gjendjes në terren, del që edhe kjo e fundit nuk qëndron më mirë.

Shumë objekte, tërësi dhe zona të dëshmuara të trashëgimisë kulturore, çdo ditë e më shumë po e humbin vlerën e tyre. Në disa qytete të Kosovës nuk mund të flitet më për qendrat e vjetra të tyre. Këto zona dhe objekte, janë lënë në mëshirën e zhvillimeve të pakontrolluara, pa ndonjë kriter dhe plan paraprak, të shtyra prej interesave të ndryshme, që tregohen si shkaktarët kryesor të një gjendjeje të tillë.¹⁵

Pas reflektimit në këto dy rrafshë që përbëjnë realitetin e gjendjes aktuale në Kosovë, shpresa për përmirësim të situatës është evidente. Vendosja në letër dhe zbatimi në terren i kritereve për planifikim dhe zhvillim, mbetet crucial për të ardhmen e TK.

¹⁵ Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor, CHWB, 2011

5.1.1. NUMRI I MONUMENTEVE TË PËRFSHIRA NË HARTËN ZONALE TË KOSOVËS

Qindra mijëra organizata në gjithë botën, shfrytëzojnë GIS-in për të krijuar harta që komunikojnë, kryejnë analiza, ndajnë informacione dhe zgjidhin probleme komplekse. Aty mund të analizohet vendodhja hapësinore dhe mund të organizohen shtresa të informacionit duke përdorur harta dhe skena 3D. Kjo krijon mundësi më të thella në të dhënat e mbledhura, krijon mardhënie dhe situata që i mundësojnë përdoruesit të marrin vendime të duhura për sektorë të caktuar.

Shfrytëzimi i këtij softueri, është i obliguar edhe për Kosovën, në bazë të UA 24/2015. Pjesa Hartografike e Hartës Zonale duhet të përmbajë hartat e integruara sipas fushave e tematikave zhvillimore të tërë hapësirës, të përgaditur në sistemin zyrtar të planifikimit hapësinor në një platformë GIS.¹⁶

Përdorimi i GIS dhe SPAK gjatë sistemimit dhe përpunimit të të dhënave dhe analizave, lehtëson menaxhimin dhe kontrollin e të dhënave voluminoze, si dhe mundëson një analizë të ndërsjelltë në mes tematikave të ndryshme në mënyrë më të shpejtë dhe më të saktë.¹⁷

¹⁶ Udhëzimi Administrativ MMPH-Nr. 24/2015

¹⁷ Udhëzues për hartim dhe miratim të hartës zonale të komunës, USAID, 2017




Fig. 1a Shembull i zhvillimit të analizave me anë të softuerit GIS në Poloni¹⁸

¹⁸ <https://doi.org/10.1051/e3sconf/20186300015>




Fig. 1b Shembull i zhvillimit të analizave me anë të softuerit GIS në

Për një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të trashëgimisë kulturore, që për bazë ka planifikimin hapësinor, përveç tjerash janë të nevojshme edhe saktësia dhe përditësimi i të dhënave.

Identifikimi dhe regjistrimi i të dhënave për numrin, gjendjen dhe shtrirjen e objekteve dhe tërësive me vlera të trashëgimisë kulturore, ndikon drejt arritjes së synimit për mbrojtjen e identitetit

19 <https://doi.org/10.1051/e3sconf/20186300015>

dhe të vlerave të trashëguara kulturore – historike dhe që përmes zhvillimit të turizmit kulturor të arrihet edhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në nivelin lokal dhe qendror.²⁰

Meqenëse rëndësia e vendosjes së monumenteve në Hartë Zonale del të jetë e madhe, numri i monumenteve prezente në hartë nuk e reflekton këtë. Në intervistën e zhvilluar me stafin e Institutit për Planifikim Hapësinor, shihet që vetëm dy listat zyrtare të MKRS-së, ajo e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme dhe ajo për mbrojtje të përhershme, janë burime të informacionit për integrim të monumenteve në Hartë Zonale.

Gjithsej janë 1620 monumente nën mbrojtje të përkohshme, 23 monumente nën mbrojtje të përhershme dhe 45 ZVM që shfaqen në HZKos.




Fig. 2a Llojet e aseteve të TK dhe kategoritë e TK (nën mbrojtje të përkohshme) në HZKos

20 *Indikatorët për planifikim hapësinor në Kosovë, IPH, 2017*




Fig. 2b Llojet e aseteve të TK dhe kategoritë e TK (nën mbrojtje të përkohshme) në HZKos

Institucionet vartëse të MKRS-së janë të obliguara të kenë edhe inventarin e aseteve të trashëgimisë kulturore, e që ky inventar potencialisht dikur do të mund të bëhet pjesë e listave zyrtare për asete të mbrojtura. Këto lista të identifikuar nga zyrtarët e institucioneve gjegjëse janë pothuajse po aq të rëndësishme sa edhe asetet që gëzojnë status ligjor.

Sipas Rregullores 05/2008 dhe Udhëzuesit për Inventarizim të Pasurive të Trashëgimisë Kulturore, inventarët duhet të krijohen për kategori të ndryshme të aseteve të trashëgimisë kulturore, qoftë të paluajtshme, luajtshme apo shpirtërore.

Mirëpo, këto lista që supozohet t'i kenë Qendrat Regjionale të Trashëgimisë Kulturore, nuk janë marrë fare parasysh përgjatë përpilimit të HZKos. Sipas IPH, me këto dhe tjera infomata lidhur me listat që i posedojnë qoftë komunat apo QRTK-të, do të duhej të merreshin autoritetet lokale.

Në intervistën e zhvilluar më përfaqësues të GIZ,- përgjegjës për përilimin e HZKos në 8 komuna të Kosovës (Podujevë, Pejë, Drenas, Lipjan, Gjilan, Kamenicë, Malishevë dhe Han i Elezit) nënvizohet fakti se TK nuk është trajtuar si duhet karshi Hartave Zonale Komunale.²¹

Nëse analizohet HZKom e Podujevës, e cila është në fazën finale, shihen mospërputhje të informatave rreth aseteve të TK-së. Përderisa në HZKos asetet e trashëgimisë kulturore janë të listës nën mbrojtje të përkohshme të shpallura në vitin 2019 me të gjitha kategoritë, HZKom e Podujevës e bënë këtë duke u thirrur në listën e shpallur të vitit 2017. Gjithashtu kategoritë tjera të aseteve të mbrojtura nuk shfaqen fare, përveç atyre arkitektonike dhe arkeologjike.

Në anën tjetër IPH në kuadër të MMPH është autoriteti i cili i aprovon Hartat Zonale të Komunave.

²¹ Intevistë me Shkelqim Daci, Planer urban, GIZ

5.1.2. INFORMATAT (LLOJI, FORMATI, STANDARDI)

Për të shfrytëzuar mundësitë që i ofron GIS për mbrojtje të trashëgimisë kulturore, mbledhja e informatave është kruciale dhe pa to nuk mund të ketë efekt prezenca e aseteve në hartë. Hapi i parë dhe më i rëndësishmi që një aset të bëhet pjesë e këtyre analizave, është posedimi i informatës për vendndodhje të asetit, - të dhënat e sakta gjeografike. Meqenëse kemi të bëjmë me hartë, referenca gjeografike e monumentit është e patjetërsueshme dhe duhet të jetë mjaft precize. Në anën tjetër, secila e dhënë që korrespondon me gjendjen reale të monumentit, është vlerë e shtuar që do t'i hyjnë në punë nxjerrjes së informatave të tjera statistikore dhe analizave për mbrojtje të monumentit.

Përveç tjerash, informatat luajnë rol edhe në “parashikimin e së ardhmës”. Përvojat e fituara nga vendet të cilat kanë kaluar nëpër katastrofa natyrore, tregojnë për rëndësinë dhe efikasitetin e inventarizimit në rrethanat më të këqija. Përpjekjet për të minimizuar sa më shumë dëmet që në raste të tilla katastrofike, që mund të paraqiten, duhet të fillojnë duke përgaditur informacionin e duhur të inventarizimit në formatin GIS. Nëse kjo do të arrihej, institucionet do të kenë mundësi për të kuptuar vendodhjen e kërcënimeve të mundshme dhe të zhvillojnë analiza. Gjithsesi do të ishte mëse e nevojshme edhe krijimi i strukturës për menaxhimin e këtyre të dhënave, përditësimi, mbrojtja e tyre, si dhe shkëmbimi - qasja nga institucionet tjera.

Në këtë frymë, të dhënat do të duhej të standardizoheshin për të mundësuar qasjen më të gjërë dhe më të shpejtë. Që asetet

kulturore të mirren në konsideratë pas një situatë katastrofe, inventari do të duhej të integrohej shpejtë për të marrë trajtimin e përshtatshëm. Në këtë mënyrë, krijimi i marrveshjeve për shkëmbim të informacioneve, do të qartësonte rolin dhe të lehtësonte aktivitetin e palëve të cilat do të shpejtonin reagimin. Edhe pse shkëmbimi i këtyre informacioneve është i dëshirueshëm, këto të dhëna, natyrisht që do të duhej të përdoret në mënyrën e duhur. Në këtë rast, cilësia dhe saktësia e të dhënave do të ndihmonte në përcaktimin e përdorimit adekuat të tyre.

Në HZKos nuk ka informata specifike për kërcënimet natyrore të identifikuar për qëllime të mbrojtjes së TK-së, e në bisedë me përpiluesit e disa prej HZKom konfirmohet që as autoritetet komunale nuk i kanë këto informata.²²

Meqenëse jemi dëshmitarë të avancimit të vazhdueshëm të teknologjisë, duhet gjithashtu të jemi të vetëdijshëm që edhe mënyra e inventarizimit të aseteve kulturore është duke ndryshuar. Por, ajo që nuk do të ndryshoj kurrë, është nevoja për të poseduar të dhëna të sakta për këto asete kulturore. Mundësia për të shkëmbyer dhe për të pasur qasje në informacion, mbetet thelbësore për planifikim dhe reagim ndaj katastrofave. Pra, standardizimi i këyre të dhënave në mes institucioneve gjegjëse, do të sigurojë që monumentet të jenë të përgaditura për përgjigje ndaj situatave-katastrofave të mundshme natyrore.

Për më tepër, qëllimi i shkëmbimit të informacioneve vlenë edhe për sektorët tjerë, e posaqërisht për atë të infrastrukturës, nga i cili trashëgimia kulturore në vendin tonë çdo ditë e më shumë po ndihet e kërcënuar. Shembull i fundit për këtë është ndërtimi i autoudhës Prishtinë - Han i Elezit, që kalon mbi një lokalitet arkeologjik në Ferizaj.

22 *Intevistë me Shkelqim Daci, Planer urban, GIZ*

Në dritë të kësaj dhe me qëllim të njoftimit me atë se sa monumetet e integruara në HZKos janë të pajisura me informata, gjatë intervistës së zhvilluar me IPH, u kuptua që vetëm për 23 monumente ka informata për vendodhjen e tyre gjeografike.

| | Info për vendodhje - pozicion gjeografik | Zonë mbrojtëse të definuar | Informatat tjera*** |
|----------------------|--|----------------------------|---------------------|
| 1620 asete të TK-së* | - | - | - |
| 23 asetet të TK-së** | + | + | + |
| 45 ZVM | + | + | + |

* Marrë nga lista e TK nën mbrojtje të përkohshme, viti 2019.

** Marrë nga lista e TK nën mbrojtje të përhershme.

*** Me informata të tjera është nënkuptuar: foto, përshkrimi i rëndësishëm për monumentin, datat e rëndësishme për monumentin, lloji, shfrytëzueshmëria, ndërhyrjet në të kaluarën etj.

1620 monumente tjera figurojnë vetëm si numra në HZKos, nuk ka as edhe një informatë tjetër për to.

Asetet që gëzojnë mbrojtje të përhershme ligjore posedojnë edhe informacionet tjera respektive si dhe kanë të definuar zonën e tyre mbrojtëse.



Fig. 3 *Permimetri dhe zona mbrotëse e Hidroelektranes në Prizren (screenshot marrë nga: <https://kktk.rks-gov.net/>)*

Instituti për Planifikim Hapësinor, si organ përgjegjës për koordinim në mes institucioneve përgjegjës në zhvillim të HZKos, potencon neglizhencën e shkëmbimit të informatave nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, në kuadër të MKRS-së. Edhe përkundër formimit të një komisioni që ka pasur për qëllim shkëmbimin e të dhënave në mes MKRS-së dhe MMPH-së, një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende.

Në anën tjetër edhe disa prej të dhënave të pranuar nga MKRS rreth vendndodhjes së monumenteve nuk kanë rezultuar të sakta dhe si të tilla ka qenë e pamundur të paraqiten në HZKos.²³ Përfaqësues të MKRS-së në këtë rrafsh, theksojnë gatishmërinë e tyre për shkëmbim të informatave dhe potencojnë rëndësinë për paraqitjen e tyre në hartë zonale.²⁴

²³ Intervistë me Festa Nixha- Nela, IPH, MMPH

²⁴ Intervistë me Vjollca Aliu, udhëheqëse e DTK, MKRS





Fig. 3 Screenshot i marrë nga HZKos dhe mënyra se si paraqiten 1620 asete të TK nën mbrojtje të përkohshme (është zmadhuar njëra nga komunat me qëllim të qartësisë)

Mungesa dhe mosshkëmbimi i informacioneve nuk është e vetmja sfidë. Zhvillimi i HZKos për fushën e trashëgimisë kulturore vështirësohet edhe më tej nga fakti që MKRS ende nuk ka përcaktuar zonat mbrojtëse rreth aseteve kulturore dhe krahas kësaj, nuk ka as kritere të zhvillimit për këto zona.

Një problem tjetër që tani nuk duket i rëndësishëm për institucionet e Kosovës, e që lidhet me planifikim hapësinor, është prezenca e një numri të madh monumentesh në listën e Institutit për Mbrojtje të Monumenteve në Republikën e Serbisë. Meqenëse ky institut ka të digjitalizuar qasjen në informacione, ekipi hulumtues i këtij projekti ka arritur të nxjerrë statistikën si vijon:

Nga 1395 lokalitete të trashëgimisë kulturore të listës së Institutit për mbrojtjen e monumenteve në Republikën e Serbisë, 448 prej tyre gjenden në territor të Republikës së Kosovës.²⁵

Lidhur me këtë, është e rëndësishme të rikujtohet se para futjes së katër lokaliteteve - manastireve të Kosovës në UNESCO, ato fillimisht ishin pjesë e kësaj liste të Republikës së Serbisë.

²⁵ E qasshme në: <http://spomenicikulture.mi.sanu.ac.rs/>

5.1.3. QASJA DHE SIGURIA

NË ZONAT E VEÇANTA TË

MBROJTURA

Disa prej parimeve të planifikimit hapësinor e që lidhen me trashëgiminë kulturore janë të specifikuara edhe në në dokumentin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Respektimi i këtyre parimeve që bazën e kanë në Planin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, është i barazvlefshëm me shtetësinë e vendit.²⁶ Bëhet fjalë për trashëgiminë fetare, e titulluar serbe, e për të cilën janë qartë të specifikuara përgjegjësitë që insitucionet publike dhe individët që kanë karrshi saj. Pra, monumente me vlera të jashtëzakonshme të trashëgimisë së përbashkët kulturore, me anë të këtij plani gjithëpërfshirës, i janë bartur në pronësi dhe menaxhim Kishës Ortodokse Serbe. Neni 7 i këtij propozimi specifikon qartë që Kisha Ortodokse Serbe është pronarja e vetme e këtyre monumenteve, me diskrecion të plotë sa i përket menaxhimit dhe qasjes në anekset përreth. Fakti që këto monumente nuk janë gërmadha apo të ngjajshme por vende të gjalla të adhurimit, të cilat janë të banuara nga bashkësitë fetare dhe që tërheqin një numër të madh të vizitorëve, kanë edhe rol të padiskutueshëm në planifikim hapësinor.

Sa i përket qasjes, Plani gjithëpërfshirës gjithashtu thekson se KOS duhet të inkurajojë që popullit të Kosovës t'i ofrohet qasje në hapësirat e veta për të nxitur dhe promovuar rëndësinë kulturore dhe historike.

Për të verifikuar se sa KOS implementon dispozitat e këtij plani, i

²⁶ E qasshme në: <http://pbosnia.kentlaw.edu/Comprehensive%20Proposal%20for%20the%20Kosovo%20Settlement.pdf>

është bërë vizitë Kishës së Shën Premtes në Prizren, monument në listën botërore të trashëgimisë - UNESCO. Në kohën e vizitës, Kisha ishte e mbyllur dhe e paqasshme për vizitorë. Nga komunikimi me zyrtarin policor, përgjegjës për sigurinë e monumentit, u kuptua se për shkak se prifti gjendet në pushim dhe çelësin e Kishës e mban me veti, monumenti është i mbyllur. Në anën tjetër, përveç qasjes për vizitorë, plani gjithëpërfshirës specifikon edhe mënyrën se si duhet të qasen zyrtarët institucional të shtetit të Kosovës. Qartë theksohet se autoritetet e Kosovës do të kenë qasje në këto objekte vetëm me pëlqimin e dhënë nga KOS-i.

Në Maj të vitit 2021, kryeministri i Kosovës iu drejtua KOS-it me kërkesë për të realizuar një vizitë në Manastir të Deçanit. KOS me anë të një letre publike, refuzoi qasjen e kryeministrit në manastir dhe vizita nuk ndodhi kurrë. Deri më sot, e vetmja vizitë e realizuar nga drejtuesit e shtetit të Kosovës mbetet të jetë ajo e vitit 2015-të, nga presidentja dhe kryeministri i asokohshëm (Atifete Jahjaga dhe Isa Mustafa).

Por, ky plan gjithëpërfshirës ka gjithsej 45 zona të veçanta të mbrojtura. Për të parë se sa është e lehtë qasja edhe në disa prej këtyre lokaliteve tjera të trashëgimisë, ekipi i këtij raporti hulumtues, i ka bërë vizitë edhe Manastirit të Premtit të Shenjtë dhe Manastirit të Shëruesve të Shenjtë në komunën e Leposaviqit. Qasja fizike në ambientet përreth, sikurse edhe në hapësirat e brendshme të këtyre dy manastireve ishte e lehtë dhe nuk shihej nevoja për prezencë policore apo ofrim të sigurisë.

Pikërisht në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e objekteve fetare, neni 3 i planit gjithëpërfshirës, specifikon se Shërbimi Policor i Kosovës ka detyra të veçanta operacionale. Pas komunikimit me zyrtarë të SHPK-së, ekipi hulumtues u njoftua se brenda këtij institucioni ekziston njësia e veçantë për sigurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe e cila ofron siguri fizike (24/7) për 24 objekte të trashëgimisë kulturore fetare.

Ekipi hulamtues ka kontaktuar edhe me strukturat ndërkombëtare të sigurisë - KFOR, që ofrojnë mbrojtje për Manastirin e Deçanit, për të marrë edhe perspektivën e tyre por nuk është nxjerrë ndonjë informacion lidhur me punën që ata bëjnë në rrafshin e sigurisë.

5.2. PERSPEKTIVA E MBROJTJES SË TRASHËGIMISË KULTURORE

5.2.1 INFORMATA TË BAZUARA NË HARTËN ZONALE TË KOSOVËS

Nga atë që u nënvizua më lartë, roli i hartës zonale në mbrojtje të trashëgimisë kulturore është i pazëvendësueshëm. Por, kostoja e kësaj është posedimi dhe menaxhimi i informatave. Meqenëse në proceset e planifikimit hapësinor në 20 vitet e fundit, trashëgimia kulturore ka qenë sektor i anashkaluar, përpilimi i dokumentit të hartës zonale është parë si shpresa e fundit për trajtim të mirëfilltë të kësaj fushe.

Mirëpo, problemi duhet trajtuar nga gjeneza, e këtu duhet të ndalemi të përgjegjësit kryesorë të sektorit të trashëgimisë kulturore. Mangësitë në përcaktimin e qartë të hierarkisë vendimmarrëse në kuadër të MKRS-së si dhe mungesa e kapaciteteve humane në aspektin e menaxhimit dhe trajtimit të trashëgimisë kulturore, përveç tjerash, ka shfaqur problem edhe për sektorin e planifikimit hapësinor. Pra, është e pamundur mbrojtja e trashëgimisë kulturore nga sektorët e planifikimit hapësinor, nëqoftëse nuk ekzistojnë struktura të qëndrueshme menaxhuese në institucionet primare të thirrura për mbrojtje të TK-së. Në një ambient të rregullt institucional, MKRS dhe institucionet vartëse do të duhej të ishin dora e parë e informacionit për gjendjen reale në terren të aseteve kulturore dhe si të tillë, do t'i mundësonin sektorit të planifikimit qasjen në bazën e tyre të të dhënave. Por, kjo fatkeqësisht nuk ndodhë dhe si pasojë përgjegjësitë hidhen nga njëra anën në tjetrën. Rezultati në fund mbetet i njëjtë, informatat për asetet e trashëgimisë kulturore reflektojnë të mangëta në planifikim hapësinor, e në këtë mënyrë edhe perspektiva për të mbrojtur këto pak vlera të mbetura, është tepër e zymtë.

5.2.2. INFORMATA TË BAZUARA NË HARTËN ZONALE KOMUNALE

Shikuar edhe në aspektin e qeverisjes lokale, këta dy sektorë dalin të jenë mjaftë me ndikim. Mungesa e të dhënave hapësinore dhe kadastrale ka ndikuar edhe në mos përmbushjen e obligimit ligjor, nenit 4, paragrafit 4.6 i cili obligon që 'objektet e trashëgimisë kulturore të përfshira në listën e trashëgimisë, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, regjistrohen në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, në të dy nivelet, qendror dhe lokal.²⁷

Por, kur bëhet fjalë për zbatimin e përgjegjësive ndaj këtyre dy sektorëve, niveli lokal lëngon edhe në një rrafsh tjetër. Mungesa e stafit profesional nëpër drejtoritë e urbanizmit dhe planifikimit

²⁷ Hulumtim parlamentar, Zbatimi i ligjit për trashëgimi kulturore, USAID, 2019

hapësinor, që do të mundësonte shfrytëzimin e softuerit GIS është dobësi e pothuajse secilës komunë. Për përpilimin e hartave zonale komunale, komunat kanë angazhuar kompani private.²⁸ Meqenëse ky dokument komunal parashihet që të revidohet secilin vit, kjo shihet si e paarritshme për t'u realizuar nga zyrtarët komunal, sepse mungojnë burimet njerëzore.

Pra, në vend që të krijohet një dokument strategjik zhvillimor, i cili përveç tjerash do të mundësonte edhe analiza hapësinore, qeveritë lokale kanë krijuar një dokument të "ngirë".

Daljen nga kjo situatë, komunat prap e shohin me angazhimin e kompanive private, gjë që i'u përkthehet në kosto financiare vjetore. Gjithsesi, e udhës do të ishte që fillimisht të bëhej trajnimi i stafit për shfrytëzim të GIS-it dhe më pas dokumenti të zhvillohej nga brenda. Ende ka iniciativa nga agjenci ndërkombëtare për të ndihmuar në krijimin e këtyre strukturave dhe stafit profesional por mungesa e vullnetit të zyrtarëve komunal është e evidente.²⁹

²⁸ Intervistë me Shkelqim Daci, Planer urban, GIZ

²⁹ Intervistë me Luan Nushi, Drejtor i IPH, MMPH

6. INSTITUCIONET E TRASHËGIMISË KULTURORE

Analizë e infrastrukturës institucionale dhe kompetencave të tyre

Roli dhe përgjegjësitë e institucioneve kompetente të trashëgimisë kulturore, analizë reflektuese e punës së këtyre institucioneve në vitet e fundit

6.1. KKTK- KËSHILLI I KOSOVËS

PËR TRASHËGIMI KULTURORE

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore - KKTK³⁰ është agjenci e pavarur e krijuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të nenit 4.8 të Ligjit për Trashëgimi Kulturore nr. 02/L-88 dhe në përputhje me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. KKTK përbëhet nga një bord prej 7 anëtarësh të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës me një mandat prej 3 viteve, duke respektuar përbërjen etnike në vend. Pas përzgjedhjes së anëtarëve të bordit, të njejtit kanë të drejtë të zgjedhin kryetarin. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtij këshilli është rregulluar me një akt të brendshëm të miratuar prej tij. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore funksionon që nga viti 2009.

Në kuadër të KKTK-së, funksionon edhe Sekretariati që udhëhiqet nga Udhëheqësi Ekzekutiv. Sekretariati luan rolin e një organi mbështetës, profesional, administrativ dhe teknik për nevojat e agjencisë së KKTK-së. Ky organ përbëhet nga 11 nënpunës civil të cilët kanë 'detyra të caktuara në përmbushjen e përgjegjësisë dhe mandatit që ka institucioni.'³¹ Sekretariati përbëhet nga Departamenti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, Departamenti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, Departamenti për Peizazhe Kulturore, Departamenti i Gjeobazes, Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme, Departamenti i Buxhetit dhe Financave, Divizioni për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Paluajtshme, Divizioni për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Luajtshme, Divizioni i Burimeve Njerëzore.

30 Më shumë rreth KKTK në <https://kktk.rks-gov.net/Home/Mandate>

31 <https://kktk.rks-gov.net/Home/Mandate>




Fig. 1 *Struktura organizative e këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.*³²

32 Marë nga Sekretariati i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Buxheti i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore miratohet nga Kuvendi i Kosovës. Poashtu KKTK ka mundësi të marrë donacione shtesë, por ato nuk duhet të ndikojnë në pavarësinë e saj. Kurse, të paktën një herë në vit, KKTK duhet të bëjë raportime të punës në Kuvendin e Kosovës.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore janë të përcaktuara në bazë të Ligjit nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore, Ligjit nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligjit nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit dhe me rregulloren e tyre të brendshme. Gjithashtu KKTK ka edhe aktet e veta nënligjore që rregullojnë mënyrën e organizimit dhe funksionimit si Rregullorja 01/2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe Rregullorja 02/2016 për Vlerësimin dhe Shpalljen e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përhershme. Përmes Rregullore nr. 01/ 2016 caktohen kompetencat dhe përgjegjësitë e kësaj agjencie të cilat janë:**33**

4.1 Shqyrton, vlerëson, aprovon apo refuzon trashëgiminë kulturore të propozuar për shpallje në mbrojtje të përhershme

4.2 Propozon hartimin e politikës Nacionale për Trashëgimi Kulturore

4.3 Vlerëson projektet e propozuara të parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse

4.4 Asiston Kuvendin e Republikës së Kosovës në plotësim-ndryshimet e ligjeve që kanë të bëjnë me trashëgimi kulturore

4.5 KKTK, siguron mjete nga donacione për intervenime dhe çështje të tjera në Trashëgiminë Kulturore

³³ Përgjegjësitë e përshkruara në Rregulloren nr. 01/ 2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13038>

4.6 KKTK, themelon komisione të pavarur për vlerësimin e kompensimit të asetëve në rast shitblerje, shpronësimi apo për ndonjë humbje financiare që ka ndodhur në asetet e evidentuara që kanë karakter të mbrojtjes së përkohshme ose përhershme. Kjo do të rregullohet me një akt të vecantë në pajtim me këtë rregullore

4.7 KKTK mbikëqyrë MKRS-në gjatë hartimit të listës së asetëve të TK në rrezik

4.8 Identifikon dhe i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës prioritetet vjetore për mbështetje financiare të TK-së

4.9 I propozon Kuvendit ndërmarrjen e masave të nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e TK dhe i ofron asistencë teknike Qeverisë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me TK-në në Republikën e Kosovës nëse një gjë e tillë kërkohet nga Qeveria

4.10 Bashkëpunon me MKRS dhe Institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare si UNESCO, Këshilli i Evropës etj. Për çështje të mbrojtjes dhe ruajtjes së TK në Republikën e Kosovës, bazuar në Ligjin e TK, ligjet e tjera në fuqi si dhe konventat dhe standardet ndërkombëtare

4.11 Bashkëpunon me Këshillin Zbatues dhe Monitorues KZM mbi çdo çështje që ka lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e TK në Republikën e Kosovës sipas Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura

4.12 Rivlerëson apo rishikon Qendrën e mbrojtur historike të Prizrenit me të gjitha elementet e saj, bazuar në Ligjin për Qendrën Historik të Prizrenit.

Dhe detyra të tjera të parapara me ligj.

Kurse disa nga përgjegjësitë dhe detyrat kryesore të Sekretariatit i cili udhëhiqet nga Udhëheqësi Ekzekutiv janë ofrimi i shërbimeve

këshilluese për Bordin, bënë përgatitjen e buxhetit vjetorë të KKTK-së, planifikon shpenzimet buxhetore dhe kryerjen e pagesave të KKTK-së dhe mbështetë në organizim të takimeve të Bordit.

6.1.1. AKTIVITETET E KKTK

Për të lehtësuar procesin e aplikimit për asetet në mbrojtje të përhershme të TK-së, **KKTK ka krijuar formën elektronike online të formularit.** Qasje në platformë kanë të gjithë zyrtarët të cilët caktohen nga institucionet vartëse të MKRS. Platforma është zhvilluar gjatë vitit 2018, kurse ka hyrë në funksion në vitin 2019.³⁴ Gjithsesi, përkundër që kanë kaluar dy vite prej kur është krijuar kjo platformë, ajo nuk është përdorur asnjëherë nga zyrtarët e MKRS-së. Sipas kryeshefit ekzekutiv, z. Isuf Koci, pas krijimit të platformës, janë mbajtur trajnime dhe prezantime me stafin e MKRS-së rreth përdorimit të kësaj platforme por ajo nuk ka gjetur zbatim ende. Sipas Kocit, kjo platformë mundëson aplikimin më transparent dhe më efikas, nga forma e plotësimit të aplikacionit me shkrim paraprak. Po ashtu, i mënjanon plotësimet gjysmake të aplikacioneve, veprim ky i bërë nga MKRS edhe në vitin 2015 (viti i fundit kur janë propozuar asetet të trashëgimisë kulturore për të hyrë në listën e asetëve të TK-së në mbrojtje të përhershme) para aprovimit dhe shpalljes së 23 asetëve në mbrojtje. Sipas z. Koci, në atë vit janë dorëzuar 100 aplikime, ku një numër i konsiderueshëm i tyre kanë qenë larg kushteve të kërkuara në ofrimin e informatave përkatëse rreth të dhënave për asetet e propozuara.

KKTK është institucioni i vetëm që **ka uebfaqe zyrtare.** Në këtë uebfaqe ofrohen informata rreth punës së këtij

34 Raportet të punës të KKTK të vitit 2019, 2020

institucioni ndër vite, duke mundësuar që deri diku veprimtaria dhe puna e KKTK-së të jetë e qasshme dhe transparente për palët e interesuara. Në kuadër të kësaj uebfaqeje, të interesuarit mund të gjejnë informacione edhe rreth asetëve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme.

Në vitin paraprak, stafi i sekretariatit ka arritur të ndjekë rreth 5 trajnime të cilat lidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të punës. Gjithësesi, nevoja e ngritjes profesionale e stafit dhe ndjekjeve të trajnimeve të tilla nuk është e mjaftueshme dhe mungesa e tyre shkakton pengesa në efektshmëri kolektive apo mundësinë e zhvillimit pozitiv të vet institucionit në periudhë kohore më të gjatë në të ardhmen.

Sipas raporteve zyrtare të lëshuara nga KKTK, kjo agjenci gjatë vitit paraprak ka arritur të ndërmerrë veprime dhe të realizoj një numër të aktiviteteve konkrete me qëllim të përmirësimit të gjendjes së trashëgimisë kulturore dhe promovimit të saj. **Janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi dhe mundësi të reja me organizata dhe institucione vendore dhe ndërkombëtare.**

“Si rezultat i bashkëpunimit në mes të KKTK-së dhe EHV-së është mundësuar të realizohet projekti ndërkombëtar vullnetarë “Gërmime arkeologjike dhe restaurimi i mozaikut romak”, në Dresnik të Komunës së Klinës në shtator të vitit 2020. Është mundësuar partneritet me Drejtorinë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Institutin Nacional STOB nga Republika e Maqedonisë së Veriut, është bërë përgatitja e Projektit për Shtëpinë e Kulturës në Runik për nominim në organizatën World Monuments Fund, Anëtarësimi në Climate Heritage Network dhe Anëtarësimi në Culture Action Europe. Poashtu, KKTK është duke punuar në projektin hulumtues, në mbledhjen

e fakteve dhe dëshmimeve për asetet e trashëgimisë kulturore arkitekturale të shkatërruara gjatë luftës së fundit. Sipas të dhënave zyrtare nga kjo agjenci, gjatë vitit 2021/22 mendohet të përfundoj ky raport.³⁵

6.1.2. SFIDAT E KKTK-SË

Që nga korriku i viti 2018 deri në korrik të këtij viti, 2021, trupi vendimmarrës apo bordi i Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore nuk ishte në funksion. Për këto tri vite, nga përfundimi i mandatit të anëtarëve të bordit paraprak, në KKTK ka funksionuar vetëm sekretariati. Dështimi i përzgjedhjes së bordit, ka shkaktuar dëme enorme në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës, duke bërë të pamundur përmbushjen e proceseve të shumta brenda përgjegjësive të kësaj agjencie. Ndër ngecjet më të mëdha janë procesi i aprovimit të aseteve të trashëgimisë kulturore për të kaluar në mbrojtje të përheshme, organizimi i komisioneve të pavarura për kompensime të pronave, shpronësimeve dhe humbjeve financiare. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 4.8 të Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturore, dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK), ka bërë shpalljen dhe rishpalljen e konkursit për zgjedhjen e 7 anëtarëve të bordit disa herë. Jostabiliteti politik në vend gjatë viteve të fundit dhe ndikimi i drejtëpërdrejtë politik në përzgjedhjen e kandidatëve të bordit ka ndikuar negativisht në këtë proces, duke e bërë të pamundur përzgjedhjen e bordit kompetent dhe funksional gjatë këtyre viteve. Përgjatë vitit 2021, përkatësisht me 7 korrik të këtij viti, është bërë përzgjedhja

35 Raporti vjetor i punës së Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore – KKTK për vitin 2020

dhe funksionalizimi i bordit me kompetenca dhe përgjegjësi të plota për 3 vitet e ardhshme.

Përkundër dështimit të përzgjedhjes së bordit të KKTK, ky institucion që nga viti 2015 nuk ka pranuar asnjë propozim nga institucionet përkatëse të trashëgimisë kulturore për shpallje në mbrojtje të përhershme të aseteve të trashëgimisë kulturore. Në vitin 2015, KKTK ka pranuar një listë prej 100 aseteve si propozime për të hyrë në listën e aseteve të TK-së në mbrojtje të përhershme. Prej tyre, KKTK ka adaptuar 23 asete, kurse 77 të tjera nuk janë pranuar për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës. Sipas të intervistuarit z. Isuf Koci dhe konfirmuar nga zyrtarë të MKRS, kjo ka qenë hera e fundit kur KKTK ka pranuar një listë të tillë nga MKRS.

Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional shihet si problematikë e theksuar po ashtu. Ngecje të mëdha janë potencuar në mosbashkëpunimin e Këshilli Zbatues Monitorues - KZM (organ i krijuar në bazë të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura) dhe Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për çështjet që ndërlidhen me trashëgiminë kulturore dhe fetare siç e obligon neni 11.2 i Ligjit të TK.

Burimet Njerezore: Mungesa e numrit të punonjësve profesional

Sipas raportit vjetor të punës të vitit 2020 të KKTK, kjo agjenci ka numrin më të vogël të punëtorëve nga të gjitha institucionet në Republikën e Kosovës. Nga themelimi e deri me sot në KKTK janë të angazhuar vetëm njëmbëdhjetë (11) nëpunës civil, të cilët, si rezultat i limiteve të resurseve njerëzore, punonjësit kryejnë më shumë se 3 detyra të punës jashtë përshkrimit të përgjegjësive të punës që kanë³⁶.

36 Raporti i punës së Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore dhe sipas të intervistuarit z. Isuf Koci - kryeshefit të Sekretariatit të KKTK.

Asetet në posedim dhe kushtet e punës: KKTK është e vendosur në kontejnerët pranë ndërtesës së ish Rilindjes, kushte këto të papërshtatshme të punës. Edhe pse këto hapësira pune ishin paraparë të jenë të përkohshme për këtë institucion, duket se tashmë janë harruar nga institucioni përgjegjës. Ambienti dhe kushtet e punës domosdoshmërisht mund të kenë ndikim edhe në efikasitetin e punës të vet punonjësve të këtij institucioni. Këta kontejnerë janë strukturalisht jo stabil, dhe gjatë kushteve klimatike ekstreme (gjatë stinës së dimrit ka probleme me ujë dhe rrymë, kurse gjatë verës me temperatura të larta në hapësirat e brendshme) vështirësojnë krijimin e kushteve bazike të punës. Sipas të intervistuarit z.lusuf Koci, paisjet e punës si kompjuterë

dhe paisje të tjera janë të vjetëruara dhe kërkohet ndërrimi i tyre, po ashtu.

Sfidë për KKTK është konsideruar të ketë qenë edhe situata e krijuar me pandeminë COVID-19, duke vështirësuar procese në kryerjen e punëve përkatëse.


6.1.3. BUXHETI I SHPENZUAR

Buxheti i shpenzuar nga KKTK ndër vite³⁷:

³⁷ Këto të dhena janë marrë nga raportet financiare të KKT për vit dhe nga raportet financiare të auditimit për vitet përkatëse.

| KKTK | Buxheti dhe shpenzimet e 2016 vitit | | Buxheti dhe shpenzimet e 2017 vitit | | Buxheti dhe shpenzimet e 2018 vitit | | Buxheti dhe shpenzimet e 2019 vitit | | Buxheti dhe shpenzimet e 2020 vitit | | Buxheti dhe shpenzimet e 2021 vitit | |
|----------------------------------|-------------------------------------|-------------------|-------------------------------------|-------------------|-------------------------------------|-------------------|-------------------------------------|-------------------|-------------------------------------|-------------------|-------------------------------------|------------|
| | Buxheti fillestar | Shpenzimet | Buxheti fillestar | Shpenzimet | Buxheti fillestar | Shpenzimet | Buxheti | Shpenzimet | Buxheti | Shpenzimet | Vleresuar | Shpenzimet |
| Pershkrimi | | | | | | | | | | | | |
| Pagat dhe meditet | | 91,801.00 | | 108,338.00 | 130319.97 | 89,183.18 | 130,972.00 | 60,912.62 | 129,262.00 | 67,156.30 | 132,285.00 | |
| Mallrat dhe Sherbimet | | 85,084.00 | | 42,761.00 | 85418.00 | 62,406.82 | 87,993.00 | 85,659.93 | 83,593.00 | 52,783.25 | 87,993.00 | |
| Shpenzimet komunale | | 1,951.00 | | 1,038.00 | 2550.00 | 867.49 | 2,550.00 | 691.18 | 2,550.00 | 640.3 | 2,550.00 | |
| Subvencionet dhe transferet | | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | |
| Shpenzimet kapitale | | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | |
| TOTAL buxheti i shpenzuar | | 178,836.00 | | 152,138.00 | 218287.97 | 152,457.49 | 221,515.00 | 147,263.73 | 215,405.00 | 147,263.73 | 222.828.00 | |

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjate periudhes 2016-2021



Raportet e auditimit për KKTK për vitet financiare 2018-2020, në përgjithësi janë vlerësuar pozitivisht. Sipas auditorit 'KKTK në përgjithësi ka kontrole të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.³⁸

Gjithsesi, në këto raporte potencohen edhe sfidat që KKTK ka përjetuar në lidhje me shpenzimet vjetore po ashtu, si:

- Mos protokollimi i faturave të pranuar duke rritur rrezikun e humbjes apo pagesës së dyfishtë të së njëjtës faturë.

-Mosrealizimi i tërësishëm i buxhetit në kategorinë e pagave dhe medijave e cila për arsye se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka arritur që të bëjë emërimin e anëtarëve të Bordit të KKTK-së. (Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2020). Çdo vit buxheti për paga për bordin është ndarë dhe kthyer sërish në fund të vitit.

-Mungesa e buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike si subvencione - transfere dhe shpenzime kapitale përkundër kërkesave të KKTK-së ndër vite.

-Rregullorja nr. 02/2011 për punë provuese, neni 4, pika 1 përcakton që kandidati i cili kalon me sukses procedurat e rekrutimit, pranohet si nëpunës civil dhe i nënshtrohet punës provuese si në vijim, pika 1.1 nëpunësi civilë të karrierës, i nënshtrohet punës provuese në kohëzgjatje prej 12 muajsh. Raporti i auditorit ka vërejtur që KKTK, **zyrtarin e personelit i cili ishte në periudhën provuese të punës, pas tre muajve e kishte caktuar ushtrues detyre (UD) në një pozitë më të lartë nga koeficienti 7 në koeficientin 9, edhe pse ishte në periudhë provuese.** Kjo kishte ndodhur për shkak se, në

38 Raporti i auditimit të KKTK të vitit 2018

njësinë ku ishte caktuar UD ishte vetëm zyrtari i caktuar dhe nuk kishte personel tjetër. Caktimi i nëpunësit civil në pozita më të larta gjatë periudhës provuese duke rritur koeficientet e pagës ndikon në pagesa të cilat janë në kundërshtim me aktet ligjore.³⁹

- Bërja e pagesave në avans për kurse të gjuhës angleze.

Pagesat në paradhënie 100% të vlerës përveç që janë në kundërshtim me ligjin e buxhetit, mund të ndikojnë që shërbimet mos të kryhen sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.⁴⁰

-Nuk janë zbatuar rekomandimet e viteve paraprake të dhëna nga auditorët

Përcaktimi i prioriteteve financiare nga ana e KKTK-së, nuk ka arritur të bëhet, pasi që nuk ka pasur bashkëpunim ndërinstitucional në mes të MKRS-së dhe KKTK-së në këtë drejtim gjatë viteve, 2018, 2019 dhe 2020

39 Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturorë për vitin 2020

40 Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturorë për vitin 2020

6.2. MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT - MKRS

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore i cili vepron në kuadër të MKRS-së, është themeluar me vendim të Ministrit në qershor të vitit 2010. Kurse, caktimi i institucioneve publike të Trashëgimisë Kulturore, vartëse

të MKRS-së është bërë në kuadër të rregullores nr. 06/2017, në cilësinë e institucioneve kompetente në organizimin dhe funksionimin e institucioneve përkatëse aktuale.

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore në MKRS ka strukturë organizative në përbërje të tri divizioneve:

- Divizioni për Trashëgimi Arkitekturore dhe Arkeologjike
- Divizioni për Trashëgimi të Luajtshme dhe Shpirtërore
- Divizioni për Menaxhim të integruar dhe turizëm kulturor




Fig...Struktura organizative e Ministrise se Kulturës, Rinisë dhe Sportit e marrë nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore të MKRS

Sipas Rregullorës së MKRS nr. 06/2017 për Caktimin e Insitucionëve Publike të Trashëgimisë Kulturore, institucionet publike, vartëse të MKRS- së ⁴¹ janë:

- Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monementeve (IKMM)
- Instituti Arkeologjik i Kosovës (IAK)
- Muzeu i Kosovës (MK)
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore - Prishtinë (QRTK - Prishtinë)
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore - Mitrovicë (QRTK - Mitrovicë)
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore - Pejë (QRTK - Pejë)
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore - Prizren (QRTK - Prizren)
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore - Gjilan (QRTK - Gjilan)
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore - Gjakovë (QRTK - Gjakovë)
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore - Ferizaj (QRTK - Ferizaj) - nuk është në funksion të plotë për shkak të mungesës së stafit profesional dhe administrativ.

Nën përgjegjësinë e Ministrisë/Departamentit/institucioneve vartëse janë edhe:

- Kompleksi etnologjik “ Emin Gjiku “ në Prishtinë
- Muzeu Shtëpia e Pavarësisë “Dr. Ibrahim Rugova” në Prishtinë
- Muzeu i “Lidhjes Shqiptare” në Prizren
- Muzeu Arkeologjik në Prizren
- Kompleksi i kullave të Isa Boletinit në Boletin derisa

⁴¹ Webfaqja zyrtare e institucioneve të Trashëgimisë Kulturore vartëse të MKRS <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,127>

në pronësi të ministrisë janë Kalaja e Vushtrrisë dhe Kulla e Mushkolajve në Deçan.

Përveç tyre, akter me rëndësi në ruajtjen dhe mbështetjen apo funksionimin e këtyre institucioneve janë edhe:

- Kuvendi i Kosovës
- Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore - KKTK
- Inspektorati për Trashëgimi Kulturore

Bazuar në dispozitat materiale të Ligjit nr 02\L-088 për TK, institucionet vartëse të lartëpërmendura zhvillojnë veprimtari për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e këtyre kategorive ligjore të TK:

1.1 Trashëgimia arkitekturale - institucioni kompetent qendror: IKMM e cila kompetencat e niveli lokal ose rajonal i ushtron përmes QRTK-së përkatëse.

1.2 Trashëgimia arkeologjike - Institucioni kompetent është IAK e cila kompetencat e niveli lokal ose rajonal i ushtron përmes QRTK- së përkatëse.

1.3 Trashëgimia e lujtshme - Institucioni kompetent është IAK dhe MK kurse kompetencat e niveli lokal ose rajonal i ushtron përmes QRTK-së përkatëse. IAK-u është përgjegjës për të gjeturat gjatë gërmimeve arkeologjike deri në momentin e dorezimit në Muzeun e Kosovës, akt në të cilin përgjegjësia kalon të ky i fundit.

1.4 Trashëgimia shpirtërore - institucioni kompetent është Muzeu i Kosovës e cila kompetencat e niveli lokal ose rajonal i ushtron përmes QRTK- së përkatëse.

^ Institucionet e nivelit qendror si: Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve (IKMM), Muzeu Kombëtar i Kosovës (MKK) dhe Instituti Arkeologjik i Kosovës (IAK) kanë Këshillat Drejtues të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Ministri i Kulturës, kurse brenda IKMM-së funksionon dhe Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve të Konservimit – Restaurimit, Komisioni brenda QRTK-Prizren që trajton vetëm lëndët për ndërtesat brenda qendrës historike të Prizrenit derisa Komisioni i Ankesave ndaj Vendimeve funksionon brenda Ministrisë/Departamentit të Trashëgimisë Kulturore.⁴²

6.2.1. AKTIVITETET E MKRS - DEPARTAMENTIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Sipas dokumenteve zyrtare të MKRS-së, gjatë dy viteve të fundit, për sa i përket legjislacionit primar dhe sekondar, janë përfunduar këto akte:

- Udhëzimi për Kartelën për objektet e trashëgimisë se luajtshme, në ri-formatim pas mbylljes së konsultimit publik
- Udhëzimi për licencimin e personave fizik dhe juridik, në pritje të opinionit nga ZKM/ZPS

⁴² Hulumtim parlamentar, zbatimi i ligjit nr. 02/I-88 për Trashëgimi Kulturore, Sali Shoshi

- **Janë miratuar dy plane të menaxhimit: për Qendren Historike të Prizrenit dhe për Kalanë e Prizrenit.**

Po ashtu, gjatë viteve të fundit në Departamentin i Trashëgimisë Kulturore, në bashkëpunim me institucionet vartëse, organizata dhe individ, varësisht nga fusha specifike, janë realizuar **aktivitete** në vende të ndryshme të Kosovës **për shënimin e ditëve ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore.**

Në vitin paraprak janë organizuar disa **ekspozita** ku ndër të tjera edhe ajo “Anton Cetta - Rrëfim biografik” dhe ekspozita “Streha e Kujtimeve” e hapur pas shpalljes së ish Burgut të Prishtinës në muze. Gjatë vitit 2020 janë mbështetur edhe botime të revistave në fushën e trashëgimisë kulturore dhe monografi.

MKRS në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës vitin e kaluar **ka financuar 6 bursistë** në fushat e arkeologjisë, arkeologji-periudha e parahistorisë, periudhës së antikitetit të vonë dhe mesjetë e hershme dhe studime të larta mbi letrat klasike. Kurse, gjatë këtij viti, MKRS ka filluar mbështetjen financiare edhe në ngritjen profesionale të stafit të tij në të gjitha degët e trashëgimisë kulturore.

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore në MKRS gjatë viteve të fundit ka marrë **masa preventive dhe ka bërë intervenime emergjente në një numër të objekteve të Trashëgimisë Kulturore** në Kosovë. Gjithsesi, nevoja e intervenimeve të tilla është ende e madhe.

Përmes thirrjeve publike, **një mori projekte në fushën e trashëgimisë kulturore nga organizata dhe individ janë mbështetur nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore.**

Sipas MKRS, projektet kishin për qëllim 'promovimin e diversitetit kulturor, respektimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë dhe shprehjes kulturore; Rritjen e numrit të botimeve, guidave, medimeve virtuale, etj., dhe shpërndarjen sistematike në vend dhe në rrafshin ndërkombëtar; si dhe promovimi i gastronomisë në lokale tradicionale si prodhim turistik. Të gjitha këto objektiva janë të përcaktuara në dokumentin: Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturorë 2017-2027.⁴³

6.2.2. SFIDAT E MKRS - DEPARTAMENTIT TË TRASHEGIMISË KULTURORE

Një nga sfidat kryesore të MKRS-së mbetet **vazhdimi i statusit të aseteve në listë të përkohshme për çdo vit**, veprim ky në kundërshtim me ligjin për trashëgimi kulturorë, respektivisht nenin 3.6. Sipas këtij neni, objektet e përfshira në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme duhet të jenë nën listën e mbrojtjes së përkohshme për një vit. Pas një viti, aseti duhet të kalojë procesin e hyrjes nën mbrojtje të përhershme. Nëse ajo nuk ndodh, e drejta për kompensim për ndonjë humbje financiare bartet në gjykatë dhe kompensimi i tillë vlerësohet nga një komision i pavarur që themelohet nga KKTK (Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë). Në këtë rast, MKRS duke vazhduar të i mbajë të njëjtat objekte në listën e mbrojtjes së përkohshme ndër vite, pa futjen e tyre në mbrojtje të përhershme, **rrezikon humbje enorme të buxhetit publik**, në rast të kërkesave për kompensim për çfarëdo

⁴³ Raport përmbledhës Janar – Dhjetor, MKRS, Departamenti i Trashëgimisë Kulturorë

humbje financiare nga pronarët e këtyre aseteve. Mungesa e planeve konkrete të Ministrisë në trajtimin e ndërtesave të mbrojtura, ka ndikuar që pronarët specifik qëllimisht të shkatërrojnë asetet në pronësi të tyre, dhe të kërkojnë largimin e aseteve nga lista e mbrojtjes së përkohshme. Kërkesa të tilla janë bërë edhe për asetet e mbrojtura publike, si ish ndërtesa e Gërmisë, ndërtesa e Armatës në Mitrovicë, ndërtesa të tjera publike në Pejë, Prizren dhe Gjilan.

Problematike mbetet edhe **shtimi i numrit të aseteve të reja çdo vit** në këtë listë, pa ndonjë plan apo planifikim në trajtimin e tyre në të ardhmen.

Në anën tjetër, edhe në asetet të cilat ka pasur intervenim me qëllim të ruajtjes së tyre, nuk ka plan të menagjimit apo shfrytëzimit e poashtu ndarje buxhetore në mirëmbajtjen e tyre në të ardhmen. Sipas ligjit të trashëgimisë kulturore, neni 6, paragrafi 6.14 'Përdorimi me qëllim përfitimi ekonomik dhe kulturor i trashëgimisë arkitekturale autorizohet me leje të shkruar nga Institucioni kompetent, në rastet ku vlerat e trashëgimisë arkitekturale janë të mbrojtura.' Pothuajse asnjë nga asetet e mbrojtura **nuk kanë strategji të shfrytëzimit të tyre për përfitime ekonomike**, kurse mirëmbajtja e tyre është tërësisht e varur nga vullneti individual i pronarëve të aseteve apo buxhetit publik në rast të ndërtesave publike.

Shqetësuese mbetet edhe fakti i mënyrës së restaurimit të aseteve të mbrojtura dhe mungesa e mbikqyrjes së intervenimeve, respektivisht **mungesa e kompanive, personave juridik apo fizik të licencuar** nga Ministria, në punë konzervuese/restauruese dhe punë të tjera teknike në këto asete, siç kërkohet me ligjin e trashëgimisë kulturore, neni 4.16. Kjo reflekton në ndërhyrje të shumta joprofessionale të një cilësie të ulët, duke shkaktuar dëme konstante të **pariparueshme** në asetet e trashëgimisë kulturore.⁴⁴

⁴⁴ Në një hulumtim të vitit 2018, të bërë nga KKTK, mund të gjenden

Pavarësisht mungesës së bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor, **MKRS nuk e ka kryer obligimin e saj në propozimin e aseteve specifike të përkohshme për të kalur në listën e aseteve në mbrojtje të përheshme.** Kërkesa e fundit e bërë nga kjo ministri ishte në vitin 2015. Me gjithsej numër të aseteve të propozuara prej 100 aseteve, sipas z. Koci (ushtrues detyre në KKTK), vetëm 23 prej tyre kishin dokumentacion të plotë të aplikimeve dhe si rrjedhojë janë aprovuar për të hyrë në listën e mbrojtjes së përhershme. Që nga ajo kohë, MKRS nuk ka propozuar asnjë aset të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme të hyjë në listën e aseteve në mbrojtje të përhershme.

1244 artefakte arkeologjike dhe etnografike të huazuara përkohësisht nga Muzeu i Kosovës në vitet 1997-1999 për ekspozimin e tyre në Beograd në vitin 1999, **nuk janë kthyer ende në Kosovë.** Deri më tani, që nga koha e pasluftes nuk ka pasur një strategji të qartë nga MKRS dhe Muzeu i Kosovës, për kthimin e këtyre artefakteve. Sipas raportit hulumtues të KKTK-së, deri në vitin 2018, **252,683.00 euro janë ndarë për kthimin e këtij thesari arkeologjik dhe etnografik të Kosovës** por nuk dihet saktësisht se çfarë veprime janë marrë në këtë drejtim.

Madje, Republika e Kosovës nuk ka arritur të përdorë në favor të kthimit të artefakteve as dokumentin “Propozimi gjithëpërfshirës për marrëveshjen për Statusin e Kosovës” ANEKSI V Trashëgimia Fetare dhe Kulturor, neni 6, ku thuhet se: “Republika e Serbisë, brenda 120 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj zgjidhjeje, do t’i kthejë artefaktet arkeologjike dhe etnologjike të cilat janë marrë hua nga muzetë e Kosovës për ekspozim të përkohshëm në Beograd gjatë viteve 1998-1999”. Deri më sot është arritur vetëm kthimi i një ekspoziti –

edhe emrat e të gjitha kompanive ndërtimore që kanë kryer punë të tilla deri në vitin 2018, dhe shumat e përgjithshme për punët e kryera nga to.

Hyjnesha në Fron e marrë në vitin 2002 nga kryeadministratori i atëhershëm i UNIMK-ut gjatë vizitës së tij në Beograd.⁴⁵ Përveç artefakteve të lartëcekura, **Kosova ka përjetuar edhe humbje të madhe të dokumentacionit të trashëgimisë kulturore.** Sipas vendimit të vitit 1996 të pushtetit serb, janë marrë dokumentacione nga IKMM, regjistra, filma, foto dhe video dhe materiale të tjera prodhim dhe pronë e Kosovafilmit, dokumentacione arkivore dhe koleksione nga Arkivat e Kosovës, Biblioteka e Kosovës dhe vepra të ndryshme të artit dhe koleksione nga Galeritë e Kosovës. Të gjitha këto dokumente përbejnë pasuri studimore dhe faktike rreth trashëgimisë kulturore e më tepër. Ritheksojmë që deri këtë vit, asgjë konkrete nuk është bërë në këtë drejtim dhe çështja e këtij dokumentacioni të humbur ka qenë temë pak e folur nga ky institucion.

Mungesa e një platforme online dhe informimi publik:

Departamenti i trashëgimisë kulturore i MKRS dhe degët e saj ende nuk kanë një platformë apo uebfaqe online, ku qytetarët mund të informohen rreth përgjegjësive, veprimtarive dhe punëve të bëra nga ky institucion. Si pasojë, shpeshherë duket e pamundur arritja e informatave tek palët e interesuara, mundësia e reflektimit kritik në punët e kryera, transparencës dhe komunikimit të hapur në mes të institucioneve përkatëse dhe personave juridik apo fizik të interesuar në këtë fushë.

Plani i punës së vitit 2021 fatkeqësisht deri në korrik të këtij viti, nuk ishte miratuar. Kjo situatë shkakton rrezikshmëri të realizimit të punëve dhe projekteve në dobi të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në vend. Gjithsesi, për shkak të situatës pandemike COVID-19, zbatimi i një numri të

⁴⁵ Raporti për projektet e investuara në trashëgimi kulturore nga MKRS 2008-2018, Analizë e gjendjes aktuale të trashëgimisë kulturore nga KKTK

programeve të punës ishte përcjellur me sfida, duke kushtëzuar rishikimin dhe miratimin e programit të punës dy herë brenda vitit.

Gjatë shqyrtimit të raporteve të punës ndërvite të këtij departamenti, shihet qartë mungesa e koordinimit të institucioneve ndërmjet vete, duke shkaktuar vonesa në kryerjen e obligimeve të tyre dhe parregullësi të tjera përgjatë implementimit të projekteve të përbashkëta specifike.

6.2.3. BUXHETI - SHPENZIMET FINANCIAR

Mungesa e kontrollit dhe llogaridhënies në investimet në trashëgimi kulturore rezultojnë si sfida për MKRS-në, respektivisht departamentin e trashëgimisë kulturore, në parandalimin e shkatërrimeve të asetëve të trashëgimisë kulturore në tërë vendin. Planifikimi jo i mirë i prioriteteve financiare dhe menaxhimi financiar shihet si problematikë e theksuar ndër vite nga gjetjet në raportet e auditimit për këtë institucion. Sipas raportit të auditimit të vitit (Raporti flet në terme të përgjithshme pa bërë ndarje të departamenteve) për pasqyrat financiare të MKRS-së, "Menaxhimi financiar dhe kontrolli - vazhdon të mbeten mjaft sfiduese për menaxhmentin e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS) pasi që mangësitë e njëjta janë duke u përsëritur ndër vite në disa fusha, si: në subvencione, prokurim, realizim të pagesave etj. Zbatimi i rekomandimeve – MKRS nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur zbatimit të rekomandimeve dhe si rezultat i saj, pjesa më e madhe e rekomandimeve të vitit

paraprak kanë mbetur të pazbatuara."⁴⁶

Në vitet paraprake janë ndarë edhe mjete financiare në projekte kapitale në **regjistrimin dhe digjitalizimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë**. 'Në bazë të të dhënave publike nuk specifikohet se çfarë është realizuar deri më tani, përveç databazës së trashëgimisë kulturore, e cila është bashkëfinancuar me fonde ndërkombëtare. Megjithatë kjo databazë është jofunksionale dhe me mangësi teknike, mungesë të dhënash, ajo përmban informata të pasakta si dhe nuk është e mirëmbajtur dhe as e përditësuar.'⁴⁷

Në anën tjetër, përkundër mjeteve financiare të shumta që janë ndarë për **shenjëzimin dhe ndriçimin e asetëve të trashëgimisë kulturore**, pothuajse shumica e asetëve nuk e kanë të zgjidhur këtë çështje. Në vitin 2019 është përpiluar udhëzuesi administrativ nr. 01/2019 për specifikat e shenjimit të TK dhe vendeve turistike. Përkundër legjislacionit të punuar, nga vizita jonë në teren mund të thuhet se ajo është zbatuar në disa raste pjesërisht, në disa raste shenjëzimet janë të dëmtuara nga kushtet natyrore apo nga personat fizik, kurse në shumicën e asetëve të mbrojtura si ato në listën e mbrojtjes së përkohshme edhe ato të përhershmet shenjëzimet mungojnë plotësisht.

⁴⁶ Raporti I auditimit I viteve 2019 dhe 2020.

⁴⁷ Raporti për projektet e investuara në trashëgimi kulturore nga MKRS 2008-2018, analizë e gjendjes aktuale të trashëgimisë kulturore nga KKTk



Foto në të majtë:
**Kulla e Bashor Pren
 Gegajt, Gjurakoc
 Komuna e Istogut me
 shënjestim të dëmtuar**

Foto në të djathtë:
**Kulla e Gani Sejdiut ne
 Skenderaj, Me shënjestim
 (Fotot nga ChwB)**

foto: CHWB Kosova

Foto në të majtë:
**Kulla e Gjylë Kadrijaj,
 Rastavicë, Deçan,
 Pa shenjzim**

Foto në të djathtë:
**Kulla e Hysen Hajdarit,
 Nivokaz, Gjakovë,
 Pa shenjzim**

foto: CHWB Kosova



Në buxhetin e rishikuar të datës 28 korrik të këtij viti, janë planifikuar edhe investime të konsiderueshme në revitalizimin e aseteve të trashëgimisë kulturore në tërë regjionin e Kosovës. **Në listën e aseteve të përzgjedhura për investim, janë edhe**

objekte të cilat nuk janë fare pjesë e listës së aseteve të mbrojtura. Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur asetet të cilat nuk gëzojnë statusin e mbrojtjes dhe investimet e parapara nga Qeveria e Kosovës për vitet e ardhshme.

Trashëgimia Kulturore 81500 - Mbrojtja, Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore

| Emri i Projektit | | Shpenzimet deri më 2022 | Vazhdim nga 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 | Vitin> 2024 | Vlera Totale Projekti |
|------------------|---|-------------------------|-------------------|-------------------|---------------------|-------------------|-------------|-----------------------|
| 1 | Muzeu i natyres / studimi i fizibilitetit dhe projekti ideor | 165,060.00 | 450,000.00 | 450,000.00 | 608,000.00 | 610,000.00 | 0.00 | 1,833,060.00 |
| 2 | Kompleksi Rexhep Malaj ne Kamenice | 93,181.00 | 30,000.00 | 30,000.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 123,181.00 |
| 3 | Muzeu i Paqes | 0.00 | 1,000.00 | 1,000.00 | 500,000.00 | 300,000.00 | 0.00 | 351,000.00 |
| 4 | Kulla e familjes Fanaj, Vermice | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 35,000.00 | 0.00 | 0.00 | 35,000.00 |
| 5 | Restaurimi i Akademisë së parë ushtarake të UÇK-së në Açarevë | 0.00 | 1,000.00 | 1,000.00 | 15,000.00 | 0.00 | 0.00 | 16,000.00 |
| 6 | Ndërtimi i Kullës të Shaban Manxhollit në fshatin Mikushnicë, Skenderaj | 0.00 | 65,000.00 | 65,000.00 | 40,000.00 | 0.00 | 0.00 | 105,000.00 |
| 7 | Ndërtesa e Shtabit, Brigada 121 | 0.00 | 1,000.00 | 1,000.00 | 40,000.00 | 0.00 | 0.00 | 41,000.00 |
| 8 | Kulla në Lubizhdë të Hasit | 11,232.00 | 1,000.00 | 1,000.00 | 50,000.00 | 0.00 | 0.00 | 62,232.00 |
| 9 | Rindërtimi i kullës se Sef Mleqanit | 0.00 | 50,000.00 | 50,000.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 50,000.00 |
| 10 | Ndërtimi i Kullës Muze i Heroit të Kombit Basri Canolli Shpendi në fshatin Marecë | 20,699.00 | 48,000.00 | 48,000.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 68,699.00 |
| 11 | Ndërtesa e Ish Burgut, Prishtinë | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 25,000.00 | 0.00 | 0.00 | 25,000.00 |
| TOTAL | | 290,172.00 | 647,000.00 | 647,000.00 | 1,313,000.00 | 910,000.00 | 0.00 | 2,710,172.00 |

Pa kontestuar rëndësinë e disa asetëve përkatëse në këtë listë, mbetet shqetësuese fakti i prioritizimeve të investimeve në këto objekte nga buxheti i trashëgimisë kulturore, përderisa

nevoja e intervenimeve në asetet e mbrojtura në listën e përkohshme dhe të përhershme është mjaftë e madh

BUXHETI NDËR VITE

Buxheti 2018 - me Ligj te Buxhetit

| Kodi i Prog | Kodi Funk / nënfunk | Departamentet | Programet | Stafi 2018 | Paga dhe Mëditje | Mallra dhe Shërbime | Shpenzimet Komunale | Subvencione dhe Transfere | Te hyrat nga AKP | Buxheti I Kosovës-Kapitalet | Totali 2018 |
|-------------|---------------------|-----------------------|--|------------|------------------|---------------------|---------------------|---------------------------|------------------|-----------------------------|--------------|
| | | Trashëgimia kulturore | | 145 | 763,534.42 | 15,100.00 | 93,500.00 | 842,286.00 | | 4,020,000.00 | 5,734,420.42 |
| 815 | 0820 | | Ruatja, Mbrotja e Trashigimisë Kulturore | 140 | 736,350.55 | 15,100.00 | 93,500.00 | 429,237.00 | | 4,020,000.00 | 5,294,187.55 |
| 816 | 0820 | | Prezentimet dhe kerkimet per trashigimi | 5 | 27,183.87 | - | | 413,049.00 | | | 440,232.87 |

Buxheti ne fund te vitit 2018

| Kodi i Prog | Kodi Funk / nënfunk | Departamentet | Programet | Stafi 2018 | Paga dhe Mëditje | Mallra dhe Shërbime | Shpenzimet Komunale | Subvencione dhe Transfere | Te hyrat nga AKP | Buxheti I Kosovës-Kapitalet | Totali 2018 |
|-------------|---------------------|-----------------------|--|------------|------------------|---------------------|---------------------|---------------------------|------------------|-----------------------------|--------------|
| | | Trashëgimia kulturore | | 145 | 838,081.51 | 3,600.00 | 93,500.00 | 1,605,077.00 | | 1,179,435.06 | 3,719,693.57 |
| 815 | 0820 | | Ruatja, Mbrotja e Trashigimisë Kulturore | 140 | 811,075.62 | 3,600.00 | 93,500.00 | 1,062,028.00 | | 1,179,435.06 | 3,149,638.68 |
| 816 | 0820 | | Prezentimet dhe kerkimet per trashigimi | 5 | 27,005.89 | - | | 543,049.00 | | | 570,054.89 |

Buxheti 2019 -me Ligj te Buxhetit

| Kodi i Prog | Kodi Funk / nënfunk | Departamentet | Programet | Stafi 2019 | Paga dhe Mëditje | Mallra dhe Shërbime | Shpenzimet Komunale | Subvencione dhe Transfere | Te hyrat nga AKP | Buxheti I Kosovës-Kapitalet | Totali 2019 |
|-------------|---------------------|-----------------------|--|------------|------------------|---------------------|---------------------|---------------------------|------------------|-----------------------------|--------------|
| | | Trashëgimia kulturore | | 145 | 831,863.17 | 107,213.00 | 109,083.34 | 1,303,049.00 | 400,000.00 | 3,308,556.00 | 6,059,764.51 |
| 815 | 0820 | | Ruatja, Mbrotja e Trashigimisë Kulturore | 141 | 805,146.72 | 76,213.00 | 15,583.34 | 890,000.00 | 400,000.00 | 3,308,556.00 | 5,495,499.06 |
| 816 | 0820 | | Prezentimet dhe kerkimet per trashigimi | 4 | 26,716.45 | 31,000.00 | 93,500.00 | 413,049.00 | | | 564,265.45 |

Buxheti ne fund te vitit 2019

| Kodi i Prog | Kodi Funk / nënfunk | Departamentet | Programet | Stafi 2019 | Paga dhe Mëditje | Mallra dhe Shërbime | Shpenzimet Komunale | Subvencione dhe Transfere | Te hyrat nga AKP | Buxheti I Kosovës-Kapitalet | Totali 2019 |
|-------------|---------------------|-----------------------|--|------------|------------------|---------------------|---------------------|---------------------------|------------------|-----------------------------|--------------|
| | | Trashëgimia kulturore | | 145 | 942,695.02 | 345,166.00 | 93,500.00 | 1,536,096.00 | 400,000.00 | 1,683,421.73 | 5,000,878.75 |
| 815 | 0820 | | Ruatja, Mbrotja e Trashigimisë Kulturore | 141 | 911,379.15 | 314,166.00 | - | 1,123,047.00 | 400,000.00 | 1,683,421.73 | 4,432,013.88 |
| 816 | 0820 | | Prezentimet dhe kerkimet per trashigimi | 4 | 31,315.87 | 31,000.00 | 93,500.00 | 413,049.00 | | | 568,864.87 |

Buxheti 2020 -me Ligj te Buxhetit

| Kodi i Prog | Kodi Funk / nënfunk | Departamentet | Programet | Stafi 2020 | Paga dhe Mëditje | Mallra dhe Shërbime | Shpenzimet Komunale | Subvencione dhe Transfere | Te hyrat nga AKP | Buxheti I Kosovës-Kapitalet | Totali 2020 |
|-------------|---------------------|-----------------------|--|------------|------------------|---------------------|---------------------|---------------------------|------------------|-----------------------------|--------------|
| | | Trashëgimia kulturore | | 139 | 850,839.07 | 704,501.00 | 93,500.25 | 1,188,049.00 | 652,333.00 | 3,574,696.00 | 7,063,918.32 |
| 815 | 0820 | | Ruatja, Mbrotja e Trashigimisë Kulturore | 135 | 824,356.24 | 376,320.00 | - | 875,000.00 | 652,333.00 | 3,574,696.00 | 6,302,705.24 |
| 816 | 0820 | | Prezentimet dhe kerkimet per trashigimi | 4 | 26,482.83 | 328,181.00 | 93,500.25 | 313,049.00 | | | 761,213.08 |

Buxheti ne fund te vitit 2020

| Kodi i Prog | Kodi Funk / nënfunk | Departamentet | Programet | Stafi 2020 | Paga dhe Mëditje | Mallra dhe Shërbime | Shpenzimet Komunale | Subvencione dhe Transfere | Te hyrat nga AKP | Buxheti I Kosovës-Kapitalet | Totali 2019 |
|-------------|---------------------|-----------------------|--|------------|------------------|---------------------|---------------------|---------------------------|------------------|-----------------------------|--------------|
| | | Trashëgimia kulturore | | 139 | 960,788.04 | 517,195.59 | 65,530.25 | 998,049.00 | 604,297.00 | 914,500.00 | 4,060,359.88 |
| 815 | 0820 | | Ruatja, Mbrotja e Trashigimisë Kulturore | 135 | 939,125.62 | 209,014.59 | - | 735,000.00 | 604,297.00 | 914,500.00 | 3,401,937.21 |
| 816 | 0820 | | Prezentimet dhe kerkimet per trashigimi | 4 | 21,662.42 | 308,181.00 | 65,530.25 | 263,049.00 | | | 658,422.67 |

Buxheti 2021-me Ligj te Buxhetit

| Kodi i Prog | Kodi Funk / nënfunk | Departamentet | Programet | Stafi 2021 | Paga dhe Mëditje | Mallra dhe Shërbime | Shpenzimet Komunale | Subvencione dhe Transfere | Te hyrat nga AKP | Buxheti I Kosovës-Kapitalet | Totali 2019 |
|-------------|---------------------|-----------------------|--|------------|------------------|---------------------|---------------------|---------------------------|------------------|-----------------------------|--------------|
| | | Trashëgimia kulturore | | 70 | 431,630.00 | 272,574.00 | 67,900.00 | 673,049.00 | - | 4,039,000.00 | 6,707,325.00 |
| 815 | 0820 | | Ruatja, Mbrotja e Trashigimisë Kulturore | 68 | 418,241.00 | 41,713.00 | 67,900.00 | 360,000.00 | | 4,039,000.00 | 4,926,854.00 |
| 816 | 0820 | | Prezentimet dhe kerkimet per trashigimi | 2 | 13,389.00 | 230,861.00 | - | 313,049.00 | | | 557,299.00 |

6.3. IAK - INSTITUTI ARKEOLOGJIK I KOSOVËS

Instituti Arkeologjik i Kosovës - IAK është institucioni kompetent për trashëgiminë arkeologjike, i cili i ushtron kompetencat në nivelin lokal dhe rajonal përmes QRTK- Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë përkatëse. Përgjegjësia e këtij institucioni bie edhe në trashëgiminë e luajtshme, të gjetura këto gjatë gërmimeve arkeologjike deri në momentin e dorëzimit të tyre në Muzeun e Kosovës, akt në të cilin përgjegjësia kalon te ky i fundit. Muzeu i Kosovës është edhe kompetent për trashëgiminë shpirtërore i cili ngjashëm me IAK, kompetencat e nivelit lokal dhe rajonal kalonjë përmes qendrës përkatëse rajonale të trashëgimisë kulturore QRTK-së. Instituti Arkeologjik i Kosovës është themeluar në vitin 2003 me vendim të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

IAK ka Këshill Drejtues i cili është i përbërë nga 5 anëtarë dhe ka mandat katër vjeçar me mundësi rizgjedhjeje. Këshilli mbikqyrës, mbështet, monitoron dhe garanton zbatimin e politikave programore dhe objektivave të përcaktuara me aktet normative dhe dokumentet strategjike në fuqi. Ky këshill emërohet dhe shkakohet nga Ministri i MKRS. Sipas të intervistuarit, drejtorit të IAK, z. Rexha, sot IAK ka 10 të punësuar dhe është i ndarë në sektorë si: sektori e parahistorisë, sektori i botimeve, sektori administrativ, sektori i arkivës, i kohës së re, dhe sektori për bashkëpunimin e institucionit të brendshëm dhe jashtëm. Ky institut nuk ka organogram dhe si rrjedhojë nuk e ka të definuar strukturën e saj organizative dhe ndarja e përgjegjësive të punës brenda IAK nuk është shumë e qartë.

Sipas nenit 11 të Rregullores (MKRS) nr. 06/2017 për Caktimin e Institucioneve Publike të Trashëgimisë Kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente, IAK ka këto përgjegjësi:

1.1 Koordinon procesin e identifikimit të TK-arkeologjike me QRTK në mënyrën e përcaktuar me nenin 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturorë, aktin përkatës nënligjor, si dhe duke respektuar standardet profesionale të përcaktuara në udhëzuesit profesional të trashëgimisë kulturore-mjetet teknike për konservim dhe menaxhim të trashëgimisë kulturore.

1.2 Jep leje me shkrim për veprimtari që mund të ndikojnë në vlerat ose ndryshojnë tërësinë apo strukturën e TK-arkeologjike nën mbrojtje të përhershme ose të përkohshme

1.3 Mund të propozoj asete të TK - arkeologjike për të hyrë në mbrojtje të përkohshme dhe të përhershme

1.4 Nëpërmjet MKRS-së, bashkëpunon me KKTK - Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për identifikimin e masave të domosdoshme për mbështetje financiare për Trashëgiminë Kulturore - Arkeologjike, në pajtim me nenin 4 të Ligjit nr.02/L- 88 për Trashëgimi Kulturorë

1.5 Urdhëron ndalimin e menjëhershëm, për një periudhë të përcaktuar kohore, të çdo lloj pune të paautorizuar, në lokalitetet dhe zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore - arkeologjike.

1.6 Aprovon projektet konservuese dhe restauruese të trashëgimisë kulturore - arkeologjike

1.7 Koordinon dhe mbikëqyr procesin e ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese në trashëgiminë kulturore - arkeologjike në bashkëpunim me qendrën rajonale përkatëse për trashëgiminë kulturore në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

1.8 Ndërmerr ndalimin e punëve konservuese dhe restauruese në trashëgiminë kulturore - arkeologjike në rastet kur identifikohen parregullësi gjatë zbatimit të tyre, kur vërehet se janë tejkualuar kushtet dhe kriteret e aprovuara si në nënparagrafin 2 dhe 6 të këtij paragrafi, respektivisht të këtij neni. Ndalimi do të jetë në fuqi deri në konstatimin e eliminimit të parregullësive apo tejkalimeve të tilla.

1.9 Propozon projektet për financim në fushën e trashëgimisë kulturore - arkeologjike, sipas nenit 5 të Ligjit nr.02/L- 88 për Trashëgimi Kulturorë

1.10 Bën regjistrimin, konfirmimin dhe aprovimin e shumave të çdo investimi me qëllim konservimi dhe restaurimi në trashëgiminë kulturore - arkeologjike të mbrojtur, nga personat juridik apo fizik, me qëllim të lirimit të tyre nga detyrimi për tatimin në të hyra deri në vlerën e shumës së investuar, sipas nenit 5 të Ligjit nr.02/L- 88 për Trashëgimi Kulturorë

1.11 Në kuadër të zbatimit të masave paraprake dhe shpëtuese, është përgjegjës për:

1.11.1. Shqyrtimin e aplikimeve për leje të cilët parashtrihen në autoritetet lokale të planifikimit dhe ndërtimit për ndërtimin e ndërtesave ose krijimtarive të tjera në trashëgiminë e identifikuar arkeologjike.

1.11.2. Njoftimin e autoriteteve lokale se ku mund të vendoset ndërtesa ose krijimtaria

1.11.3. Marrëveshjet me aplikuesit për të ndërmarrë studimet vlerësuese për trashëgiminë arkeologjike si në aktin përkatës nënligjor mbi procedurat për gjurmimet/ hulumtimet arkeologjike.

1.11.4. Pranimin e njoftimit nga qendra rajonale përkatëse, dhe me pas ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme rastet kur ka gjetje të rastësishme arkeologjike gjatë punëve ndërtuese.

1.12. Menaxhon procesin e përcaktimit të rezervateve arkeologjike

sipas nenit 7 të Ligjit nr.02/L- 88 për Trashëgimi Kulturorë

1.13. Bazuar në informatat që përmbanë lista e inventarit, e hartuar përgjatë procesit të inventarizimit, IAK-u propozon rezervatet arkeologjike për mbrojtje të përkohshme pranë Komisionit në MKRS, i cili është përgjegjës për vlerësimin e propozimeve të tilla në pajtim me nenin 3 të Ligjit nr.02/L- 88 për Trashëgimi Kulturorë

1.14. Ushtron autoritetin eksklusiv për gjurmime arkeologjike me karakter shpëtimi në rezervatet arkeologjike.

1.15. Është autoriteti i vetëm që mund të japë leje për veprimtari brenda rezervateve arkeologjike.

1.16. Në bashkëpunim me QRTK-në përkatëse, bën përcaktimin e rradhës (kufirit) të zonës së mbrojtur të trashëgimisë së mbrojtur arkeologjike e cila është 100 metra nga perimetri i saj. Gjatë procesit të përcaktimit, rradha e zonës së mbrojtur mund të zgjerohet ose ngushtohet sipas nenit 7 të Ligjit nr.02/L- 88 për Trashëgimi Kulturorë

1.17. Shqyrtton aplikimet për leje me shkrim për ndërtime ose krijimtari tjera brenda zonës së mbrojtur të trashëgimisë - arkeologjike, në kuadër të masave që ndërmerren për ruajtjen dhe mbrojtjen e hapësirave dhe zonave të mbrojtura, sipas nenit 7 të Ligjit nr.02/L- 88 për Trashëgimi Kulturorë

1.18. Është autoriteti i vetëm që jep lejet me shkrim për veprimtari të bujqësore brenda zonës së mbrojtur.

1.19. Është autoriteti i vetëm që jep lejet me shkrim për gjurmime arkeologjike, në bazë të kërkesave të institucioneve tjera, personave fizik dhe juridik. Vendimi i tillë jepet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës.

1.20. Pranon raporte të gjurmimit nga personi i licencuar për

gërmim arkeologjik, përfshirë materialet fotografike, skicat, vizatimet, planet, materialet topografike, materialet kartografike dhe materialet tjera shkencore e profesionale të përdorura gjatë gërmimit, si dhe ndonjë zbulim arkeologjik, brenda një viti nga fillimi i gërmimit arkeologjik.

1.21. Themelon komisionin e pavarur, i cili do të vlerësojë kompensimin, për humbjen e tokës punuese bujqësore ose pronës tjetër ku janë bërë zbulimet arkeologjike, të cilat duhet të ruhen në vend.

1.22. Siguron këshillime administrative dhe procedurale, me Institucionet qendrore dhe lokale, mbi çështjet që lidhen me trashëgiminë arkeologjike.

1.23. Bën prezantimin e të gjeturave nga rezultatet e hulumtimeve arkeologjike përmes ekspozitave tematike, konferencave shkencore dhe publikimeve periodike shkencore.

6.3.1. AKTIVITETET E INSTITUTIT

ARKEOLOGJIK TË KOSOVËS - IAK

Sipas të dhënave zyrtare të Institutit Arkeologjik të Kosovës, gjatë vitit paraprak, 2020, janë realizuar një mori punësh dhe aktivitete nga ky Institut. Nën objektivat - **Hartime, Hulumtime, Inventarizim, Gërmime konzervuese dhe Studime** janë realizuar 11 projekte të ndryshme të udhëhequra nga IAK, si: Studimi i gjetjeve të lokalitetit në Cërnicë, Zabregjë- materiali i luajtshëm arkeologjik, studimi i materialit të lokaliteteve Zhegoc, Dardana – Kamen-

icë dhe Ulpiana, menaxhimi i Kalasë dhe Muzeut në Kalanë e Prizrenit, Përnjohje arkeologjike në Kështjellën Antike dhe Kishën Paleokristiane në fshatin Strezoc, Kamenicë, studimi i materialit arkeologjik dhe restaurimi i artefakteve arkeologjike në Barilevë, studimi i materialit arkeologjik të Kështjellës së Artanës dhe Dresnikut, menaxhimi i Parkut Arkeologjik Ulpiana, studimi, pastrimi, signimi, kartelizimi i materialit arkeologjik i lokalitetit Kështjella e Marecit, pastrime dhe gërmime arkeologjike në lokalitetin arkeologjik në Korishë etj.

Poashtu, IAK ka bërë **Restaurimin** e pjesshëm të artefakteve arkeologjike- Barilevë, Cernicë, Zhegoc, Dresnik dhe **hartimin** e 19 projekteve për vitin 2021. Në kuadër të gërmimeve arkeologjike/konservimet arkeologjike - **menaxhim, roje dhe mirëmbajtje**, ka punuar në 4 lokalitete si Ulpianë, Prizren, Artanë dhe Dresnik. Përnjohje arkeologjike në 11 lokalitete arkeologjike. Hulumtimet dhe Studimet në fushën e Trashëgimisë Kulturore, më përkatësisht 3D restituimi i lokalitetit arkeologjik Ulpiana dhe filmi dokumentar i realizuar me donacion të jashtëm. Gjithsesi, plani i punës për vitin paraprak, i sfiduar nga pandemia Covid-19, ka arritur të realizohet vetëm 50% e tij.⁴⁸

Sipas të intervistuarit, drejtorit të këtij instituti, z. Enver Rexha, IAK gjatë viteve të fundit ka pasur një mori projekte bashkëpunuese kombëtare dhe ndërkombëtare, poashtu. Gjatë tri viteve e fundit është duke u realizuar marrveshja për hulumtime dhe analiza në lokalitetin e Ulpianës, bashkëpunim ky katërpalësh në mes të Universitetit të Prishtinës, Institutit Arkeologjik të Kosovës, shkollës franceze “The École Normale Supérieure” dhe Ambasadës Franceze në Kosovë.

Mbi 10 vite bashkëpunim me Muzeun e Bohumit (Bochum Museum) në fushën e arkeometalurgjisë. Marrëveshje janë arritur

⁴⁸ *Interviste e drejtorit të IAK : <https://www.youtube.com/watch?v=Vp6yuVhQauA>*

edhe me Akademinë e Vjenës për hulumtime rreth periudhës së neolitit në lokalitete në Kosovë, me Universitetin dhe Institutin arkeologjik në Michigan, Amerikë, hulumtim ky për njohje të trashëgimisë arkeologjike dhe peisazhit.

Po ashtu, IAK çdo vit mbanë punëtori në lokalitetin e Ulpianës.

6.3.2. SFIDAT E INSTITUTIT ARKEOLOGJIK TË KOSOVËS - IAK

Përkundër të arriturave të cekura më lartë, Instituti Arkeologjik i Kosovës përballet me një numër sfidash ndër vite. **Ky Institucion ka mangësi në transparencë, llogaridhënie dhe informimit publik.** Në mungesë të ndonjë platforme elektronike apo uebfaqe për të prezantuar punën e tyre, ndarja e punëve dhe informatave me publikun duket të jetë mjaftë sfiduese. Si rrjedhojë, pothuajse asnjë nga punët e cekura më lartë nuk është e qasshme për palët e interesuara. Përgjatë zhvillimit të këtij hulumtimi, edhe ekipi ynë hulumtues ka hasur në pengesa të marrjes së dokumenteve publike përkatëse. Përkundër kërkesave zyrtare të drejtuara në këtë institucion, për qasje në dokumente publike, kërkesë kjo e mbrojtur me ligjin nr. 06/L=081, ku potencohet që 'Institucionet publike detyrohen të ofrojnë qasje në çdo dokument publik, të prodhuar, të pranuar, të mbajtur apo të kontrolluar nga to, jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga momenti i bërjes së kërkeses zyrtare. ChwB nuk ka arritur të siguroj materialin e kërkuar për më shumë se 4 muaj. Për sigurimin e dokumenteve përkatëse (jo i gjithë dokumentacioni ka arritur të sigurohet), është angazhuar Avokati i Popullit dhe IAP - Agjencia për Informim dhe Privatësi.

Në anën tjetër, Instituti arkeologjik i Kosovës, edhe pse është institucion kërkimor dhe shkencor, ka mangësi në zhvillimin e hulumtimeve shkencore të mirëfillta në fushën e arkeologjisë. Për më tepër, në një kërkim `online` nuk mund të gjindet asnjë hulumtim i bërë nga ky institucion, që do të thotë që edhe ato kërkime të pakta që janë bërë deri më tani, nuk janë të qasshme për publikun.

IAK nuk ka organigram apo strukturë organizative.

Problematikë mbetet edhe **administrimi dhe menaxhimi i aseteve të trashëgimisë kulturore arkeologjike të cilat janë në prona private.** Theks të veçant vihet në pronat private të lokalitetit të Ulpianës dhe Dresnikut, lokalitete këto me vlerë të veçantë për trashëgiminë kulturore në Republikën e Kosovës, duke mos përjashtuar asete dhe lokalitete të tjera në vend. Deri më tani nuk ka pasur ndonjë plan strategjik, plan bashkëpunues në mes të IAK dhe MKRS- së për shpronsimin e këtyre pronave.

Trafikimi i objekteve të luajtshme, është fenomen që vazhdon të ndodhë që nga periudha e pas luftës deri sot. Si pasojë e moskompletimit të bazës ligjore nga MKRS për liçencimin e personave fizik dhe juridik që merren me shitjen e objekteve të trashëgimisë se luajtshme, keqpërdorime/abuzime të tilla janë ende të mundshme të ndodhin. Në vitin 2013, autoritetet gjermane i kthyen Kosovës shtatë artefakte të gjetura në tregun e zi në Gjermani⁴⁹. Sipas të intervistuarit z.Ismet Koci përfaqësues i KKTK-së, artefaktet janë hasur edhe në uebfaqe online si faqja e njohur `merrjep`, duke u vënë në shitje nga persona fizik të paautorizuar. Trashëgimia kulturore e luajtshme është përgjegjësi e Institutit Arkeologjik të Kosovës dhe Qendrave Rajonale për Trashëgimi Kulturore, por deri më sot nuk duket të ketë ndonjë strategji nga asnjëra prej këtyre institucioneve bartëse në parandalimin e një dukurie të tillë në vend.

⁴⁹ <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,495#.YX1--hBBxb9>

Edhe pse sipas Ligjit nr.02/L- 88 për Trashëgimi Kulturore, ku institucionet ose personat fizik apo juridik mund të lejohen të bëjnë gërmime arkeologjike vetëm me licencë sipas kritereve të standardeve profesionale dhe mbikëqyrjes që përcaktohet në aktin nënligjor të bazuar në këtë ligj, në Kosovë ende nuk është bërë një gjë e tillë. **Mungesa e licencimit të personave juridik dhe fizik për të bërë gërmime arkeologjike**, paraqet jo vetëm shkelje të ligjit në fjalë por edhe pasoja për trashëgiminë kulturore arkeologjike të vendit.

Në anën tjetër, eksponatet arkeologjike të cilat zbulohen gjatë gërmimeve arkeologjike duhet të prezentohen në Muzeun e Kosovës dhe institucione të tjera. Por, për shkak të **hapësirës mjaftë të limituar të muzeut**, eksponatet zakonisht përfundojnë në hapësira jo të qasshme për publikun dhe jo adekuate për mbrojtjen e duhur të tyre. Rasti i fundit i punës bashkëpunuese të IAK dhe ChwB, në restaurimin, konservimin dhe rekonstruktimin e mbi 2000 fragmenteve të afreskave të gjetura në lokalitetin arkeologjik të periudhës romake në Dresnik, edhe pas arritjes së finalizimit të punës, në paraqitjen e plotë të afreskave, ajo nuk ka arritur të gjej vend në muze. Si rezultat, një punë e tillë mbetet në bodrum të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prishtinë.

Mungesë e bashkëpunimeve ndërinstytucionale, koordimit dhe angazhimit të përbashkët, vazhdon edhe sot të shkaktojë vonesa në kryerjen e obligimeve të tyre dhe krijimin e parregullësive të tjera përgjatë implementimit të projekteve specifike.


Për sa i përket **aseteve në posedim dhe kushteve të punës, IAK dhe MK përballen me mungesë të theksuar të hapësirave adekuate të punës**. Mungesa e ngrohjes në ndërtesën e Muzeut të Kosovës, vështirëson tej mase efektshmerinë e punës gjatë

stinëve të ftohta në vend. IAK ka pasur mangësi me furnizim nga MKRS me material dezinfektues, dhe maskave mbrojtëse kundër pandemisë, virusit Corona-19. Përkundër kërkesave të tyre drejtuar MKRS, nuk ka pasur ndonjë veprim nga kjo e fundit. Instituti Arkeologjik i Kosovës, vazhdon të ketë sfida të shumta edhe si pasojë e mungesës së resurseve të tjera, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në trashëgiminë kulturore arkeologjike në vend. IAK ka angazhime të mëdha në terren, ky Institut ndër vite përballlet me mungesën e veturave. Edhe pse në oborrin e këtij Instituti gjinden tri vetura të paraprrara për IAK, ato ka vite që nuk janë përdorur për shkak të mos regjistrimit të tyre. Si pasojë, stafi i IAK shumë herë është detyruar të përdorë makinat e tyre private për veprimtari në terren pa ndonjë kompenzim financiar në shpenzimet e makinës. Po ashtu, shpesh herë, mungesa e makinave ka pamundësuar daljen në terren, edhe pas kërkesave/lajmërimeve nga qytetarët për gjetje rasti apo mbetjeve, gërmadhave - strukturave arkeologjike⁵⁰. Gjithsesi, IAK gjatë këtij viti, është pajisur me një veturë nga MKRS, për punë në terren.

6.3.3. BUXHETI I SHPENZUAR I INSTITUTIT ARKEOLOGJIK TË KOSOVËS

Buxheti i shpenzuar i IAK ndër vite është:

| IAK | Buxheti dhe shpenzimet e vitit 2018 | | Buxheti dhe shpenzimet e 2019 vitit | | Buxheti dhe shpenzimet e 2020 vitit | | Buxheti dhe shpenzimet e vitit 2021 | |
|---|-------------------------------------|-------------------|-------------------------------------|-------------------|-------------------------------------|------------|-------------------------------------|------------|
| | Buxheti fillestar | Shpenzimet | Buxheti | Shpenzimet | Buxheti | Shpenzimet | Vleresuar | Shpenzimet |
| Pershkrimi | | | | | | | | |
| Saldo dhe subvencionet e bartur nga viti i kaluar | | 78,385.42 | | 58,658.50 | | ? | | |
| Pagat dhe meditet | | ? | | ? | | ? | 74,232.00 | |
| Mallrat dhe Sherbimet | | ? | | ? | | ? | 203,807.00 | |
| Subvencionet dhe transferet | | 600,107.98 | | 185,471.90 | | ? | 145,000.00 | |
| Donacione | | 54,925.54 | | | | | | |
| TOTAL buxheti i shpenzuar | 0.00 | 733,418.94 | | 244,130.40 | | ? | 423,039.00 | |



Ankesa zyrtare nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - MKRS janë bërë në drejtim të këtij Instituti për sfidat në shpenzimet buxhetore dhe parregullësitë e tjera në këtë fushë. Në vitin 2019, MKRS ka gjetur parregullësi në pagesat e bëra të cilat pa marrë parasysh linjën e tyre buxhetore, të gjitha pagesat, përfshirë edhe obligimet e vitit 2018 janë ekzekutuar nga linja buxhetore e subvencioneve ⁵¹. Nga IAK ishte kërkuar të riorganizohet buxheti në formë të duhur. Sipas të intervistuarës, drejtoreshës së departamentit të trashëgimisë Kulturore, në MKRS, znj. Vjollca Aliu⁵², për të parandaluar pasaktësi dhe gabime të tilla si dhe keqperdorimin e parasë publike, MKRS që nga viti 2020, ka menaxhuar buxhetin financiar për të gjitha institucionet bartëse të trashëgimisë kulturore. Gjithsesi, ky veprim është kritikuar nga institucionet vartëse përkatëse, në këtë rast nga IAK, duke theksuar vonesat të shumta në kryerjen e pagesave apo obligimeve financiare nga ana e MKRS. Në fund të këtij viti ka filluar procesi i anulimit të këtij vendimi dhe kthimi i llogarive të veçanta për secilin institucion vartës. ⁵³

Në dokumente zyrtare dhe intervistave me drejtorin e IAK, është theksuar problemi i mosrregullimit adekuat të koeficientit të pagave të këtij instituti. Ky problem është ngritur edhe nga drejtoresha e QRTK Mitrovicë, ku në të dy rastet pagat e udhëheqësve të këtyre instituteve janë më të vogla sesa të punonjësve të tyre. Vlenë të theksohet, që mosrregullimi i pagave nga ana e MKRS, ndër të tjera, mund të demotivoj drejtuesit e këtyre institucioneve bartëse në kryerjen e obligimeve të tyre.

Mosdhënia e plotë e dokumentacionit të kërkuar nga IAK rreth shpenzimeve financiare të viteve të fundit, vështirëson punën

51 *Përmbledhje e punës e vitit 2019 nga MKRS*

52 *Interviste e bere me daten 22 Qershor, 2021*

53 <https://kallxo.com/kulture/deshtoi-me-kodet-buxhetore-mkrs-synon-rihapjen-e-llogarive-te-institucioneve-kulturore-ne-bankat-komerciale/>

tonë në analiza më të detajuara të shpenzimeve, në raport me implementimin e planeve të tyre të punës për vit.

6.4 INSTITUTI I KOSOVËS

PËR MBROJTJEN

E MONUMENTEVE - IKMM

Sipas Rregullores nr. 06/2017, për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente ngjashëm si IAK që është përgjegjëse për trashëgiminë arkeologjike, IKMM është institucioni kompetent për trashëgiminë arkitekturale. Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, kompetencat e nivelit lokal dhe rajonal i ushtron përmes Qendrës përkatëse Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (QRTK).

IKMM ka Këshill Drejtues i cili është i përbërë nga 5 anëtarë dhe ka mandat katër vjeçar me mundësi rizgjedhjeje. Këshilli mbikqyrë, mbështet, monitoron dhe garanton zbatimin e politikave programore dhe objektivave të përcaktuara me aktet normative dhe dokumentet strategjike në fuqi. Ky këshill emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i MKRS. Sipas rregullores nr. 06/2017, neni 6, anëtarët e këtij këshilli duhet të jenë profesionistë të shquar të fushës së shkencave shoqërore, kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Po ashtu, së paku njëri nga anëtarët e këshillit duhet të jetë përfaqësues nga MKRS. Në këtë rregullore, në nenin 7 për-

caktohen edhe detyrat e përgjegjësitë e tyre, të cilat janë përshkruar më poshtë.

Sipas rregullores O6\2017 për caktimin e institucioneve publike të TK, neni 10. IKMM ka këto përgjegjësi:

1.1. Koordinon procesin e identifikimit të TK së bashku me QRTK-në në mënyrën e përcaktuar nga neni 3 të ligjit O2\L - 88 për TK, aktin përkatës nënligjor, si dhe duke respektuar standardet profesionale të përcaktuara në udhëzuesin profesional për trashëgimi kulturore - mjetet teknike për konservim dhe menaxhim të trashëgimisë kulturore.

1.2. Jep leje me shkrim për ndërtim ose veprimtari tjera që mund të ndikojnë në vlerat ose ndryshojnë tërësinë ose strukturën e objektit të trashëgimisë kulturore - arkitekturale nën mbrojtje të përhershme ose të përkohshme.

1.3. Mund të propozoj asete për të hyrë në listë të mbrojtjes -Bashkë me KKTK identifikon masat për mbështetje financiare në TK në pajtim me nenin 4 të ligjit nr. O2\L - 88 për TK.

1.4. Nëpërmjet MKRS-së, bashkëpunon me Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore për identifikimin e masave të domosdoshme për mbështetje financiare në trashëgiminë kulturore - arkitekturale, në pajtim me nenin 4, të Ligjit nr. O2/L- O88 për Trashëgimi Kulturore

1.5. Urdhëron ndalimin e menjëhershëm, për një periudhë të përcaktuar kohore, të çdo lloj pune të paautorizuar, në objektet dhe zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore - arkitekturale.

1.6. Kryen veprime konservuese dhe restauruese në lidhje me trashëgiminë kulturore - arkitekturale dhe bën mbikëqyrjen e veprimeve konservuese dhe restauruese të cilat kryhen nga personat juridik dhe fizik, të licencuar nga Ministria. Gjatë kryerjes së kësaj veprimtarie IKMM-ja bashkëpunon me Qendrën përkatëse Rajonale për Trashëgiminë Kulturore.

1.7. Aprovon projektet konservuese dhe restauruese të trashëgimisë kulturore - arkitekturale. Gjatë shqyrtimit dhe aprovimit, siguron zbatimin e teknikave dhe të standardeve të projektimit në objekte të trashëgimisë kulturore të përcaktuara në udhëzuesit profesional për trashëgiminë kulturore - mjetet teknike për konservim dhe menaxhim të trashëgimisë kulturore.

1.8. Koordinon dhe mbikëqyrë procesin e ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese të trashëgimisë kulturore - arkitekturale në bashkëpunim me QRTK-të në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj të veçantë dhe apo akt nënligjor të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

1.9. Ndërmerr ndalimin e punëve konservuese dhe restauruese në trashëgiminë kulturore - arkitekturale rastet kur identifikohen parregullësi gjatë zbatimit të tyre dhe kur vërehet se janë tejkaluar kushtet dhe kriteret e aprovuara si në nënparagrafin 2. 6 dhe 7 të këtij paragrafi, respektivisht këtij neni. Ndalimi do të jetë në fuqi deri në konstatimin e eliminimit të parregullësive dhe apo tejkalimeve të tilla.

1.10. Propozon projektet për financim në fushën e trashëgimisë kulturore - arkitekturale, sipas nenit 5 (paragrafi 2) të Ligjit nr. O2/L- O88 për Trashëgimi Kulturore

1.11. Bën regjistrimin, konfirmimin dhe aprovimin e shumave të çdo investimi me qëllim konservimi dhe restaurimi në trashëgiminë kulturore - arkitekturale të mbrojtur, nga personat juridik ose fizik, me qëllim të lirimit të tyre nga detyrimi për tatimin në të hyra deri në vlerën e shumës së investuar, sipas nenit 5 të Ligjit nr. O2/L- O88 për Trashëgimi Kulturore.

1.12. Në bashkëpunim me QRTTK-në përkatëse, bën përcaktimin e rradhës (kufirit) të zonës së mbrojtur të trashëgimisë së mbrojtur arkitekturale, e cila është 50 metra nga perimetri i saj. Gjatë këtij procesi të përcaktimit, rradha e zonës së mbrojtur mund të zgjerohet ose ngushtohet sipas nenit 6 të Ligjit nr. O2/L- O88 për Trashëgimi Kulturore si dhe në pajtim me ligjin në fuqi për planifikim hapësinor.

1.13. Menaxhon procesin e përcaktimit të ansambleve dhe hapësirave të konservuara arkitekturale sipas nenit 6 të Ligjit nr. 02/L-088 për Trashëgimi Kulturor.

1.14. Merr pjesë në përcaktimin e politikave për ruajtjen, menaxhimin dhe shtimin e fushave të konservuara arkitekturale së bashku me institucionet e tjera qendrore, rajonale dhe lokale që merren me Trashëgiminë Kulturorë, institucionet e pushtetit lokal dhe institucionet përgjegjëse për planifikim hapësinor.

1.15. Është autoriteti i vetëm që jep pëlqim me shkrim për çdo punë për modifikim ose demolim të një monumenti arkitektural ose ndonjë veprimi konservues ose restaurues që mund të ndikojë në vlerat atribuese të monumentit, për aq sa kjo përgjegjësia nuk i është përcaktuar ndonjë institucioni tjetër, me ligj të veçantë.

1.16. Është autoriteti i vetëm që jep pëlqim me shkrim për çdo punë për modifikim ose demolim ose ndonjë veprim konservues apo restaurues për dukjen e jashtme të ndërtesave të përfshira në ansamble ose zona konservuese arkitekturale, për aq sa kjo përgjegjësia nuk i është përcaktuar ndonjë institucioni tjetër, me ligj të veçantë.

1.17. Shqyrton aplikimet për leje për ndërtimin e ndërtesave ose krijimtari tjetër brenda zonës së mbrojtur të një monumenti arkitektural, ose brenda një hapësire konservuese arkitekturale, ose që ndikon në mjedisin e një ansambli, dhe ka veto mbi dhënien e një leje të tillë nëse kjo përgjegjësi nuk i është përcaktuar ndonjë institucioni tjetër me ligj të veçantë.

1.18. Autorizon me leje të shkruar përdorimin me qëllim përfitimi ekonomik dhe kulturor të trashëgimisë arkitekturale janë të mbrojtura, pas konsultimit me QRTK.

2. IKMM ushtron të gjitha përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 6 të Ligjit nr. 04/L - 62 për Fshatin Hoçë e Madhe.

6.4.1. AKTVITETET E INSTITUTIT TE KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE - IKMM

Në peridhën e tre mujorit të parë të këtij viti IKMM ka arritur të ketë nën përkujdesje dhe mbikqyrje disa projekte konzervuese dhe restauruese, si mbikqyrje të sanimit të dëmeve në Kalanë e Artanës, mbikqyrjen e punimeve në rrugën Mehmet Kacurri - Rruga Model. Po ashtu, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve ka nën mbikqyrje edhe punimet restauruese / konzervuese në muzeun etnografik `Emin Gjiku`, punimet në xhaminë e Pirinazit dhe disa asetë tjera të paspecifikuara të trashëgimisë kulturore arkitekturore⁵⁴.

Po ashtu, gjatë tremujorit të këtij viti një numër i librave në bibliotekë janë sistemuar dhe është arkivimi i dokumentacionit të komisioneve ndër vite. I gjithë materiali është ruajtur në një databazë të veçantë me qëllim të qasjes më të lehtë e të shpejtë në të ardhmen.

6.4.2. SFIDAT E INSTITUTIT TE KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE - IKMM

54 Informata të marra nga raporti i tremujorit të punës të IKMM

Instituti i Kosovës për mbrojtjen e monumenteve **nuk ka statut të mbrendshëm**, duke shkaktuar vështëresi në qartësimin e mandatit, veprimtarisë së tij, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre. IKMM **nuk ka as organigram** dhe si rrjedhojë nuk e ka të definuar strukturën e saj organizative dhe institucionale dhe përshkrimin e vendeve të punës për secilin punonjës të IKMM-së. Që nga viti 2019 deri në tre mujorin e parë të këtij viti, IKMM është ballafaquar me mungesën e plotësimit të pozitës së zyrtarit ligjor duke shkaktuar pengesa reale të dukshme në implementimin e punëve në IKMM. Specifikisht, pengesa të mëdha janë krijuar në punën e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave dhe projekteve konservuese/ restauruese të trashëgimisë kulturore arkitekturore në IKMM, duke bërë të pamundur nxjerrjen e vendimeve nga rekomandimet e këtij komisioni pas shqyrtimit të kërkesave apo projekteve brenda institutit. Vështirësi të mëdha janë identifikuar edhe me mungesën e rregullores së punës për vet këtë komision. Krijimi i një rregulloreje të tillë të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave dhe projekteve konservuese/ restauruese të trashëgimisë kulturore arkitekturore do të mund të ndihmonte në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisë të tij, e po ashtu procedurat apo hapat që duhet ndjekur palët përkatëse për të adresuar kërkesat e tyre. Kjo do të ndihmonte në qartësimin dhe bashkëpunimin më të mirë në mes të IKMM-së, QRTK-ve dhe komunave në tërë vendin. Sipas IKMM, shqetësim i madh mbetet edhe fakti i mos kompenzimit financiar të punës dhe takimeve të vet komisionit që nga gushti i vitit 2018, konform vendimit të Ministrit të MKRS dhe vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së.

Sfidë e theksuar e këtij instituti por edhe të institucioneve të tjera vartëse të MKRS-së është **jo digjitalizimi i proceseve të punës** në përgjithësi dhe jokoordinimi i duhur që proceset të cilat janë të ndërlidhura në mes të dy apo më shumë institucioneve të përdorin forma apo metoda të njejta të punës. Një rast i tillë ndodhë

edhe me kërkesat e dërguara nga QRTK-të në IKMM. Përderisa QRTK-të aplikojnë dërgimin e kërkesave online, përmes rrjeteve elektronike, IKMM ende praktikon pranimin e kërkesave në formë fizike. Vlenë të theksohet që digjitalizimi i punës në këto institucione dhe informatave që vet institucioni i ka, është mjaftë e rëndësishme në llogaridhënie dhe transparencën e punës së institutit. Në këtë rast mungesa e një uebfaqeje apo platforme të IKMM-së, kufizon një person juridik apo fizik të informohet me punën e këtij instituti.

Rregullorja nr. 06/2017, disave nga insitucionet kompetente, iu ka dhënë role dhe përgjegjësi të shumëfishta. Nëse analizohen detyrat dhe përgjegjësitë e IKMM vërehet se **ky institucion ka detyra të cilat kanë potencial për të krijuar konflikte interesi**. Rregullorja nr. 06/2017 e ka caktuar IKMM si instiucion kompetent për të kryer veprime konservuese dhe restauruese (neni 10, paragrafi 1.6). Këto janë veprime që do të ndikojnë drejtpërdrejt në gjendjen fizike të ndërtesës prandaj bazuar në praktikat dhe standardet profesionale ndërkombëtare, veprimet duhet të mbikqyren nga një palë e tretë që cila garanton që çfarëdo ndërhyrje nuk cenon vlerat kulturore të monumentit. Rregullorja nr. 06/2017 këtë rol të 'palës së tretë' ia ka dhënë prap IKMM-së. Mundësitë për konflikt interesi rriten për shkak se çfarëdo veprimi apo ndërhyrje restaurimi do të bëhet përmes aprovimit me shkrim nga IKMM. Në një situatë hipotetike një punonjës në IKMM mund të këtë rolin personit fizik/juridik i cili parashtrohet kërkesë për të marrë pëlqim për një ndërhyrje konzervuese dhe restuaruese; personit i cili aprovon kërkesën e tij; personit që kryen veprime restaurues dhe konzervuese; dhe personit që bën mbikqyrjen e punëve.⁵⁵

⁵⁵ Hulumtim parlamentar, zbatimi i ligjit nr. 02/I-88 për trashëgimi kulturore, Sali Shoshi

Mungesa e theksuar e stafit profesional dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të IKMM-së. IKMM ka mungesë të stafit në fushën e trashëgimisë arkitekturore duke vështirësuar funksionimin e mirëfilltë të këtij instituti. IKMM ka ngecje edhe në mbikqyrjen e punimeve konzervuese/restauruese për shkak të mungesës së personave fizik apo juridik të licencuar për këto punime.

Sipas Rregullores në fuqi nr. 06/2017 për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente, neni 10, paragrafi 1.12, IKMM së bashku me QRTK-në përkatëse, bënë përcaktimin e zonave të mbrojtura të trashëgimisë së mbrojtur arkitekturore, e cila është 50 metra nga perimetri i saj. Gjatë këtij procesi të përcaktimit, radiusi i zonës së mbrojtur mund të zgjerohet ose ngushtohet sipas nenit 6, të Ligjit nr. 02/L-088 për Trashëgimi Kulturor, si dhe në pajtim me ligjin në fuqi për planifikim hapësinor. **Këto zona në të gjitha rastet e aseteve në mbrojtje të përkohshme nuk janë të percaktuara.** KTKK arsyeton dështimin e kryerjes së obligimit me moskoordinimin e akterëve relevant nga niveli lokal rajonal dhe qendror.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve që nga viti 2019, bënë sistemimin dhe inventarizimin e gjetjeve arkeologjike, si projekt i implemetuar në bashkëpunim në mes të këtij Instituti dhe Institutit për Studime Sociale Humanistike. Përkundër volumit të punëve të kryera në këtë drejtim, vlenë të theksohet që sipas Rregullores në fuqi nr. 06/2017 për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente, intervenimet dhe punët e kryera në trashëgiminë kulturore arkeologjike nuk janë detyra dhe kompetenca të IKMM. Si rrjedhojë, **punët e kryera në këtë fushë janë në kundërshtim me rregulloren e punës aktuale në fuqi ku IKMM ka kërkuar të kryej punë të**

cilat nuk janë në kuadër të fushëveprimtarisë së tyre. Sipas rregullores në fuqi 06/2017, neni 7, pika 1.3, Këshilli drejtues përgjegjës për miratimin e raporteve të punës dhe atyre financiare të këtij instituti, ka aprovuar punën e IKMM në këtë projekt duke lejuar shkelje ligjore dhe ngatërrim të përgjegjësive të punës të institucioneve të saj bartëse.

Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional, shihet si problematikë tjetër e cila ndikon në efektshmerinë e punës edhe të IKMM. Në veçanti theksohet mungesa e bashkëpunimit nga niveli lokal komunal lidhur me kërkesat për zhvillimet urbane brenda zonave të mbrojtura të aseteve të trashëgimisë kulturore.


Deri më tani nuk ka ndonjë plan strategjik në mes të IKMM dhe MKRS në kthimin e dokumentacionit të trashëgimisë kulturore nge Serbia. Në bazë të një vendimi nga pushteti serb në vitin 1996 janë marrë dokumentacioni nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve dhe ato dokumentacione përbëjnë një pasuri të jashtëzakoshme studimore dhe faktike rreth trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Vështirësi në implementimin e punëve ka shkaktuar edhe situata e krijuar nga pandemia COVID-19, që nga viti i kaluar. Vështirësi në kufizimin e lëvizjes, punës me orar të kufizuar dhe me vetëm staf esencial. Gjatë vitit 2020, plani i punës së vitit është miratuar nga MKRS në qershor 2020, duke pamundësuar punë produktive të institutit në gjysmën e parë të vitit. Po ashtu gjatë asaj periudhe asnjë nga projektet e parapra të realizohen në kuadër të kategorisë subvencione, nuk ka filluar të zbatohet.

6.4.3. BUXHETI I SHPENZUAR I INSTITUTIT TË KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE - IKMM

për vitet e fundit janë:

| IKMM | Buxheti dhe shpenzimet e vitit 2018 | | Buxheti dhe shpenzimet e vitit 2019 | | Buxheti dhe shpenzimet e vitit 2020 | | Buxheti dhe shpenzimet e vitit 2021 | |
|---|-------------------------------------|-------------------|-------------------------------------|-------------------|-------------------------------------|-------------------|-------------------------------------|------------|
| | Buxheti fillestar | Shpenzimet | Buxheti | Shpenzimet | Buxheti | Shpenzimet | Vleresuar | Shpenzimet |
| Pershkrimi | | | | | | | | |
| Saldo dhe subvencionet e bartur nga viti i kaluar | 238,430.63 | 10,000.00 | | / | | / | | |
| Pagat dhe medijtjet | 74,583.67 | 74,583.67 | | 88,780.46 | | 100,591.86 | | |
| Mallrat dhe Sherbimet | 5,780.75 | 5,780.75 | | 612.12 | | 96.90 | | |
| Shpenzimet komunale | 206.35 | 206.35 | | 4,050.58 | | 4,447.45 | | |
| Subvencionet dhe transferet | 44,872.46 | 44,872.46 | | 46,878.09 | | / | | |
| Shpenzimet kapitale | 40,000.00 | 52,669.67 | | / | | / | | |
| Gjetjet arkeologjike | / | / | | 15,425.28 | | 2,873.68 | | |
| Petty Cash | / | / | | 138.57 | | / | | |
| TOTAL buxheti i shpenzuar | 403,873.86 | 188,112.90 | | 155,885.10 | | 108,009.89 | | |



IKMM deklaroi që kërkesa dhe nevoja e mbështetjes financiare në implementim e projekteve dhe shpenzimeve buxhetore është problematike pasi që, ato asnjëherë nuk plotësohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Si pasojë, një pjesë e projekteve të planifikuara për vitin përkatës, nuk arrijnë të implementohen.

IKMM që nga viti 2018, mesatarisht shpenzon rreth 88,000 euro, me rritje prej rreth 13,000 euro me shumë çdo vit. Mbetet për t'u diskutuar rritja e kësaj kategorie edhe në vitin 2020, kur sfidat e implementimit të punëve për shkak të situatës së virusit Covid-19, kanë pamundësuar një numër të madh të aktiviteteve edhe në këtë institut. Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, shihet një rënie drastike në vitin 2020, në krahasim me atë të vitit 2018. Rritje në vitin e fundit ka pasur edhe në shpenzimet komunale. Gjithsesi, buxheti total i shpenzuar nga IKMM ka pësuar rënie çdo vit, kjo pasi që me ndryshimet legjislative, shpenzimet kapitale që nga viti 2019 janë bërë vetëm nga MKRS.

6.5. QENDRA RAJONALE PER TRASHEGIMI KULTURORE - QRTK

Qendrat rajonale për Trashëgimi Kulturor janë institucione përgjegjëse rajonale për ushtrimin e përgjegjësive në përputhje me Ligjin nr. 02/L - 088 për Trashëgimi Kulturor, legjislacionin tjetër të përgjithshëm, për aq sa ndërlidhet me trashëgiminë kulturore, rregulloren si dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi të cilat rregullojnë fushën e trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës.

Sipas Rregullores së MKRS Nr. 06/2017 për Caktimin e Institucionëve Publike të Trashëgimisë Kulturore, Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturor, si vartëse të MKRS - së janë:

- **Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Prishtinë** (QRTK - Prishtinë) e cila ushtron kompetencat në komunat si: Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Drenas, Lipjan, Fushë Kosovë, Graçanicë.
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në **Mitrovicë** (QRTK - Mitrovicë) ushtron kompetencat në komunat si në Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Zhubin- Potok, Zveçan, Leposaviq.
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në **Pejë** (QRTK - Pejë) ushtron kompetencat në komunat si në Pejë, Deçan, Istog.
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në **Prizren** (QRTK - Prizren) ushtron kompetencat në komunat si: Prizren, Rahovec, Suharekë, Dragash, Malishevë, Mamushë.
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në **Gjilan** (QRTK - Gjilan) ushtron kompetencat në komunat si në Gjilan, Novobërdë, Dardanë, Partesh, Ranillug, Viti, Kllokot, Kamenicë.
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në **Gjakovë** (QRTK - Gjakovë) ushtron kompetencat në komunat si në Gjakovë, Klinë dhe Junik.
- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në **Ferizaj** (QRTK - Ferizaj) - nuk është në funksion të plotë për shkak të mungesës së stafit profesional dhe administrativ. Ushtron kompetencat në komunat si në Ferizaj, Shtime, Shtërpcë, Hani i Elezit, Kaçanik.

- Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore e **Prizrenit** përveç ushtrimit të përgjegjësive dhe kompetencave të saj të përcaktuara me Ligjin nr.02/ L-088 për Trashëgimi Kulturore dhe legjislacionin tjetër përkatës të njëjtë me të gjitha QRTK-të tjera, kjo ushtron përgjegjësi dhe kompetenca të veçanta të përcaktuara me Ligjin nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligjin nr. 04/L-196 për fshatin Zym i Hasit, në rastet kur këto ligje i referohen Institutit për Mbrojtjen e Monamenteve të Prizrenit.

Sipas Rregullores nr. 06/2017 për caktimin e Institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente QRTK kryen këto përgjegjësi:

- 2.1.** Bëjnë identifikimin, inventarizimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore për rajonin, respektivisht, territorin e komunave për të cilin/at është përgjegjëse, në bashkëpunim me institucionet qendrore të përcaktuara në nenin 3 të kësaj rregullore, në mënyren e përcaktuar në nenin 3 i Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore dhe aktin përkatës nënligjor.
- 2.2.** Verifikojnë vlerën dhe gjendjen e trashëgimisë kulturore gjatë procesit të inventarizimit dhe vlerësimit pas 7 ditësh të njoftimit të pronarit, si në nenin 3 të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgimi Kulturore.
- 2.3.** Bëjnë përzgjedhjen e gjetjeve dhe objekteve, nga inventari i trashëgimisë kulturore të cilat më pas u propozohen organeve përgjegjëse për t'u dhënë status të mbrojtjes së përkohshme në kuadër të Listës së trashëgimisë kulturore.
- 2.4.** Mund të propozojnë asete të trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përhershme.
- 2.5.** Njoftojnë me shkrim pronarët e objekteve që përfshihen në listën e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje brenda 28 ditësh pas shpalljes në gazetën zyrtare.

2.6. Bashkëpunojnë me institucionet qendrore të trashëgimisë kulturore për përcaktimin e prioriteteve për mbështetje financiare të projekteve nga rajoni përkatës të cilat projekte, përmes institucionit përkatës qendror dhe MKRS-së i propozohen Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore sipas nenit 4 të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore.

2.7. Lidhin Grant- Marrëveshje për qasje publike, me pronarët, shfrytëzuesit dhe poseduesit e trashëgimisë kulturore të mbrojtur që është në pronësi private dhe që përfitojnë nga fondet publike për punë rreth konservimit dhe restaurimit, sipas nenit 4, të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore si dhe aktin përkatës nënligjor.

2.8. Koordinojnë veprimet dhe masat e nevojshme me autoritetet lokale në funksion të menaxhimit dhe administrimit të ruajtjes dhe mbrojtjes së aseteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje.

2.9. Vlerësojnë kushtet dhe gjendjen e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe ndërmarrin masat e duhura për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore për rajonet përkatëse. Masat e tilla për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore konsistojnë në:

2.9.1. Propozimin dhe marrjen e masave për mirëmbajtjen e aseteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje.

2.9.2. Pas vlerësimit të detajuar të gjendjes fizike, i propozojnë Institucionit përkatës qendror asetet e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të cilat janë në gjendje të rënde fizike për përfshirjen e tyre në Programin e Intervenimeve Emergjente.

2.9.3. Bëjnë mbikqyrjen e implementimit të masave të sigurisë të cilat i ndërmarrin autoritetet lokale në rast kur asetet e trashëgimisë kulturore paraqesin rrezik për sigurinë e njerëzve dhe të objekteve.

2.9.4. Janë përgjegjëse direkte që të raportojnë tek Institucionet qendrore përkatëse. IKMM-ja, IAK-u dhe MK-ja, në rastet e ndërhyrjeve pa leje të shkruar që ndikojnë në tërësinë ose vlerat e aseteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore.

2.9.5. Njoftojnë autoritetet lokale përkatëse për vendimin e ndaljes së menjëherëshme për një periudhë të pacaktuar kohore të çdo lloj pune të paautorizuar në trashëgimie kulturore, të lëshuar nga institucioni qendror përkatës. Në bashkëpunim me autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato lokale kujdesen për zbatimin e vendimit.

2.9.6. Bëjnë monitorimin e vazhdueshëm të aseteve të trashëgimisë kulturore dhe përcjellin zhvillimet në Zonat Mbrojtëse të tyre. Bëjnë njoftimin e menjëherëshëm të institucioneve qendrore përkatëse për çfarëdo aktiviteti të paautorizuar apo tejkallim të projektit të aprovuar.

2.9.7. Në bashkëpunim me institucionin qendror përkatës kryejnë veprime konservuese dhe restauruese në lidhje me trashëgiminë kulturore.

2.9.8. Hartojnë projektet për intervenime emergjente, si dhe projekte restauruese/konservimit, në përputhje me kriteret, teknikat dhe standartet profesionale e shkencore të projektimit për objektet e trashëgimisë kulturore në përputhje me parimet e kartave dhe konventave ndërkombëtare si dhe me udhëzuesit profesional për trashëgiminë kulturore - mjetet teknike për konservim dhe menaxhim të trashëgimisë kulturore.

2.9.9. Ofrojnë mbështetje profesionale gjatë projektimit të ndërhyrjeve të propozuara sipas standarteve të përcaktuara në nenin paraprak, për të gjithë institucionet, individët dhe OJQ-të, bashkësitë fetare apo subjektet tjera vendore dhe ndërkombëtare që investojnë në asetet e trashëgimisë kulturore.

2.9.10 Bëjnë mbikqyrje e procesit të ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese, kur përcaktohen nga Institucioni qendror përkatës.

2.9.11. Bashkëpunojnë me institucionet qendrore përkatëse, në përcaktimin e radiusit (kufirit) të zonës së mbrojtur të asetit të trashëgimisë kulturore sipas nenit 6 dhe nenit 7 të 4 të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore.

2.9.12. Marrin pjesë në procesin e përcaktimit të ansambleve dhe hapësirave të kozervuara arkitekturale sipas nenit 6 të Ligjit

nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore

2.9.13. Marrin pjesë në përcaktimin e politikave për ruajtjen, menaxhimin dhe shtimin e fushave të konservuara arkitekturale, së bashku me IKMM-në, MKRS-në Institucionet e Pushtetit Lokal dhe Institucioneve përgjegjëse për planifikim hapësinor.

2.9.14. Sigurojnë zbatimin e procedurës së aplikimit përmes klasifikimit të dokumenteve relevante kur paraqiten kërkesat/ projektet për leje për ndërtim ose krijimtari tjetër brenda zonës së mbrojtur të një monumenti arkitektural, apo brenda një hapësire konservuese arkitekturale, ose që ndikon në mjedisin e një ansambli, pranë IKMM-së, si në nenin 10 të kësaj Rregulloreje, si dhe në pajtim me nenin 6 të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore

2.9.15. Japin pëlqimet për vendosjen e materialeve reklamuese në monumentet arkitekturale, ndërtesat e ansambleve ose brenda hapësirave konservuese arkitekturale.

2.9.16. Zbatojnë përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 6 të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore

2.9.17. Përgatitjen e dokumentacionet vlerësues, me të cilin e rekomandon institucionin qendror përkatës për dhënjen e autorizimit/lejes për përdorimin me qëllim përfitimi ekonomik dhe kulturor të trashëgimisë arkitekturale në rastet ku vlerat e trashëgimise arkitekturale janë të mbrojtura.

2.9.18. Zbatojnë procedurën e aplikimit përmes klasifikimit të dokumenteve relevante, kur paraqiten kërkesat/ projektet për leje për ndërtim ose krijimtari tjetër në trashëgiminë e ditur arkeologjike, pranë IAK-u, si në nenin 11 të kësaj Rregulloreje, si dhe në pajtim me nenin 7 të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore

2.8.19. Njoftojnë autoritetet lokale për planifikim dhe ndërtim, për vendimin e IAK-ut në lidhje me dhënien apo refuzimin e lejes si në nenin 11 të kësaj Rregulloreje, si dhe në pajtim me nenin 7 të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore. Në rast të aprovimit të lejes, QRTK-ja njofton autoritetet lokale se ku duhet të vendoset krijimtaria e tillë.

2.9.20. Pranojnë dhe administrojnë informacione në lidhje me zbulimet arkeologjike, nga zbuluesit apo investitorët gjatë punëve ndërtuese. Informacionet e tilla QRTK-ja i bart në IAK për procedurë të mëtejme.

2.9.21. Pranojnë dhe administrojnë informacione në lidhje me zbulimet e rastësishme arkeologjike, në pajtim me nenin 7 të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore. Informacionet e tilla QRTK i bartë në IAK për procedurë të mëtejme.

2.9.22. Marrin pjesë në procesin e përcaktimit të rezervateve arkeologjike sipas nenit 7 të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore.

2.9.23. Zbatimin e procedurës së aplikimit përmes klasifikimit të dokumenteve relevante, kur paraqiten kërkesat/ projektet për leje për ndërtim ose krijimtari tjetër brenda zonës së mbrojtur të një vendi të trashëgimisë arkeologjike, pranë IAK, si në nenin 11 të kësaj Rregulloreje, si dhe në pajtim me nenin 7 të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore.

2.9.24. Zbatimin e procedurës së aplikimit përmes klasifikimit të dokumenteve relevante, kur paraqiten kërkesat / projektet për leje për ndërhyrje në tokë brenda zonës së mbrojtur në kuptimin e veprimtarive bujqësore.

2.9.25. Pranimin dhe administrimin e informacionit nga pronarët privat në lidhje me çfarëdo dëmtimi, shkatërrimi, humbje ose vjedhje të një objekti të përcaktuar si trashëgiminë e luajtshme, në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore.

2.9.26. Njoftimin e një pronari të një objekti të trashëgimisë së luajtshme, me qëllim të ndërmarrjes së masave të domosdoshme siguroese dhe mbrojtese, sipas nenit 9 të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore.

2.9.27. Zbatojnë procedurën e aplikimit përmes klasifikimit të dokumenteve relevante, kur paraqiten kërkesat/ projektet për leje për konservim/ restaurim ose krijimtari tjetër në trashëgiminë e ditur të luajtshme, pranë MK si në nenin 14 të kësaj Rregulloreje, si

dhe në pajtim me nenin 7 të Ligjit nr. 02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore.

2.9.28. Monitorimin, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e vazhdueshme në grupet punuese të institucioneve lokale dhe qendrore, gjatë procesit të hartimit dhe aprovimit të rregulloreve dhe planeve hapësinore urbanistike, me qëllim të harmonizimit të tyre me kriteret dhe standardet e menaxhimit të monumenteve të trashëgimisë kulturore duke përfshirë edhe zonat mbrojtëse të tyre.

2.9.29. Bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen aktive gjatë hartimit të Planeve të Konservimit me Autoritetet Lokale dhe Institucionet tjera.

Reflektim i punëve të QRTK-ve është bërë në kapitullin e parë. Gjithsesi, vlenë të theksohet se sikurse çdo institucion tjetër vartës, **as QRTK-të nuk kanë ndonjë uebfaqe** por disa nga to janë aktive në rrjete sociale, kurse dhe qasja në dokumente të tyre publike është mjaftë e vështirë.

Në mënyrë që të kemi informacione më të hollësishme rreth punës së QRTK-ve, secilës QRTK iu janë dërguar pyetësorë specifik përmes rrjeteve elektronike. Përkunder tentim kontaktimeve të vazhdueshme përmes emailit dhe rrjetit telefonik, **nga 7 QRTK, vetëm QRTK nga Mitrovica iu është përgjigjur pyetësorëve të përgatitur. Kurse, asnjëra nga QRTK-të nuk ka ndarë me ne shpenzimet e tyre financiare ndër vite.**

Në këtë rast ChwB bënë thirrje që këto institucione të jenë transparente dhe të hapura për shoqërinë civile, duke respektuar të drejtën ligjore të çdo personi fizik apo juridik për qasje në informacion dhe dokumente publike.

6.6. INSPEKTORATI PËR TRASHËGIMI KULTURORE- ITK

ITK ka status Departamenti në kuadër të strukturës organizative të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), raporton tek ministri i MKRS, si dhe në mandat ka vlerësimin e kushteve dhe gjendjes të ruajtjes së autenticitetit dhe integritetit të aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje, në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin për trashëgimi kulturore.⁵⁶ Inspektorati i Trashëgimise Kulturore është funksionalizuar në vitin 2018, bazuar në Ligjin nr. 02/L-88 për trashëgmi kulturore, neni 4, pika 4.12 dhe Rregullores nr. 01/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të MKRS, neni 35. Në rregulloren nr. 01\2020 për kompetencat, autorizimet dhe procedurat e inspektimit dhe të ankesave të Inspektoriatit të Trashëgimise Kulturore përcaktohen qartë përbërja dhe funksioni i ITK në vend. Kjo rregullore është hartuar në fund të vitit të kaluar, 14 dhjetor 2020.

Sipas Ligjit nr. 02/L-88 për Trashëgmi Kulturore, detyrat dhe kompetencat e ITK janë :

4.12. Inspektorët e caktuar nga Ministria, në pajtim me një akt nënligjor bazuar në këtë ligj, vlerësojnë kushtet dhe gjendjen e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe ndërmarrin masat e duhura për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

4.13. Pronari, poseduesi ose shfrytëzuesi i trashëgimisë kulturore të mbrojtur është i obliguar të mos pengojë inspektimin që kryhet sipas nenit 4.12.

4.14. Cilado ndërhyrje që ndikon në tërësinë ose vlerat e trashëgimisë kulturore kërkon leje të shkruar nga institucioni kompetent.

4.15. Institucioni kompetent urdhëron ndaljen e menjëhershme për një periudhë të pacaktuar kohore të çdo lloj pune të paautorizuar në trashëgiminë kulturore.

4.16. Veprimet konservuese dhe restauruese në lidhje me trashëgiminë kulturore bëhen nga Institucioni kompetent dhe personat juridik dhe fizik, të licencuar nga Ministria, në pajtim me një akt nënligjor të bazuar në këtë ligj. Puna e bërë me licencë mbikëqyret nga Institucioni kompetent.

4.17. Projektet konservuese dhe restauruese të trashëgimisë kulturore zbatohen vetëm pas aprovimit të shkruar për to nga Institucioni kompetent.

4.18. Ndërhyrjet konservuese dhe restauruese bëhen në pajtim me aktin nënligjor në pajtueshmëri me nenin 4.17 të këtij ligji.

4.19. Procesi i ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese bëhet nën mbikëqyrjen e institucionit kompetent.

4.20. Institucioni kompetent ndalon punën konservuese dhe restauruese nëse identifikon parregullsi gjatë zbatimit të tyre dhe derisa kushtet e nevojshme të plotësohen për përmbyllje të punëve të tilla.

Përkundër sfidave të ndryshme, puna e Inspektoratit, në veçanti vitin e fundit, vlerësohet pozitivisht, dhe angazhimi i tyre është në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre, në vlerësimin e kushteve dhe ndërmarrjes së masave të duhura për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Reflektim i punëve konkrete të Inspektoratit për Trashëgimi Kulturore është bërë në kapitullin e parë.

56 Gjejlane Hoxha, inspektore ne ITK

6.6.1. SFIDAT E INSPEKTORATIT PËR TRASHËGIMI KULTURORE- ITK

ITK përbëhet nga personeli administrativ, inspektorëve dhe drejtorit. Aktualisht, të punësuar janë 3 inspektorë, 1 punëtorë administrative dhe drejtori. Gjatë viteve të kaluara, ky departament ka funksionuar edhe me vetëm një inspektor (korrik - tetor 2019). Sipas inspektorëve të intervistuar⁵⁷, numri i vogël i të punësuarve në këtë fushë shkakton ngarkesë të madhe e po ashtu rrezikon të ketë mangësi në plotësimin e plotë të obligimeve të tyre.

Sipas të intervistuarëve, Inspektorati nuk ka pasur asnjëherë trajnime të stafit punues. Në vitin 2018, edhe pse ishte planifikuar një vizitë zyrtare në Holandë për stafin e inspektoratit, përfaqësues të MKRS, përkatësisht të departamentit të Trashëgimisë Kulturore kishin marrë pjesë në vend të tyre.

Edhe pse sipas ligjit të trashëgimisë kulturore, neni 4.10 `obligon çdo person juridik apo fizik të kujdeset për mbrojtjen e tërësisë së trashëgimisë kulturore nëse ai/ajo është pronar, posedues ose shfrytëzues i kësaj trashëgimie kulturore`, kjo nuk duket të jetë e praktikueshme në gjendjen aktuale të këtyre asetëve në terren. Sipas nenit 4.11, `Cilido person fizik apo juridik që dëmton trashëgiminë kulturore, pavarësisht nga marrëdhëniet e tyre pronësore me të, dënohet ose sanksionohet në bazë të Kodit Penal të Kosovës, Ligjit për Kundërvajtje dhe në pajtim me nenin 11 të këtij ligji.` Përkundër kallëzimeve penale për punë të jashtëligjshme në asetet e trashëgimisë kulturore, dënimet e ulëta të dhëna nga institucionet përkatëse, paraqiten si problem për ku-

57 *Inspektoret e intervistuar Pajtim Zogaj dhe Labëri Dakaj*

fizimin apo ndalimin e intervenimeve të tilla në të ardhmen. Për më shumë rreth punës së Inspektoratit, dëmtimeve, ndalimeve dhe kallëzimeve penale në komunat përkatëse, mund të i gjeni në kapitullin e I-rë.

Mungesa e bashkëpunimeve ndërinstucionale, respektivisht mungesa e komunikimit në mes të QRTK-ve dhe ITK, është pengesë dhe sfidë esenciale për kryerjen e obligimeve karshi mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në vend. Sipas z. Pajtim Zogaj, përveç gatishmërisë së bashkëpunimit të QRTK-së në Prizren, bashkëpunimi i tyre me QRTK-të e tjera është shumë i mangët.


ITK përballat edhe me mungesë të veturave, si mjete të nevojshme për kryerjen e punëve në terren. Si pasojë, Inspektorati obligohet të kaloj nëpër procedura të gjata dhe jo praktike, çdo herë kur është nevojta e vizitave në terren.

Jostabiliteti politik në vend gjatë viteve të fundit ka ndikuar negativisht në funksionimin e Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore. Prej vitit 2018 deri sot, ky departament ka pasur 4 drejtorë të ndryshëm. Secili nga këta drejtorë, është dashur fillimisht të njihen më afër me punën e Inspektoratit, proceset paraprake dhe përgjegjësitë e tyre, duke shkaktuar vonesa në proceset e tjera të punës.

Sikurse çdo institucion tjetër i përfshirë në këtë hulumtim, edhe ITK nuk ka ndonjë uebfaqe apo platformë online për njoftim rreth punëve të tyre për publikun.

6.6.2. BUXHETI I INSPEKTORATIT PËR TRASHËGIMI KULTURORE- ITK

| ITK | Buxheti dhe shpenzimet e vitit 2018 | | Buxheti dhe shpenzimet e vitit 2019 | | Buxheti dhe shpenzimet e vitit 2020 | | Buxheti dhe shpenzimet e vitit 2021 | |
|----------------------------------|-------------------------------------|-------------|-------------------------------------|------------------|-------------------------------------|------------------|-------------------------------------|------------|
| | Buxheti fillestar | Shpenzimet | Buxheti | Shpenzimet | Buxheti | Shpenzimet | Vleresuar | Shpenzimet |
| Pershkrimi | | | | | | | | |
| Pagat dhe medijtjet | | | | 30,542.00 | | 28,217.00 | 28,217.00 | |
| Mallrat dhe Sherbimet | | | | 9,000.00 | | 9,000.00 | 9,000.00 | |
| Shpenzimet komunale | | | | 0.00 | | 0.00 | 0.00 | |
| Subvencionet dhe transferet | | | | 0.00 | | 0.00 | 0 | |
| Shpenzimet kapitale | | | | 0.00 | | 0.00 | 0 | |
| TOTAL buxheti i shpenzuar | 0.00 | 0.00 | | 39,542.00 | | 37,217.00 | 37,217.00 | |



Buxheti i përgjithshëm i ITK ka pësuar rënie që nga viti 2019, kurse çdo vit ai përballlet me limitime buxhetore, të cilat ndahen nga MKRS.

7. LISTA E TRASHEGIMISË KULTURORE NË MBROJTJE TË PËRHERSHME DHE TË PËRKOHSHME

Në bazë të Kreut 5.1 (e) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001), me qëllim të krijimit të infrastrukturës dhe rregullativës ligjore përkitazi me mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës, Kuvendi i Kosovës, ka miratuar ligjin nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturore.⁵⁸

Ky ligj përfshinë trashëgiminë arkitekturale, arkeologjike, të luajtshme dhe shpirtërore, pavarësisht nga koha e krijimit dhe ndërtime, tipi i ndërtimit, përfituesit, krijuesit ose implementuesit e punës. Ligji në fjalë, ka për qëllim të rregulloj legalisht fushën e trashëgimisë kulturore në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen, qasjen publike, komunikimin dhe kërkimin e burimeve të domoshme.

Po ashtu, ky ligj dhe udhëzues të tjerë përkatës, përcaktojnë ndarjen e trashëgimisë kulturore, që përzgjedhen për ruajtje dhe mbrojtje nga institucioni kompetent, dhe specifikojnë kriteret në lidhje me rëndësinë e trashëgimisë, parimet dhe kushtet operationale për procesin e vlerësimit, dokumentacionin mbështetës dhe formën e raportit të procesit të vlerësimit. Në kriteret e dhëna në lidhje me rëndësinë e trashëgimisë janë veçuar rëndësia historike, estetike dhe shkencore e një asemi. Në to potencohet rëndësia e ndërlidhjes së ngjarjeve me njerëzit dhe aseteve përkatëse, rëndësia e asetit në stil, përsosmëria teknike, bukuria, cilësia e dizajnit dhe të punuarit, asete me vlerë dhe studim shkencor dhe asete me rëndësi shpirtërore të cilat kontribuojnë në identitetin dhe kohezionin social të një komuniteti përkatës.

Asetet e trashëgimisë kulturore, fillimisht hyjnë në listën e aseteve në mbrojtje të përkohshme, për një afat kohor 1 vjeçar. Pas një viti, këto asete duhet të hyjnë në listën e aseteve në mbrojtje të përhershme. Sipas Ligjit nr.02/L-88, nenit 3.6. Objektet e përfshira

⁵⁸ LIGJI PËR TRASHËGIMINË KULTURORE: <https://gzk.rks-gov.net/Act-Detail.aspx?ActID=2533>

në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme duhet të jenë nën mbrojtje të përkohshme për një vit. E drejta për kompensim për ndonjë humbje financiare bartet në gjykatë nëse objekti nuk është nën mbrojtje të përhershme pas një viti. Kompensimi i tillë vlerësohet nga një komision i pavarur që themelohet nga Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore. Gjithsesi, me hulumtimin e këtyre listave ndër vite, duket qartë që situata në realitet është më ndryshe dhe jo në përputhje me legjislacionin në fuqi. Më poshtë mund të gjeni analizat e listave të aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme dhe të përhershme ndër vite.

7.1. LISTA E TRASHEGIMISË KULTURORE NË MBROJTJE TË PËRKOHSHME

Lista e trashëgimisë kulturore për Mbrojtje të Përkohshme është e definuar dhe përmban propozimet e vlerësimit përkatëse nga institucionet dhe palët e autorizuara me ligj për këto propozime.

Në vitin 2016, lista e trashëgimisë kulturore në Mbrojtje të Përkohshme, ka përfshirë **1534** asete. Ky vlerësim është bërë nga Departamenti për Trashëgimi Kulturor në MKRS. Këto asete sipas vendimit të marrë me datën 10.10.2016, janë në këtë listë nën mbrojtje për periudhën një vjeçare. Prej tyre, në kategorinë e Trashëgimisë Arkeologjike janë **416** asete të ndara në dy nënkat-

egori, Monument/Ansambël me 84 dhe nënkategoria Lokalitet Arkeologjik/ Rezervat me 331. Në kategorinë e Trashëgimisë Arkitektonike gjithsej kanë hyrë në mbrojtje **891** asete, të ndara në nënkategori Monument/ Ansambël me 889 dhe Fushat e Konzervimit Arkitekturor me 2 asete. Në kategorinë e objekteve të luajtshme kanë hyrë **212**, në kategorinë e pejsazheve kulturore **10**, trashëgimi shpirtërore **5**.

Në vitin 2017, listës së trashëgëmisë kulturore në mbrojtje të përkohshme, i janë shtuar 33 asete, duke arritur numrin e aseteve të mbrojtura në **1567**. Ky vlerësim është bërë nga Departamenti për Trashëgimi Kulturor dhe Komisioni për rishikimin e listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme, i emëruar me Vendimin nr. 65/2017 e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Këto asete sipas vendimit të marrë me datën 10.10.2017, janë në këtë listë nën mbrojtje për periudhën një vjeçare. Prej tyre, në kategorinë e Trashëgimisë Arkeologjike janë **432** asete të ndara në dy nënkategori, Monument/Ansambël me 85 dhe nënkategoria Lokalitet Arkeologjik/ Rezervat me 347. Në kategorinë e Trashëgimisë Arkitektonike gjithsej kanë hyrë në mbrojtje **896** asete, të ndara në nënkategori Monument/ Ansambël me 894 dhe Fushat e Konzervimit Arkitekturor me 2 asete. Në kategorinë e objekteve të luajtshme kanë hyrë **214**, në kategorinë e pejsazheve kulturore **14**, trashëgimi shpirtërore **11**.

Në vitin 2018, lista e trashëgëmisë kulturore në mbrojtje të përkohshme, përfshinte **1595** asete, 28 asete më shumë se në vitin paraprak. Ky vlerësim është bërë nga Departamenti për Trashëgimi Kulturor dhe Komisioni për Rishikimin e Listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme, i emëruar me Vendimin nr. 107/2018 të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Këto asete sipas vendimit të marrë me datën 10.10.2018, janë nën mbrojtje për periudhën një vjeçare. Prej tyre, në kategorinë e Trashëgimisë Arkeologjike janë **432** asete të ndara në

dy nënkategori, Monument/Ansambël me 85 dhe nënkategoria Lokalitet Arkeologjik/ Rezervat me 347. Në kategorinë e Trashëgimisë Arkitektonike gjithsej kanë hyrë në mbrojtje **896** asete, të ndara në nënkategori Monument/ Ansambël me 894 dhe Fushat e Konzervimit Arkitekturor me 2 asete. Në kategorinë e objekteve të luajtshme kanë hyrë **214**, në kategorinë e pejsazheve kulturore **14**, Trashëgimi shpirtërore **11**.

Në vitin 2019, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit ka marrë vendim për listën e Trashëgëmisë kulturore në mbrojtje të përkohshme, vendim ky i cili pas një muaji vendimi është anuluar. Në faqen zyrtare të MKRS mungon dëshmia rreth marrjes së një vendimi të ri nga ministri⁵⁹. Sipas të dhënave të mbledhura, nga viti 2019 deri në tetor të vitit 2020 nuk ka pasur asnjë listë të aseteve në mbrojtje të përkohshme. Në këtë mënyrë është rrezikuar ekzistenca e këtyre aseteve edhe më shumë, duke lënë të hapur mundësinë e rrënimit apo degradimit të cilido aset gjatë një viti⁶⁰. Në një rast të tillë, çdo aset që ka pësuar ndonjë intervenim apo edhe rrënim, nuk mund të ndjeket penalisht apo të kërkohet përgjegjësi për veprat e bëra.

Në vitin 2020, lista e Trashëgëmisë kulturore në Mbrojtje të Përkohshme, përfshini **1612** asete. Prej tyre, në kategorinë e Trashëgimisë Arkeologjike janë **433** asete të ndara në dy nënkategori, Monument/Ansambël me 86 dhe nënkategoria Lokalitet Arkeologjik/ Rezervat me 347. Në kategorinë e Trashëgimisë Arkitektonike gjithsej kanë hyrë në mbrojtje **930** asete, të ndara në nënkategori Monument/ Ansambël me 923 dhe Fushat e konzervimit arkitekturor me 7 asete. Në kategorinë e objekteve të luajtshme kanë hyrë **214**, në kategorinë e pejsazheve kulturore **21**, trashëgimi shpirtërore **14**.

59 <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,153>

60 <https://kallxo.com/kulture/mkrs-shkel-ligjin-nuk-publikon-listen-e-trashegimise-kulturore-ne-mbrojtje-te-perkohshme/>

Përkundër faktit që Ligji i Trashëgimisë Kulturore thotë diçka tjetër, Ligji nr.02/L-88, Nenit 3.6. `Objektet e përfshira në Listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme duhet të jenë nën mbrojtje të përkohshme për një vit` dhe pas asaj të hyjnë në mbrojtje të përhershme, asetet kanë mbetur në listë të përkohshme për çdo vit. **Pasojat e një veprimi të tillë e po ashtu shtimi i aseteve të reja në listë pa ndonjë plan konkret të**

trajtimit të tyre në të ardhmen, janë shtjelluarmë lartë.(sfidat e MKRS)

Vlenë të ritheksohet që **MKRS nuk e ka kryer obligimin e saj në propozimin e aseteve specifike të përkohshme për të kalur në listën e aseteve në mbrojtje të përheshme.** Kërkesa e fundit e bërë nga kjo ministri ishte në vitin 2015.

| TK në Mbrojtje të Përkohshme | | VITI | | | | |
|------------------------------|-----------------------------------|-------------|-------------|-------------|-----------|-------------|
| KATEGORIA | NËNKATEGORIA | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
| Tashëgimia Arkeologjike | Monument / Ansambel | 84 | 85 | 86 | ? | 86 |
| | Lokalitet Arkeologjik/ Rezervat | 332 | 347 | 347 | ? | 347 |
| Trashëgimia Arkitektonike | Monument/ Ansambel | 889 | 894 | 921 | ? | 923 |
| | Fushat e konzervimit arkitekturor | 2 | 2 | 2 | ? | 7 |
| Objektet e luajtshme | | 212 | 214 | 214 | ? | 214 |
| Pejsazhe kulturore | | 10 | 14 | 14 | ? | 21 |
| Trashëgimia shpirtwrore | | 5 | 11 | 11 | ? | 14 |
| TOTAL | | 1534 | 1567 | 1595 | ? | 1612 |
| TK në Mbrojtje të Përhershme | | VITI | | | | |
| KATEGORIA | NËNKATEGORIA | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
| | Monument /Ansambel | 23 | 23 | 23 | 23 | 23 |
| TOTAL | | 23 | 23 | 23 | 23 | 23 |

Në anën tjetër, në buxhetin e rishikuar të datës 28 korrik të këtij viti, janë planifikuar edhe investime të konsiderueshme në revitalizimin e aseteve të trashëgimisë kulturore në tërë regjionin e Kosovës.

Në listën e aseteve të përzgjedhura për investim, janë edhe objekte të cilat nuk janë fare pjesë e listës së aseteve të mbrojtura.

7.2. LISTA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË MBROJTJE TË PËRHERSHME

Sipas rregullores nr.02/2016 për vlerësimin dhe shpalljen e Trashëgimisë Kulturore në mbrojtje të përhershme, përcaktohen kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe shpalljes së TK në mbrojtje të përhershme.

Të gjithë personat juridik dhe fizik kanë të drejtë të propozojnë asete të TK në mbrojtje të përhershme ku të gjithë asetet që janë pjesë e listës së mbrojtjes së përkohshme kanë të drejtë të propozohen. Këto propozime kalojnë në një vlerësim paraprak nga MKRS sipas nenit 4.2 të ligjit për TK dhe nenit 4.3 të Rregullores 05/2008 mbi vlerësimin dhe përzgjedhjen e TK në mbrojtje. Vendimi për përfshirjen e objekteve në listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përhershme të përcaktuar nga Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore, nënshkruhet nga ministri.

Numri i aseteve në listë të mbrojtjes së përhershme nga 1620 asete që janë në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtjen e përkohshme:

“Në intervistën e zhvilluar në KKTK është kuptuar se në vitin 2015, MKRS ka dërguar një listë prej 100 aseteve për adaptim. Nga kjo listë, KKTK i ka adaptuar 23, ndërsa për mungesë dokumentacioni i ka refuzuar 77.14 sipas bashkëbiseduesit në intervistë kjo ka qenë hera e parë dhe e fundit kur KKTK ka pranuar një listë për adaptim nga MKRS, e paraparë në nenin 4 të këtij ligjit. Sipas të intervistuesit, për ta lehtësuar procesin KKTK ka përgaditur Formularin T1 dhe Draftin Grafik T2 si formë për plotësim të dokumentacionit për asetet që propozohen për listën nën mbrojtje të përhershme. Formularët i janë prezentuar MKRS për vërejtje dhe komente.”⁶¹ Gjithashtu, për të lehtësuar procesin e aplikimit për asetet në mbrojtje të përhershme të TK, **KKTK ka krijuar formën elektronike online të formularit.** “Qasje në platformë kanë të gjithë zyrtarët të cilët caktohen nga institucionet vartëse të MKRS. Platforma është zhvilluar gjatë vitit 2018, kurse ka hyrë në funksion në vitin 2019⁶². Gjithsesi, përkundër që kanë kaluar vite prej kur është krijuar kjo platformë, ajo nuk është përdorur asnjëherë nga zyrtarët e MKRS.

Në intervistë me personat zyrtar në MKRS është konfirmuar se institucionet kompetente kanë dërguar vetëm një herë një listë me 100 asetet të propozuara. Në pyetjen se pse nuk janë dërguar të tjera propozime pas vitit 2015, e intervistuar ka deklaruar se arsytet për një situatë të tillë ndërlidhen me ‘ripërseritjen e formave’ dhe me ‘format e komplikuar’ digjitale dhe të shkruara të hartuara nga KKTK, të cilat sipas tyre kanë qenë sfidë për stafin e institucioneve kompetente në varësi të MKRS-së.”⁶³

⁶¹ Hulumtim parlamentar, zbatimi i ligjit nr. 02/l-88 për trashëgimi kulturore, Sali Shoshi

⁶² Raportet të punës të KKTK të vitit 2019, 2020

⁶³ Hulumtim parlamentar, zbatimi i ligjit nr. 02/l-88 për trashëgimi kulturore, Sali Shoshi. Informacionet e shënuara janë konfirmuar edhe në intervistimet e bëra gjatë këtij hulumtimi në 2021.

8. PËRDORIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Planet e menaxhimit paraqesin një sërë parimesh për menaxhimin e mirëfilltë të objekteve të trashëgimisë që përshkruajnë themelet ligjore, procedurat administrative dhe strukturat përfshirë burimet në dispozicion (buxheti, stafi dhe infrastruktura). Megjithatë, efikasiteti i një plani të menaxhimit është i lidhur fort me planin e veprimit, i cili përshkruan hapat e nevojshëm për zbatimin e plotë të planit.

Planet e menaxhimit duhet të hartohen dhe të zbatohen përmes një qasje të bashkërenduar dhe të barazpeshuar, që është e qëndrueshme me kalimin e kohës dhe që forcon identitetin lokal. Me qëllim të përcaktimit të politikave strategjike për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohor të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit dhe Kalasë së Prizrenit, janë hartuar Planet e Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kalanë e Prizrenit. Iniciativa për fillimin e hartimit të planeve të tilla është marrë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me rrjetin e organizatave të Kulturës në Prizren përmes një memorandumi të mirëkuptimit të nënshkruar në gusht të vitit 2016. Kjo ka ardhur si nevojë për adresimin e problemeve të akumuluar ndër vite në qendrën historike dhe gjithashtu për përmbyshjen e obligimit nga Ligji për Trashëgimi Kulturor nr. 02/L88 dhe Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit nr. 04/L-066. Element shumë i rëndësishëm i procesit të përpilimit të këtyre planeve është gjithë përfshirja gjatë tërë procesit. Në kuadër të këtij procesi, përmes formave të ndryshme të komunikimit (takime joformale, takime zyrtare, takime konsultative me grupe të ndryshme institucionale dhe ato të shoqërisë, punëtori e prezantime publike) janë konsultuar palët e interesit me të drejtat, detyrimet dhe interes në fushat e mbrojtjes, ruajtjes, promovimit dhe shfrytëzimit socio-ekonomik të këtyre aseteve të trashëgimisë kulturore.

Megjithëse, sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturorë, menaxhimi i trashëgimisë kulturore nuk është i detyrueshëm, ai përmendet

në nenin 6.6 "Politikat për ruajtjen, menaxhimin dhe shtimin e fushave të konservuara arkitekturore përcaktohen së bashku nga institucioni kompetent dhe autoritetet qendrore dhe lokale për planifikim hapësinor."

Qendra Historike e Prizrenit sipas nenit 1 të Ligjit nr. 04/L-066 (2012) trajtohet si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe e klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

8.1 PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Plani i Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit 2019-2028 adreson sfidat e Qendrës Historike të Prizrenit dhe jep zgjidhjet për to duke u bazuar në praktika dhe standarde ndërkombëtare. Plani i Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit në pjesën e parë të tij, pjesën ekzekutive të dokumentit, përmban informata mbi metodologjinë e aplikuar, deklaratën e rëndësisë, vizionin e përcaktuar duke përfshirë objektivat dhe planin e veprimit. Në pjesën e dytë, pjesën analitike të dokumentit janë të radhitura në formë të anekseve trajtimi i temave të veçanta të Qendrës Historike të Prizrenit. Secili aneks parashtron natyrën e problemit, analizën e problemit dhe jep konkluzione e rekomandime specifike. Metodologjia e hartimit Plani i Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit është bazuar në parimet e Kartës së Burra-s dhe prak-

tikat ndërkombëtare të menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Gjithëpërfshirja është element që e ka karakterizuar procesin e hartimit të planit dhe kjo është arritur përmes takimeve joformale, takimeve zyrtare, takimeve konsultative me grupe të ndryshme institucionale dhe me komunitetin. Janë mbajtur punëtori e prezantime publike ku janë konsultuar palët e interesit me të drejtat, detyrimet dhe interes në fushat e mbrojtjes, ruajtjes, promovimit dhe shfrytëzimit socio-ekonomik të Qendrës Historike të Prizrenit.

Sipas Planit të Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit, vlerat, rëndësia dhe autenticiteti janë tema të rëndësishme dhe bazë themelore për përcaktimin dhe udhëzimin se çka është me rëndësi, çka duhet të ruhet, dhe ndihmojnë në përcaktimin e prioritetëve për të ardhmen.

Vlerësimi i Qendrës Historike të Prizrenit është strukturuar në tri nivele: niveli i ndërtesës; niveli i zonave; dhe niveli i qytetit.

Plani i veprimit i këtij dokumneti parasheh që Qendra Historike e Prizrenit në dhjetë vitet e ardhshme do të jetë shtyllë e rëndësishme e promovimit të Kosovës dhe zhvillimit të qëndrueshëm e Komunës së Prizrenit. Në funksion të kësaj, Ministria e Kulturës, Rinisë e Sportit, Komuna e Prizrenit dhe partnerë të tjerë do të punojnë në avansimin e mëtejshëm të sistemit të mbrojtjes, në bashkëpunimin efektiv dhe rritjen e pjesëmarrjes në proceset e planifikimit dhe të menaxhimit të zhvillimeve, si dhe në promovimin e vlerave reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore.

Për të arritur synimet dhe objektivat parashtruara në planin e menaxhimit të QHP duhen ndërmarrë një numër veprimesh sikurse:

- Themelimi dhe funksionalizimi i Zyres së Qendrës Historike
- Mbrojtja dhe promovimi i QHP përmes nominimit të monumenteve në Listën e Trashëgimisë Botërore në UNESCO
- Rregullimi i bazës ligjore për funksionim të mirëfilltë të pro-

cesit të mbrojtjes, menaxhimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore

- Inventarizimi i plotë i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe prioritizimi i ndërhyrjeve konservuese në QHP
- Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore përmes procesit të planifikimit hapësinor dhe zhvillimin urban
- Mbrojtja, zhvillimi dhe promovimi i QHP përmes qasjes së rigjenerimit urban të nënzonave dhe revitalizimit të ndërtesave publike
- Promovimi i trashëgimisë shpirtërore dhe rritja e kapaciteteve muzeale të qytetit
- Shndërrimi i QHP në mjedis miqësor për ruajtjen dhe promovimin e natyrës
- Zhvillimi i edukimit formal dhe joformal rreth trashëgimisë dhe diversiteti kulturor
- Ngritja e vetëdijes në fushën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- Rritja e cilësisë së festivaleve dhe shëndërrimi i qytetit në qendër të festivaleve gjatë tërë vitit
- Dokumentimi i të gjitha shtëpive tradicionale brenda QHP dhe kategorizimi i tyre për intervenim dhe potenciale për të ardhmen
- Ngritja e vetëdijes së pronarëve të shtëpive tradicionale rreth vlerave të trashëgimisë dhe menaxhimit të pronave të tyre
- Promovimi dhe brendimi i qytetit të Prizrenit
- Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik përmes turizmit kulturor
- Rritja e cilësisë së festivaleve dhe shëndërrimi i qytetit në qendër të festivaleve gjatë tërë vitit
- Hartimi i dokumentacioneve relevante për të siguruar lëvizshmëri të sigurtë, ambient të pastër dhe infrastrukturë sipas standardeve bashkëkohore
- Zhvillimi i politikave të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për menaxhim të hapësirave publike

- Plani i Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit është plan strategjik multisektorial dhe zbatimi i tij involvon institucione të ndryshme të nivelit qendror, lokal dhe agjencitë tjera zbatuese. Përderisa nuk përcaktohet me ligjin e ri për trashëgimi kulturore institucioni kompetent për mbikëqyrje të zbatimit të planeve të menaxhimit, mbikëqyrjen e zbatimit të PMQHP ta bëjë një Komision Mbikëqyrës i veçantë që përcaktohet nga MKRS, duke përfshirë të gjitha palët e interesit.

8.2 PLANI I MENAXHIMIT PËR KALANË E PRIZRENIT

Plani i menaxhimit për Kalanë e Prizrenit është hartuar në kuadër të projektit ‘Ruajtja e Kalasë së Prizrenit’, financuar nga Ambasada e SHBA-së dhe implementuar nga organizata Trashëgimia Kulturore pa Kufijë (CHWB Kosova).

Plani i menaxhimit për Kalanë e Prizrenit e përshkruan rëndësinë dhe historinë e Kalasë së Prizrenit, si dhe veprimet e nevojshme që duhet të ndërmerren për menaxhimin e qëndrueshëm të këtij lokaliteti. Procesi i hartimit të këtij plani është zhvilluar në disa faza dhe ka përfshirë të gjitha palët e interesit. Në këtë proces kanë marrë pjesë institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e Kalasë së Prizrenit, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të komunitetit si dhe ekspert të profileve të ndryshme. Fillimisht janë mbajtur takime dhe punëtori me të gjitha palët e përfshira dhe si veprim i parë është bërë vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe janë vendosur objektivat. Më tutje janë identifikuar çështjet që duhen

të adresohen përmes planit të menaxhimit të cilat janë sistemuar nëpër fusha të ndryshme të veprimit. Janë përcaktuar objektivat, janë definuar aktivitetet dhe janë identifikuar palët përgjegjëse, afatet, kostot e përafërta dhe burimet e financimit.

Plani gjithashtu ka përcaktuar kornizën për bashkëpunim midis institucioneve, grupeve dhe individëve që marrin pjesë në menaxhimin e lokalitetit. Plani i menaxhimit për Kalanë e Prizrenit është hartuar në bashkëpunim me palët e interesit dhe diskutimet me ekspertë, ku është përcaktuar organogrami i menaxhimit, rregullorja e brendshme dhe marrëveshjet midis palëve të interesit. Dokumenti përmban objektivat kryesore dhe planin e veprimit për pesë vite.

Palët e interesit që drejtpërdrejt ndikojnë në planin e menaxhimit të Kalasë së Prizrenit janë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Komuna e Prizrenit; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore; Instituti Arkeologjik i Kosovës; Këshilli për Trashëgimi Kulturore të Prizrenit; Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore (Prizren); Banorët lokal, pronarët, shfrytëzuesit dhe përfituesit; Ekspertët (hulumtime, studime, dokumentime dhe mbikëqyrje); Komuniteti i biznesit (ofronjë shërbime, tërheqin vizitorët); Donatorët (mbështetja financiare, ngritja e kapaciteteve, monitorim); Shoqëria civile (monitorim, mbështetje në promovimin dhe ngritjen e fondeve).

Rëndësia e lokalitetit dhe gjendja e tij e përgjithshme ekzistuese janë analizuar dhe prezantuar në pjesën e parë të dokumentit, ku përshkruhen karakteristikat dhe vlerat e Kalasë së Prizrenit si dhe veprimet që janë ndërmarrë deri tani në këtë lokalitet. Gjithashtu është bërë një krahasim me të gjitha vendet, si ato të zhvilluara apo që janë në zhvillim e sipër, në mënyrën se si investojnë në ruajtjen e qendrave të tyre të vjetra me projekte të ndryshme me theks të veçantë në monumentet e trashëgimisë kulturore për të krijuar mundësitë e rritjes së të ardhurave dhe rritjes ekonomike.

Janë potencuar edhe faktorët që ndikojnë në këtë proces si ata politik, ekonomik, shoqëror, teknologjik, mjedisor e legjislativ.

Objektivat e përcaktuara në planin e menaxhimit të Kalasë së Prizrenit përfshijnë: Krijimin e një ambienti të ri për kënaqësi kulturore dhe natyrore; Krijimin e të kuptuarit më të mirë të Kalasë së rehabilituar; Paraqitjen e një koncepti të ri të integruar të vlerave të trashëgimisë dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm për përfitime sociale, ekonomike dhe kulturore.

Plani i menaxhimit ka prezantuar vizionin për Kalanë e Prizrenit: Kalaja Prizrenit, kurorë e qytetërimeve, pikëtakim i brezave që rrezaton lashtësi, identitet dhe ardhmëri.

Janë përcaktuar nëntë fusha të veprimit me objektivat gjenerale sikurse: konservimi dhe adaptimi; korniza institucionale dhe ligjore; edukimi dhe hulumtimi; zhvillimi ekonomik dhe i turizmit; komunikimi: Interpretimi, prezantimi dhe promovimi; mjedisi; planifikimi hapësinor; infrastruktura dhe menaxhimi i riskut. Gjithashtu dokumenti përmban planin e detajuar të veprimit për Kalanë e Prizrenit.

Për menaxhimin e të gjitha çështjeve që lidhen me Kalanë e Prizrenit është kërkuar themelimi i një njësie përgjegjëse menaxhuese. Kjo njësi menaxhuese për Kalanë e Prizrenit të emërohet me vendim të Ministrit të MKRS-së me këtë përbërje: Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit – Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, Institutit Arkeologjik i Kosovës dhe Komuna e Prizrenit.

Bazuar në Ligjin nr.02/L-88 Ligji për Trashëgimi Kulturore, Ligji nr.04/L-66 për Qendrën Historike të Prizrenit, Ligji nr. 03/L-39 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Rregulloren (MKRS) nr.06/2017 për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në cilësinë e institucionit kompetent, institucionet përgjegjëse vartëse të MKRS-

së dhe institucionet tjera të nivelit qendror dhe lokal obligohen t'i ushtrjnë detyrat dhe përgjegjësitë në zbatim të këtij plani.

Implementimi i planit të menaxhimit të Kalasë së Prizrenit varet nga ajo se sa e suksesshme do të jetë struktura menaxhuese në ngritjen e fondeve dhe masave nxitëse. Gjithashtu dokumenti thekson se kontributi financiar nga buxheti i shtetit është i domosdoshëm për të mbuluar kostot e implementimit të planit të menaxhimit.

8.3 MIRATIMI DHE PUBLIKIMI I PLANEVE TË MENAXHIMIT PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT DHE KALANË E PRIZRENIT

Planet e Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kalanë e Prizrenit janë miratuar dhe prezantuar nga Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryetari i Komunës së Prizrenit me 17 dhjetor 2020.

Ndonëse këto dokumente janë prezantuar në fund të vitit 2020, institucionet përgjegjëse lokale në implementimin e këtyre planeve nuk janë njoftuar zyrtarisht për miratimin e këtij plani nga ana e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Nga takimet e zhvilluara dhe komunikimi me institucionet përgjegjëse për implementimin e Planit, sikurse Komuna e Prizrenit

(Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Arsim, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Zyra për Informim e Komunës së Prizrenit) dhe Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë del se deri në tetor 2021 kur edhe janë zhvilluar takimet dhe komunikimi me institucionet e lartpërmendura, këto të fundit nuk janë njoftuar zyrtarisht për miratimin e Planeve të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kalanë e Prizrenit dhe rrjedhimisht edhe për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me implementimin e këtyre planeve. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka publikuar vetëm me datë 4 Tetor 2021 Planet e Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kalanë e Prizrenit në uebfaqen zyrtare.

9. PËRFUNDIMI

Kapitulli I: GJENDJA FIZIKE E TRASHËGIMISË KULTURORE NË TERREN

- Asetet e trashëgimisë kulturore përballen me sfida sa i përket ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të tyre.
- Shumica e aseteve trashëgimisë kulturore të kategorisë arkitekturore janë në gjendje të mirë dhe mesatare fizike si dhe vazhdojnë të mbesin në gjendje të njejtë fizike. Megjithatë nuk mungojnë asetet të cilat janë në gjendje të keqe fizike, pranë shkatërrimit të tërësishëm apo edhe ato të cilat janë rrënuar plotësisht.
- Në disa raste ka prioritizim të gabuar, intervenohet në ndërtesa të reja krahas atyre të cilat janë në rrezik dhe fokusi i intervenimi është në rajone të caktuara të Kosovës.
- Në disa raste, vet pronarët e aseteve janë shkaktar se pse nuk intervenohet në disa asete nga institucionet përgjegjëse duke refuzuar intervenimin.
- Mungesa e numrit të inspektimeve dhe përditësimi i të dhënave nga terreni kontribuon që në raste të caktuara të përkeqësohet gjendja fizike e disa aseteve apo edhe të mungojnë të dhënat e përditësuara nga terreni.
- Mungesa e kapaciteve të mjaftueshme profesionale interdisiplinare për hartimin e projekteve të restaurimit paraqitet si njëri nga shqetësimet me të cilat përballen QRTK-të.
- Vlerësimi i projekteve nga IKMM është po ashtu një nga problemet në realizimin e projekteve. Ky proces në shumë raste merr shumë kohë derisa është jashtëzakonisht e rëndësishme që ky vlerësim të bëhet më shpejt, veçanërisht kur bëhet fjalë për masa preventive e intervenime emergjente në asete.
- Mungesa e komunikimit dhe bashkëpunimi ndër institucional rrezikon mbledhjen e të dhënave statistikore të koordinuara si mjet matës dhe kontrollues për dëmtimin e aseteve të trashëgimisë kulturore.
- Zyrat për statistika në organet përgjegjëse nuk kanë të dhëna mbi dëmtimin e aseteve të trashëgimisë kulturore si kategori.
- Dëmtimi i trashëgimisë kulturore nuk trajtohet me prioritet nga institucionet e drejtësisë, Gjykatat Themelore, Prokuroritë Themelore, Policia e Kosovës.
- Ndjekja dhe gjykimi i rasteve që kanë të bëjnë me dëmtimin e trashëgimisë kulturore, në përputhje me përkufizimet e dhëna në Kodin Penal të Kosovës është i dobët kur në vitin 2018 Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka trajtuar 6 lëndë dhe ka dhenë 1 dënim me kusht kurse në vitin 2019 nga 7 lëndë të trajtuara ka dhënë 2 dënime me kusht.
- Gjykatat Themelore, për dëmtimin e trashëgimisë kulturore ka dhënë dënime minimale dhe gati të papërfillshme dhe kjo ka për pasojë vazhdimin e dëmtimit të trashëgimisë kulturore.
- Shkalla e dëmtimit të aseteve të trashëgimisë kulturore është shumë e lartë në krahasim me ndëshkueshmërinë për kryerjen e veprave në lidhje me dëmtimin e trashëgimisë kulturore.
- Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra për Statistika në KPK nuk posedon të dhëna lidhur me kategorinë e trashëgimisë kulturore. Zyra në databazën e vet nuk e ka të specifikuar kategorinë që ndërlidhet me trashëgiminë kulturore.
- Numri i inspektorëve në Inspektoratin për Trashëgimi Kulturore është shumë i vogël në krahasim me hapësirën dhe numrine aseteve që duhet të mbulojnë, inspektojnë

Kapitulli II: PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

- Sektori i planifikimit hapësinor e trajton trashëgiminë kulturore vetëm si çështje formale, e cila shpesh përfundon vetëm me konstatim për gjendjen ekzistuese dhe pa analizë për mundësitë e përfshirjes si faktor i rëndësishëm për zhvillim në përgjithësi.
- Sektori i trashëgimisë kulturore nuk ka të krijuar një sistem të mirëfillt në bazë të cilit do të standardizohej procesi i inventarizimit dhe përditësimit të të dhënave.
- Sektori i trashëgimisë kulturore nuk investon në ngritjen profesionale të stafit për trajtim dhe menaxhim të të dhënave hapësinore.
- Sektori i trashëgimisë kulturore nuk ka përcaktuar zonat mbrojtëse të monumenteve nën mbrojtje të përkohshme.
- Sektori i trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor nuk i ka të identifikuar kërcënimet natyrore që i rrezikojnë asetet e TK-së.
- Sektori i trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor nuk i kanë të integruara informatat bazike në softuerin GIS.
- Sektori i trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor nuk ka strukturë menaxhuese për shfrytëzimin e këtyre të dhënave dhe zhvillimin e analizave për trajtim të TK-së.
- Niveli qendror nuk ka bërë ndonjëherë kërkesë për heqjen e lokaliteteve të trashëgimisë kulturore të Kosovës nga lista e Institutit për mbrojtjen e monumenteve në Republikën e Serbisë.
- Niveli lokal është pasiv në përpilim të inventarit të brendshëm të TK-së dhe krijimit të listave për përmbajtjet kulturore të komunave respektive.
- Niveli lokal ka mangësi të theksuar në stafin profesional që bën bartjen e të dhënave nga terreni në GIS dhe shfrytëzimin e softuerit GIS në zhvillimin e analizave për fushën e trashëgimisë kulturore.

Kapitulli III: REFLEKTIM I PUNËS SË INSTITUCIONEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

KKTK

- KKTK ka krijuar formën elektronike online të formularit për procesin e aplikimit për asetet në mbrojtje të përhershme të TK
- Është institucioni i vetëm që ka uebfaqe zyrtare
- Ka nevojë për ngritje profesionale të personelit dhe ndjekje të trajnimeve
- Gjatë viteve të fundit janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi dhe mundësi të reja me organizata dhe institucione vendore dhe ndërkombëtare.
- Është duke u punuar projekti hulumtues, në mbledhjen e fakteve dhe dëshmive për asetet e trashëgimisë kulturore arkitekturale të shkatërruara gjatë luftës së fundit
- Që nga korriku i viti 2018 deri në korrik të këtij viti, 2021, trupi vendimmarrës apo bordi i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor nuk ishte në funksion
- Që nga viti 2015 nuk ka pranuar asnjë propozim nga institucionet përkatëse të trashëgimisë kulturore për shpallje në mbrojtje të përhershme të aseteve të trashëgimisë kulturore.
- Ka mungesë të bashkëpunimit ndër-institucional
- Mungesë e punonjësve profesional
- Vendi i punës së KKTK është i papërshtatshëm dhe nuk i plotëson kushtet bazike të hapësirës së punës
- Raportet e auditimit për KKTK për vitet financiare 2018-2020, në përgjithësi janë vlerësuar pozitivisht por
- Parregullësi janë hasur në mos protokollimin e faturave të pranuar, mosrealizimi i tërësishëm i buxhetit, shkelje ligjore në ngritjen e pozitave të personelit, kryerja e pagesave në avans për kurse të gjuhës angleze

MKRS

- Janë përfunduar aktet:
- Udhëzimi për Kartelën për objektet e trashëgimisë së luajtshme, në reformim pas mbylljes së konsultimit publik
- Udhëzimi për licencimin e personave fizik dhe juridik, në pritje të opinionit nga ZKM/ZPS
- Janë miratuar dy plane të menaxhimit: për Qendren Historike të Prizrenit dhe për Kalanë e Prizrenit.
- Ka realizuar aktivitete në vende të ndryshme të Kosovës për shënimin e ditëve ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore
- Në vitin 2020, ka organizuar disa ekspozita
- Në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës vitin e kaluar ka financuar 6 bursistë në fushat e arkeologjisë, arkeologji-periudha e parahistorisë, periudhës së antikitetit të vonë dhe mesjetë e hershme dhe studime të larta mbi letrat klasike

- Ka filluar mbështetjen financiare edhe në ngritjen profesionale të stafit të tij në të gjitha degët e trashëgimise kulturore
- Ka marrë masa preventive dhe ka bërë intervenime emergjente në një numër të objekteve të trashëgimise kulturore
- Ka mbështetur një mori projekte në fushën e trashëgimisë kulturore nga organizata dhe individ
- Ka vazhduar statusin e aseteve në listë të përkohshme për çdo vit
- Është bërë shtimi i numrit të aseteve të reja çdo vit në listën e TK, pa ndonjë plan apo planifikim në trajtimin e tyre në të ardhmën
- Në asetet të cilat ka pasur intervenim me qëllim të ruajtjes së tyre, nuk ka plan të menaxhimit apo shfrytëzimit e po ashtu ndarje buxhetore në mirëmbajtjen e tyre në të ardhmën
- Ende nuk ka kompani, persona juridik apo fizik të licencuar për restaurimin e aseteve të mbrojtura
- Nuk e ka kryer obligimin e saj në propozimin e aseteve specifike të përkohshme për të kalur në listën e aseteve në mbrojtje të përheshme.
- Nuk ka pasur një strategji të qartë nga MKRS në kthimin e artefakteve dhe dokumentacionit të trashëgimisë kulturore të marra nga Serbia
- Mungese e një platforme online, uebfaqe me të dhëna për informim publik
- Ka mungesë të koordinimit të institucioneve ndërmjet vete
- Mungesë e kontrollit dhe llogaridhënies në investimet në trashëgimi kulturore
- Mangësi në regjistrimin dhe digjitalizimin e trashëgimisë kulturore, përkundër mjeteve financiare të ndara ndër vite
- Mangësi në shenjëzimin dhe ndriçimin e aseteve të trashëgimisë kulturore, përkundër mjeteve financiare të ndara ndër vite
- Në listën e aseteve të përzgjedhura për investim, janë edhe objekte të cilat nuk janë fare pjesë e listës së aseteve të mbrojtura

IAK

- Gjatë vitit 2020, nën objektivat - Hartime, Hulumtime, Inventarizim, Gërmime konzervuese dhe Studime janë realizuar 11 projekte të ndryshme të udhëhequra nga IAK
- Ka bërë Restaurime të artefakteve arkeologjike
- Në kuadër të gërmimeve arkeologjike/ konservimet arkeologjike - menaxhim, roje dhe mirëmbajtje, ka punuar në 4 lokalitete
- Ka pasur një mori projekte bashkëpunuese kombëtare dhe ndërkombëtare
- Çdo vit mbanë punëtori në lokalitetin e Ulpianës
- Ka mangësi në transparencë, llogaridhënie dhe informimit publik
- Problematikë mbetet edhe administrimi dhe menaxhimi i aseteve të trashëgimisë kulturore arkeologjike të cilat janë në prona private

- Dyshime në trafikimin e objekteve të luajtshme
- Problematikë mbetet fakti i mungesës së licencimit të personave juridik dhe fizik për të bërë gërmime arkeologjike
- Nuk ka hapësirë të mjaftueshme për ekspozimin e gjetjeve në muze
- Mungesë e bashkëpunimeve ndërinstitucionale
- IAK dhe MK përballen me mungesë të theksuar të hapësirave adekuate të punës
- Ka mungesë të veturave për punë në terren
- Ankesa zyrtare nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - MKRS janë bërë në drejtim të këtij Instituti për sfidat në shpenzimet buxhetore dhe parregullësitë e tjera në këtë fushë

IKMM

- Në peridhën e tre mujorit të parë të këtij viti IKMM ka arritur të ketë nën përkujdesje dhe mbikqyrje disa projekte konzervuese dhe restauruese
- Është bërë arkivimi i dokumentacionit të komisioneve ndër vite
- Nuk ka statut të brendshëm
- Nuk ka as Organigram
- Mungesa e përkohshme e plotësimit të pozitës së zyrtarit ligjor duke shkaktuar pengesa reale të dukshme në implementimin e punëve në IKMM
- Jo digjitalizimi i proceseve të punës në përgjithësi dhe jokoordinimi i duhur që proceset të cilat janë të ndërlidhura në mes të dy apo më shumë institucioneve që përdorin forma apo metoda të njehta të punës.
- Ka detyra të cilat kanë potencial për të krijuar konflikte interesi
- Mungesë e theksuar e stafit profesional dhe ngritja e kapaciteteve profesionale
- Ka kryer punë të cilat nuk janë në kuadër të fushëveprimtarisë së tyre
- Mungesë të bashkëpunimit ndërinstitucional
- Deri më tani nuk ka ndonjë plan strategjik në mes të IKMM dhe MKRS në kthimin e dokumentacionit të trashëgimisë kulturore nga Serbia
- Ndarja buxhetore për IKMM nuk duket e mjaftueshme në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të implementimit të projekteve të planifikuara

QRTK

- Nuk kanë uebfaqe për informim publik
- Ka mungesë të transparencës dhe qasja në dokumente të tyre publike është mjaftë e vështirë

ITK

- Puna e Inspektoratit vlerësohet pozitivisht, dhe angazhimi i tyre është në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre
- Numër i vogël i inspektoëve të punësuar
- Nuk ka pasur asnjëherë trajnime të personelit punues
- Përkunder kallëzimeve penale për punë të jashtëligjshme në asetet e trashëgimise kulturore, dënimet e ulëta të dhëna nga institucionet përkatëse, paraqiten si problem për kufizimin apo ndalimin e intervenimeve të tilla në të ardhmën
- Mungesa e bashkëpunimeve ndërinstitucionale
- Mungesë të veturave për punë në terren
- Jostabiliteti politik ka pasur ndikim edhe në ITK
- Nuk ka ndonjë uebfaqe apo platformë online për informim publik
- Përballet me limitime buxhetore

Kapitulli IV: LISTA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË MBROJTJE TË PËRHERSHME DHE TË PËRKOHSHME

- Në vitin 2016, Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme, ka përfshirë 1534 asete.
- Në vitin 2017, Listës së trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme, i janë shtuar 33 asete, duke arritur numrin e aseteve të mbrojtura në 1567
- Në vitin 2018, Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme, përfshinë 1595 asete
- Në vitin 2019, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit ka marrë vendim për listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme, vendim ky i cili pas një muaji vendimi është anuluar. Sipas të dhënave të mbledhura, nga viti 2019 deri në tetor të vitit 2020 nuk ka pasur asnjë listë të aseteve në mbrojtje të përkohshme.
- Në vitin 2020, Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme, përfshinë 1612 asete
- Pasoja evidente në mbajtjen e aseteve në listë të mbrojtjes së përkohshme me vite
- Vetëm 23 asete janë në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme

Kapitulli V: PERDORIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

- Planet e menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kalanë e Prizrenit janë hartuar në një proces

- gjithpërfshirës ku të gjitha palët e interesit kanë marrë pjesë në hartimin e këtyre dokumenteve.
- Planet e menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kalanë e Prizrenit janë miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me 17 dhjetor 2020.
 - Planet e menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kalanë e Prizrenit janë publikuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në uebfaqen zyrtare me 4 tetor 2020.
 - Institucionet përgjegjëse për implementimin e Planeve të menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kalanë e Prizrenit nuk janë njoftuar zyrtarisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për miratimin e planeve dhe rrjedhimisht edhe për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me implementimin e tyre.
 - Institucionet përgjegjëse për implementimin e Planeve të menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kalanë e Prizrenit e kanë të paqartë se çfarë MKRS nënkupton me miratimin e planeve dhe çfarë me publikimin e tyre në uebfaqen zyrtare.

BIBLIOGRAFIA

Instituti për Mbrojtje të Monumenteve, Republika e Serbisë (2004) **“Databaza e të dhënave të digjitalizuara”** <http://spomenickulture.mi.sanu.ac.rs/>

Gjykata Themelore Prishtinë (2018, 2019) **Raportet vjetore të Gjykatës Themelore në Prishtinë**
 EC Ma Ndryshe (2020) **“Trashëgimia kulturore në Prizren prej vitesh përballen me sfida të shumta”** <https://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,739#.YYfvDGDMJPY>

Instituti Arkeologjik i Kosovës, IAK, (2018), Raporti i punës për vitin 2018
 Instituti Arkeologjik i Kosovës, IAK, (2019), Raporti i punës për vitin 2019
 Instituti Arkeologjik i Kosovës, IAK(2020), Raporti i punës për vitin 2020
 Instituti Arkeologjik i Kosovës, IAK, (2021), Plani i punës për vitin 2021
 Instituti Arkeologjik i Kosovës, IAK (2018) Raporti financiar për vitin 2018
 Instituti Arkeologjik i Kosovës, IAK (2019), Raporti financiar vitin 2019
 Instituti Arkeologjik i Kosovës, IAK, Përshkrimet e punës për punonjësit

Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, IKMM, (2018), Raporti i punës për vitin 2018
Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, IKMM, (2019), Raporti i punës për vitin 2019
Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, IKMM(2020), Raporti i punës për vitin 2020
Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, IKMM (2018) Raporti financiar për vitin 2018
Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, IKMM (2019), Raporti financiar për vitin 2019
Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, IKMM, (2020), Raporti financiar për vitin 2020

Inspektorati për Trashëgimi Kulturore, ITK, (2019), Raporti i punës për vitin 2019
Inspektorati për Trashëgimi Kulturore, ITK, (2020), Raporti i punës për vitin 2020
Inspektorati për Trashëgimi Kulturore, ITK, (2019), Raporti financiar për vitin 2019
Inspektorati për Trashëgimi Kulturore, ITK, (2020), Raporti financiar për vitin 2020

Këshilli I Kosovës Për Trashëgimi Kulturore, KKTK, (2018), Raporti i punës për vitin 2018
Këshilli I Kosovës Për Trashëgimi Kulturore, KKTK, (2019), Raporti i punës për vitin 2019
Këshilli I Kosovës Për Trashëgimi Kulturore, KKTK, (2020), Raporti i punës për vitin 2020
Këshilli I Kosovës Për Trashëgimi Kulturore, KKTK, (2021), Plani i punës për vitin 2021
Këshilli I Kosovës Për Trashëgimi Kulturore, KKTK, (2018) Raporti financiar për vitin 2018
Këshilli I Kosovës Për Trashëgimi Kulturore, KKTK, (2019), Raporti financiar për vitin 2019
Këshilli I Kosovës Për Trashëgimi Kulturore, KKTK, Raporti financiar për vitin 2020

Këshilli I Kosovës Për Trashëgimi Kulturore, KKTK, (2019), Raporti Për Projektet E Investuara Në Trashëgimi Kulturore Nga Mkrs 2008-2018, (Analizë e gjendjes aktuale të trashëgimisë kulturore)

Kuvendi i Kosovës (2006) Ligji për Trashëgiminë Kulturore të Kosovës, Ligji nr. 02/L-88

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2017) “Indikatorët për planifikim hapësinor në Kosovë”

MMPH, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2015) “Udhëzimi Administrativ MMPH-Nr. 24/2015”

Ministria e Punëve të Brendshme (2015) “Koncept Dokumenti për Sistemin e monitorimit dhe vlerësimit për Reformën e Administratës Publike 2015-2020 në Kosovë”

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (2020) “Prezantimi i Planeve të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kalanë e Prizrenit” <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,2429#.YYfxrWDMJPY>

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (2021) **“Plani i Menaxhimit i Qendrës Historike të Prizrenit 2021-2030”** https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/PMQHP-alb.pdf?fbclid=IwAR3lOhO-_893pb4WogU8wfgOwEdZrBWhiU7NWzjMU2sj8bVS_AKPEA5O90

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (2021) **“Plani i Menaxhimit për Kalanë e Prizrenit”** https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Plani-i-Menaxhimit_Kalaja-e-Prizrenit_2020-2025.pdf?fbclid=IwAR3heqONXyE-Ki9K-uD6LfuMh5E8Pk9YNmdJr-3OTYJmj7t5gFiFgvqtWw8

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, (2008), Procedurat për gërmimet / Hulumtimet Arkeologjike

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, (2008), Aktivitetet konservuese dhe restauruese të Trashëgimisë kulturore

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, MKRS, (2018), Raporti i punës për vitin 2018

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, MKRS, (2019), Raporti i punës për vitin 2019

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, MKRS, (2020), Raporti i punës për vitin 2020

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, MKRS, (2021), Plani i punës për vitin 2021

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, MKRS, (2018) Raporti financiar për vitin 2018

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, MKRS, (2019), Raporti financiar për vitin 2019

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, MKRS, Raporti financiar për vitin 2020

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, MKRS, Përshkrimi i detyrave të punës

OSBE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (2020) “Udhëzues për standardet e hartimit të planeve menaxhuese të trashëgimisë kulturore” <https://www.osce.org/files/f/documents/f/5/461191.pdf>

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, (2019), Studim mbi kënaqshmërinë e turistëve në Prizren

Republika e Kosovës (2013) “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/ nr. 30/ 23 gusht, 2013”

MMPH, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore (2020) “Draft - Harta zonale e Kosovës 2020-2028+”

Republika e Kosovës (2007) “Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës” <http://pbosnia.kentlaë.edu/Comprehensive%20Proposal%20for%20the%20Kosovo%20Settlement.pdf>

Trashëgimia Kulturore pa Kufij, CHWB Kosovo (2011) “Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor”

Rregullore Nr. 01/2016, (2016), Për punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Rregullore, Nr. 02/2010, mbi organizimin e brendshëm, dhe sistematizimin e vendeve të punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Rregullore Nr. 01/2020 Për Kompetencat, Autorizimet Dhe Procedurat E Inspektimit Dhe Të Ankesave Të Inspektoratit Të Trashëgimisë Kulturore, <https://Gzk.Rks-Gov.Net/Actdetail.aspx?Actid=35808>

Rregullore (Mkrs) Nr. 06/2017 Për Caktimin E Institucioneve Publike Të Trashëgimisë Kulturore, Vartëse Të Ministrisë Së Kulturës, Rinisë Dhe Sportit, Në Cilësinë E Institucioneve Kompetente
<https://Gzk.Rks-Gov.Net/Actdetail.aspx?Actid=16466>

Rregullore Nr. 01/2008 Mbi Procedurat Për Gërmimet/Hulumtimet Arkeologjike.
<https://Gzk.Rks-Gov.Net/Actdetail.aspx?Actid=8231>

Rregullore Nr. 02/2008 Mbi Qasjen Publike Në Trashëgiminë Kulturore Në Pronësi Private.
<https://Gzk.Rks-Gov.Net/Actdetail.aspx?Actid=8232>

Rregullore Nr. 03/2008 Mbi Aktivitetet Konservuese Dhe Restauruese Të Trashëgimisë Kulturore.
<https://Gzk.Rks-Gov.Net/Actdetail.aspx?Actid=8233>

Rregullore Nr. 04/2008 Mbi Autorizimet Dhe Kompetencat E Inspektionit Për Trashëgimi Kulturore.
<https://Gzk.Rks-Gov.Net/Actdetail.aspx?Actid=8234>

Rregullore Nr. 05/2008 Mbi Regjistrimin, Dokumentimin, Vlerësimin Dhe Përzgjedhjen E Trashëgimisë Kulturore Për Mbrojtje.
<https://Gzk.Rks-Gov.Net/Actdetail.aspx?Actid=8235>

Rregullore Nr. 06/2008 Mbi Masat E Sigurisë Për Trashëgiminë E Luajtshme.
<https://Gzk.Rks-Gov.Net/Actdetail.aspx?Actid=8236>

Rregullore Nr. 07/2008 Mbi Procedurat E Licencimit Për Tregtarët E Objekteve Të Trashëgimisë Së Luajtshme, <https://Gzk.Rks-Gov.Net/Actdetail.aspx?Actid=8237>

Statuti I Muzeut Komëtar Të Kosovës, <https://Gzk.Rks-Gov.Net/Actdocumentdetail.aspx?Actid=32154>

Shoshi, Sali, 2019, ZBATIMI I LIGJIT NR. 02/L-88 PËR TRASHËGIMI KULTURORE
Trashëgimia Kulturore pa Kufij, CHWB Kosovo (2019) “Analiza e Strategjise Kombetare te TK-se, Ruzhdi Halili”

Universiteti i Warmia, Fakulteti i Gjeodezisë, Poloni (2018) “Aplikimi I GIS-it në mbrojtje të monumenteve” <https://doi.org/10.1051/e3sconf/20186300015>

UDHEZIM administrativ per shenjimin e TK dhe vendeve turistike
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21855>

USAID, Agjensioni Ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim, 2017 “Udhëzues për hartim dhe miratim të hartës zonale të komunës”

USAID, Agjensioni Ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim, 2019 **“Hulumtim parlamentar, Zbatimi I Ligjit Për Trashëgimi Kulturore”**

Udhëzues Për Standardet E Hartimit Të Planeve Menaxhuese Të Trashëgimisë Kulturore, 2020

Udhëzues Për Trashëgiminë Kulturore, Mjete Teknike Për Mbrojtjen dhe Menagjimin E Trashëgimisë, 2020

Zyra Kombetare E Auditimit, Raporti I Auditimit, (2018), Për Këshillin E Kosovës Për Trashëgimi Kulturore Për Vitin Financiar Të Përfunduar 2018

Zyra Kombetare E Auditimit, Raporti I Auditimit, (2020), Për Këshillin E Kosovës Për Trashëgimi Kulturore Për Vitin Financiar Të Përfunduar 2020

Zyra Kombetare E Auditimit, Raporti I Auditimit, (2020), Për Ministrinë E Kulturës, Rinisë Dhe Sportit, Mkr, Për Vitin Financiar Të Përfunduar 2019

Zyra Kombetare E Auditimit, Raporti I Auditimit, (2020), Për Ministrinë E Kulturës, Rinisë Dhe Sportit, Mkr, Për Vitin Financiar Të Përfunduar 2020

Komunikimi me shkrim me Institucionet përgjegjëse:

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë,
Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë dhe Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren).
Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Gjykata Themelore në Prishtinë, Gjykata Themelore në Pejë dhe Gjykata Themelore në Prizren)
Këshilli Prokurorial i Kosovës (Prokuroria Themelore Prishtinë, Prokuroria Themelore Pejë dhe Prokuroria Themelore Prizren)
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Pejë,
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren,
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Gjakovë,
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Gjilan,
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Mitrovicë
Inspektorati për Trashëgimi Kulturore

Komunikimi me shkrim dhe takime fizike me:

Ministrine e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoreshën e Departamentit të Trashëgimisë Kulturore, Vjollca Aliu
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prishtinë - Drejtoresha Edona Gashi-Durguti,
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Mitrovicë, Drejtoresha Rrezarta Loxha-Vitaku
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Gjilan, Drejtor Artan Hoxha
Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore, Inspektorë Cjejlane Hoxha, Pajtim Zogaj, Labëri Dakaj dhe Imer Hakaj
Drejtorin e Institutit Arkeologjik të Kosovës, Enver Rexha
Institutin e Kosoves për Trashëgimi Kulturore, Ushtrues Detyre- Isuf Koci
Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, drejtor Ismet Hajrullahu
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - Drejtor i Institutit për Planifikim Hapësinor,
Luan Nushi dhe Festa Nixha Nela
GIZ - Shkëlqim Daci
Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Kulturës, Yllka Sylja dhe Lindita Hajdari
Komuna e Leposaviqit, Departamenti i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Goran Lazovic
Komuna e Podujeves, Zyra për mbrojtje të mjedisit, Rizah Muqolli

PYETËSORËT

Pyetësoni i përgjithshëm drejtuar MKRS, Departamentit të Trashëgimisë Kulturore, të gjitha Qendrave rajonale për Trashëgimi Kulturore - QRTK, Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Institutit Arkeologjik të Kosovës, Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve... :

- 1.** Sa të punësuar i ka institucioni/ departamenti juaj?
- 2.** A keni strukturë organizative të personelit-organogram?
Nëse, po: Kur është krijuar? Nga kush? Ju lutem bashkangjiteni në pyetësor.
- 3.** Listojini përgjegjësitë që ka institucioni/departamenti juaj.
- 4.** A i keni të përshkruara detyrat e punës?
- 5.** A keni rregullore të punës?
Nëse, po: Kur është krijuar? Ju lutem bashkangjiteni në pyetësor.
- 6.** Sa shpesh keni takime të brendshme? Tregoni më shumë rreth tyre.
- 7.** A keni raporte vjetore të viteve 2018, 2019, 2020?
Nëse, po: Ju lutem bashkangjiteni ato në pyetësor.
- 8.** Cili ka qenë buxheti që është planifikuar gjatë këtyre viteve: 2018, 2019, 2020?
Cili është buxheti i planifikuar të shpenzohet gjatë këtij viti?
- 9.** Cili ka qenë buxheti që është shpenzuar gjatë këtyre viteve: 2018, 2019, 2020?
- 10.** A keni plan vjetor të punës? Nëse po, ju lutem bashkangjiteni dokumentin.
- 11.** Cfarë bashkëpunime - projekte afatgjate, kombëtare dhe ndërkombëtare keni pasur që nga viti 2018 deri sot?
Listojini ato duke përfshirë të dhëna në llojin e bashkëpunimit, kohën dhe arsyen e bashkëpunimit.
- 12.** Cfarë lloje të punëtorive (workshopeve) keni pasur që nga viti 2018 deri më sot?
- 13.** A ka pasur trajnime të prsonelit tuaj manaxhues që nga viti 2018? Nëse po, cilat kanë qenë ato?
- 14.** Cilat janë sfidat në buxhet, trajnime, logjistikë, komunikim me eprorët dhe personel në institucionin/departamentin tuaj këtë vit?

Pyetësor drejtuar MKRS, Departamentit të Trashëgimisë Kulturore:

- 1.** A keni listë të të gjitha intervenimeve fizike që MKRS i ka bërë deri tani?
Nëse, po: Ju lutem bashkangjiteni në pyetësor.
Nëse, jo: Pse?
- 2.** Cili është buxheti i shpenzuar për vit në intervenimet fizike?
2018:
2019:
2020:
- 3.** Sa është planifikuar të shpenzohet këtë vit?
Ju lutem bashkangjiteni raportet vjetore buxhetore në pyetësor.
- 4.** Sa ndërtesa janë të përfshira në bazën e të dhënave të listës së mbrojtjes së përkohshme?
(Sipas Ligjit për Trashëgimi Kulturor, neni 3)
- 5.** Sa ndërtesa përfshihen në listën e mbrojtjes së përkohshme brenda një viti kalendarik?
- 6.** Cilat janë kriteret e përzgjedhjes? Tregoni detaje rreth mënyrës së krijimit të listës vjetore.
- 7.** Kush është përgjegjës në përzgjedhjen e listës së objekteve që hyjnë në mbrojtje të përkohshme?
- 8.** A është procedura e njejtë e përzgjedhjes që nga viti 2018? Tregoni arsyet nëse po ose nëse jo.
- 9.** Sa shpesh përditësohen të dhënat e kësaj liste dhe sa është numri i stafit që përditësojnë këto të dhëna?
- 10.** Cilat institucione përfshihen në përditësim të këtyre të dhënave?
- 11.** Cfarë ndodhë me asetet e propozuara pas publikimit të listës së asetëve në mbrojtje të përkohshme?
- 12.** A bëhet vlerësimi i tyre brenda afatit të paraparë 1 vjeçar?
Nëse po, nga kush bëhet vlerësimi? Tregoni numrin e asetëve që arrijnë të vlerësohen brenda vitit të paraparë dhe bashkangjitur kopje të shembujve të vlerësuar.
- 13.** Sa projekte janë aprovuar nga KKTK viteve të fundit?
Nëse nuk vlerësohen nga KKTK, atëherë kush i ka vlerësuar këto projekte?
- 14.** Sipas neni 3, pika 3.6, a ka pasur ndonjë rast të kompensimit për ndonjë humbje financiare të objektit nëse nuk ka hyrë në listën e mbrojtjes së përkohshme pas një viti?
- 15.** A është institucioni juaj i vetëdijshëm për dëmin e mundshëm të buxhetit të shtetit nëse asetet e listës së mbrojtjes së përkohshme vazhdojnë të mbesin në këtë listë për vite me radhën dhe pronarët do të kërkonin kompensim?
- 16.** Sa ndërtesa janë të përfshira në bazën e të dhënave të listës së mbrojtjes së përhershme?
(Ligji për Trashëgimi Kulturor, neni 4)
- 17.** Sa ndërtesa përfshihen në listën e mbrojtjes së përhershme brenda një viti kalendarik?
- 18.** Kush është institucioni përgjegjës në propozimin dhe përzgjedhjen e listës së objekteve që hyjnë në mbrojtje të përhershme?

19. Cilat janë kriteret e përzgjedhjes dhe cili akt nënligjor përcakton këto kriteret?
Tregoni detaje rreth mënyrës së organizimit të krijimit të listës vjetore.
20. Cilat institucione përfshihen në përditësim të këtyre të dhënave dhe sa është numri i stafit që përditësojnë këto të dhëna?
21. Sa shpesh përditësohen të dhënat e kësaj liste?
22. A është procedura e njëjtë e përzgjedhjes në tri vitet e fundit? Tregoni arsyet nëse po ose nëse jo.
23. Ju lutem bashkangjiteni raportet e punës për tri vitet e fundit.
24. Si është caktuar perimetri i asetit të mbrojtur dhe i zonës së mbrojtur të objekteve në mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme?
25. A është zbatuar në praktikë?
Nëse, po: A keni dokumente të dëshmojnë atë?
Nëse, jo: Pse?
26. Sa shpesh bëhet inspektimi i aseteve në terren dhe nga kush?
27. Si identifikohet gjendja e asetit përkatës? Pse nuk bëhen riparimet urgjente për asetet e rrezikuara në praktikë?
28. A keni bazë të të dhënave për asetet që janë të rrezikuara? A mundem me pas qasje në këto informata?
29. Sa shpesh ndodhë të ndalohet puna konservuese ose restauruese nëse identifikohen parregullësi gjatë zbatimit të tyre (neni 4.20)?
30. Raste konkrete? Cilat janë veprimet që ndërmerren në këtë rast ndaj punëkryesit?
31. A keni format/ pyetësorë/ manual (apo diç tjetër) në bazë të së cilit analizohen specifikat e monumenteve për të caktuar zonën mbrojtëse?
32. Në qoftëse po, cili është ai? Në qoftëse jo, a është ky problemi i vetëm që monumentet nuk kanë zonë të definuar?
33. Sa janë të aplikueshme në praktikë nenet 6.7 dhe 6.9, rreth modifikimit apo demolimit të një aseti?
Tregoni rastet konkrete
34. A ka kapacitete njerëzore MKRS për të caktuar perimetrin dhe monitoruar në baza vjetore zhvillimet që ndodhin rreth monumenteve në tërë territorin e KS?
35. Sa janë të aplikueshme në praktikë leje të marrura për ndërtim brenda një zone së mbrojtur?
Tregoni raste konkrete.
36. Tregoni më shumë detaje rreth shenjzimit të përcaktuar sipas nenit 6.1? Kush është përgjegjës? Pse ka ngecje?
37. A është e aplikueshme në praktikë neni 7.16 rreth perimetrit të trashëgimisë arkeologjike?
38. Si përzgjedhet komisioni i pavarur për kompensimin e humbjes së tokës punuese bujqësore?
Më shumë info rreth kompensimit...
39. Sa monitorohen aktet e lëvizjes së objekteve të trashëgimisë së luajtshme të përcaktuar në nenin 9.29, 9.30, 9.31?
40. A janë të regjistruara asetet në mbrojtje të përkohshme ose të përhershme në agjencionin kadastral dhe gjeodezi të Kosovës, në të dy nivelet, atë qendror dhe lokal?
41. Si është bashkëpunimi me Agjencionin Kadastral? A ju dërgoni të dhënat e aseteve?

42. Sa shpesh përditësohen të dhënat në Agjencion Kadastral?
43. Si ndodhe procesi i rishikimit, adaptimit ose refuzimit nga Këshilli i Kosovës i përshkruar në nenin 4, pika 3? (Ligji për trashëgimi kulturore)
Si vazhdon ky proces?
44. Si është bashkëpunimi ndërinstitucional?
45. A ka qasje MKRS në asetet që janë në mbrojtje të UNESCO-s? Nëse po, si monitorohen dhe kontrollohen zhvillimet në dhe rreth këtyre monumeteve?
46. A është tentuar ndonjëherë që MKRS të ushtrojë përgjegjësitë institucionale ndaj këtyre aseteve
47. Cila ka qenë ekipa për përcaktimin e SPZ (Special Protected Zones)? A ka pasur përfaqësues nga MKRS?
48. Mbi cilat kritere kjo ekipë ka përcaktuar zonën e mbrojtur?
49. A ka raporte/agjendë të takimeve të mbajtura të kësaj ekipe?
50. Cilat janë fondet që janë ndarë në 3-5 vitet e fundit për shpëtim arkeologjik? (neni 7.3)
51. Trego më shumë rreth procedurave të vlerësimit të trashëgimisë së luajtshme? Si ndodhë ajo?
52. Kush është insitucioni kompetent? Çka dallon institucioni kompetent i kësaj kategorie me institucionin kompetent për trashëgimin e palujtshme?
53. Sa raste janë gjorbitur për veprime të paautorizuara sipas nenit 11 gjatë viteve të fundit?

Pyetësor drejtuar Këshillit të Kosovës për Trashegimi Kulturore

1. Kush është institucioni mbrenda Kuvendit që e mbikëqyrë KKTK, roli?
2. Si ndodhë procesi i rishikimit, adaptimit ose refuzimit nga Këshilli i Kosovës i përshkruan në nenin 4, pika 3?
3. Si vazhdon ky proces?
4. Kush janë anëtarët e Këshillit të Kosovës?
5. Ju lutem bashkangjitni raportet e punës në tri vitet e fundit.
6. Si është bashkëpunimi ndërinstitucional?

Pyetësor drejtuar Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumeteve

1. Si identifikohen ndërhyrjet e paligjshme në astete të TK dhe sa shpesh bëhen vizita në asete?
2. A keni gjendje te dokumentuar (baseline) te cilen pastaj mund ta krahasoni nga viti në vit në mënyrë që të detektohen ndërhyrjet?
3. Për sa monumente keni gjendje të dokumentuar?

Pyetësor drejtuar të gjitha Qendrave Rajonale për Trashëgimi Kulturore - QRTK

1. Si identifikohen ndërhyrjet (nëse ka) në asete të TK?
2. A keni gjendje të dokumentuar (baseline) të cilën pastaj mund ta krahasoni nga viti në vit në mënyrë që të identifikohen ndërhyrjet?
3. Për sa monumente keni gjendje të dokumentuar?

Pyetësor drejtuar Inspektoratit për Trashëgimi Kulturore

1. Si bëhet verifikimi i punëve të paautorizuara në asete të TK?
2. Sa raste kanë ndodhur në 3 vitet e fundit në ndalimin e punëve të tilla?
3. A janë marrë veprime konkrete ndaj intervenimeve të paautorizuara? Nëse po, trego raste konkrete.
4. A janë kthyer asetet në gjendjen e mëparshme?
5. A ka inicuar Inspektorati procedura penale dhe të kundërvajtjes ndaj personave juridik dhe fizik që kanë dëmtuar asetet e TK?

Pyetësor drejtuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:

6. Sa monumente janë të përfshira në Hartë Zonale të Kosovës??
7. Cilat kategori të aseteve në mbrojtje ligjore janë të përfshira në Hartë Zonale?
8. Cfarë lloj dhe sa specifike janë këto informata të futura rreth Trashëgimisë Kulturore?
9. A janë të trajtuara të gjitha komunat e Kosovës në Hartë Zonale?
10. A janë të trajtuara të gjitha komunat e Kosovës në Hartë Zonale?
11. A keni format/ pyetësor/ manual (apo diç tjetër) në bazë të së cilit analizohen specifikat e monumenteve për të caktuar zonën mbrojtëse?
12. Në qoftëse po, cili është ai? Në qoftëse jo, a është ky problemi i vetëm që monumentet nuk kanë zonë të definuar?
13. A keni pasur ekipë (qoftë deskresearch apo ekipë të terrenit) për verifikim/ monitorim të informatave para futjes në hartë zonale?
14. Nëse po, si është caktuar ajo ekipë? A kanë marrë pjesë përfaqësues nga institucione tjera?
15. A ka mandat kjo ekipë dhe në çfarë bazë kohore funksionon?
16. A janë informatat e TK-së të harmonizuara me Agjensionin Kadastral të Kosovës?
17. Cili është komunikimi me Këshillin Zbatues Mbikqyrës të caktuar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë?
18. A ka qenë MMPH pjesë e caktimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtura dhe a ka rol MMPH monitorimin e zhvillimeve në Zonat të Veçanta të Mbrojtura?

19. Cilat kanë qenë kriteret e caktimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtura?
20. A ka raporte/ agjendë të takimeve të mbajtura të kësaj ekipe?

Pyetësor drejtuar Komunës së Prishtinës:

21. Në cilin nivel gjendet përpilimi i Hartës Zonale Komunale?
22. Nga cili institucion janë të marra informatat për Trashëgiminë Kulturore?
23. Sa monumente janë të integruara në Hartë Zonale?
24. A ka asete në HZK që nuk gëzojnë status ligjor?
25. A janë këto informata të sinkronizuara/ përfshira në planet kadastrale?
26. Cfarë lloj të informatash posedojnë këto monumente në Hartë Zonale dhe a ka pasur kriter për pranim të tyre?
27. A është bërë ndonjë analizë në terren për identifikim të gjendjes së këtyre monumenteve, para se të futen në HZK?
28. Si e vlerësoni bashkëpunimin me MKRS për përfshirjen e trashëgimisë kulturore në HZK?
29. A ka komuna personel të trajnuar që do të siguronte qëndrueshmëri rreth përpunimit të të dhënave?
30. A ekzistojnë zona të mbrojtura të trashëgimisë kulturore në HZK?
31. Si është trajtuar deri me tani zona e vjetër e qytetit? Me çfarë baze janë dhënë dhe jepen lejet e ndërtimit në këtë zonë?
32. A ka komuna mekanizëm për monitorim të zhvillimit në zona përreth dhe në monumente?
33. A ka ndodhë që dikush të paditet apo dënohet për dëmtim të monumentit - në çfarëdo lloj forme?

Pyetësor drejtuar Komunës së Pejës:

34. A kanë qasje zyrtarët komunalë në Patrikanën e Pejës?
35. Cili është komunikimi i zyrtarëve përgjegjës (departamentit të planifikimi dhe kulturës) me KOS?
36. A keni pasur ndonjëherë takim me përfaqësues të KOS rreth Patrikanës së Pejës?
37. A mund të konsiderohet si territor i huaj zona e këtij monumenti?
38. A ka pasur KK në Pejë ndonjëherë investime apo kërkesë për investime në këtë monument/ zonë?
39. Kush ka qenë dhe kush është përgjegjës për sigurinë e zonës dhe monumentit?

Pyetësor drejtuar Komunës së Leposaviqit:

- 40.** Sa monumente konsiderohen të mbrojtura ligjerisht dhe a janë këto të sinkronizuara me listat e MKRS-së?
- 41.** Cilat monumente janë të mbrojtura nga Serbia në komunën tuaj?
- 42.** A kanë zonë të mbrojtur këto monumente?
- 43.** A ka departamenti mekanizëm për monitorim të zhvillimeve në këto zona?
- 44.** Si qendron komunikimi më MKRS-së rreth aseteve të mbrojtura?
- 45.** A kanë investuar institucionet e Kosovës në monumentet e komunës tuaj?

Pyetësor drejtuar Shërbimit Policor të Kosovës:

- 46.** Cilat janë objektet të trashëgimisë kulturore fetare që i ofrohet siguri nga Policia e Kosovës?
- 47.** A ka objekte fetare që për aspektin e sigurisë është përgjegjës ndonjë strukturë ndërkombëtare?
- 48.** Për sa vite ofrohet kjo siguri nga Policia e Kosovës?
- 49.** Cila është kostoja vjetore për ofrimin e sigurisë në këto objekte?
- 50.** A është e mjaftueshme siguria që ofrohet nga Policia e Kosovës ndaj këtyre objekteve?
- 51.** A kanë ndodhë sulme/ vandalizma/ vjedhje apo të tjera ndaj objekteve fetare (serbe, muslimane apo të tjera) në tri vitet e fundit?
- 52.** Cili ka qenë motivi i sulmeve dhe a ka të dënuar?
- 53.** Cili është nacionaliteti i të dënuarve?
- 54.** A vlerësoni se qëllimet e kryesit/ve të veprave kanë qenë me motive fetare?